



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI
MBI
“AUDITIMIN FINANCIAR DHE TË PËRPUTHSHMËRISË”
BASHKIA SARANDË

Tiranë, 2022



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

Raport përfundimtar mbi auditimin e ushtruar në Bashkinë Sarandë

PËRMBAJTJA:

NR	EMËRTIMI I KAPITUVJE	FAQE
I	PËRMbledhja EKZEKUTIVE	4 - 20
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimití í í í í í í í í í í í í í í í í	4 - 4
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeveí í í í í í í í í í í í í	4 - 17
3.	Konkluzion i përgjithshëm dhe Opinioni i Auditimití í í í í í í í í í í í	17 - 20
II	HYRJA	20 - 24
	a. Objektivat e auditimit.....	
	b. Qëllimi i auditimit.....	
	c. Identifikim i çështjes.....	
	d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	
	e. Përgjegjësitë e Audituesve.....	
	f. Kriteret e vlerësimit	
	g. Standardet e auditimit.....	
	h. Metodatat e auditimi	
	i. Dokumenti i auditimit.....	
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.	24 - 117
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.	24 - 26
2.	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.	26 - 117
2.1	Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm	26 - 27
2.1.2	Mbi funksionimin e Auditit të Brendshëm	27 - 31
2.2.	Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit,.....	31 - 43
2.2.6	Mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi i tyre.	43 - 65
2.3	Vlerësimi Raportimit Financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2021.....	65 - 82
2.4	Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta për vitin 2021.....	82 - 101
2.4.4	Mbi hartimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues	101 - 114
2.5.	Zbatimi i rekomandimeve	114 - 115
2.5	Të ndryshme (shqyrtim ankesash)	115 - 117
IV.	GJETJE DHE REKOMANDIME.	117 - 144
V.	ANEKSE.	144 - 209

SHKURTIME

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit.
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli.
NA	Nëpunës Autorizues.
NZ	Nëpunës Zbatues.
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik.
NJAB	Njësia e Auditimit të Brendshëm.
AB	Auditi i Brendshëm.
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm.
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rajoneve.
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara.
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave.
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak.
ISSAI	Standartet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit.
INOTSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit.
ISA	Standartet Ndërkombëtare të Auditimit.
IFAC	Federatës Ndërkombëtarë të Kontabilistëve
IPSAS	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik.
ALUIZNI-t	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritit të Zonave të Ndërtimeve Informale.
IT	Teknologjia e Informacionit.
NJA	Njësi Administrative.
SHA	Shoqëri Anonimë.
BOE	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë.
OE	Operator Ekonomik.

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.

Kontrolli i Lartë i Shtetit (*këtu e vijim KLSH*), në periudhën nga data 8.4.2022 deri në datë 20.5.2022, realizoi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë të veprimtarisë ekonomike dhe financiare të subjektit Bashkisë Sarandë, të periudhës nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021, duke u përqendruar kryesisht në organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, planifikimin, hartimin dhe realizimin e buxhetit; realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat e tarifave vendore; auditimin me zgjedhje i transaksioneve financiare, hartimin e pasqyrave financiare viti 2021, si dhe zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimeve të fondeve publike dhe menaxhimit të të ardhurave, etj.

Grupi i auditimit të KLSH shqyrtoi, analizoi dhe arriti në konkluzione mbi secilën prej drejtimeve të auditimit, në bazë të dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga subjekti (me zgjedhje), për të arritur në një siguri të arsyeshme në dhënien e opinionit të auditimit.

Gjatë gjithë procedurës së këtij auditimi, janë mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë në KLSH, Rregullorja funksionimit organizativ dhe administrativ të KLSH, Rregullorja e procedurave të auditimit, Kodi i etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Në arritjen e konkluzioneve dhe përfundimeve mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me kuadrin ligjor dhe rregullator përkatës, krahas njohjes së detajuar të tyre të cilat kanë shërbyer si burim i kriterëve të auditimit, ne kemi përdorur metoda dhe teknika efikase, si verifikimi i transaksioneve, intervistimi, raporte dhe informacione, verifikime në terren etj.

Gjetjet e këtij auditimi të karakterit organizativ, shpërblim të dëmit, mungesë së të ardhurave dhe të përdorimit jo me efektivitet të fondeve publike (3-E), i janë nënshtruar skepticizmit profesional dhe gjykimit objektiv të audituesve, duke i dhënë mundësi KLSH në dhënien e rekomandimeve përkatëse për përmirësimin e gjendjes, si dhe për të evidentuar përgjegjësitë nëpërmjet rekomandimit të masave disiplinore.

Bazuar në rezultatet e auditimit të Bashkisë Sarandë për periudhën nga data 01.01.2021 deri më datë 31.12.2021, grupi i auditimit konkludon në një *opinion të modifikuar/ kualifikuar*¹ për aspektin financiar (pasqyrat financiare viti 2020), ndërsa për aspektin e përputhshmërisë për të ardhurat dhe shpenzimet ka dalë me *opinion të kundërt*².

Raporti Përfundimtar i Auditimit është i strukturuar në pesë kapituj: përmbledhja ekzekutive; hyrja, me çështjet e objektivave dhe qëllimi i auditimit, përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe të Audituesve, kriteret, identifikimi i çështjeve etj.; përshkrimi i auditimit, në të cilin paraprin një informacion i përgjithshëm mbi subjektin e audituar dhe vazhdon me trajtimin e rezultateve të auditimit për secilin prej 5 drejtimeve të auditimit; në kapitullin e katërt jepen gjetjet dhe rekomandimet dhe në fund janë anekset.

¹Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar:

Kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose

2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura

²**Opinion i kundërt.** Audituesi duhet të shprehë një opinion të kundërt: 1. kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomalië apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose 2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale të përhapura.

I.1. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe Rekomandimeve

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
1.	<p>Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2021, konstatohet se në total është realizuar në masën 82%, ku nga vlera e planifikuar prej 1,296 mijë lekë është realizuar vlera prej 1,075,684 lekë. Zëri investime paraqitet në masën 59%, shpenzimet operative në masën 71% dhe shpenzime për paga në masën 90%.</p> <p>Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara për vitin 2021, nga vlera planifikuar prej 417,275 mijë lekë është realizuar vlera prej 294,617 mijë lekë.</p> <p>Referuar të dhënave, rezulton se në totalin e procedurave të zhvilluara për vitin 2021 (<i>me vlerë të lartë</i>), Bashkia Sarandë me të ardhurat e veta mbulon 19% (nga vlera e kontratave të lidhura prej 110,616 mijë lekë është likuiduar vlera prej 89,307 mijë lekë), pra me një diferencë në vlerën 21,309 mijë lekë.</p> <p>Pjesa tjetër e kontratave të lidhura e cila paraqitet në vlerën 402,550 mijë lekë, është me financim nga Ministrinë e linjës dhe FZHR, ku për vitin ushtrimorë 2021 është planifikuar për likuidim vlera 98,059 mijë lekë, duke respektuar kufirin e 20%, nga e cila likuiduar vlera 78,259 mijë lekë ose më pak për shumën 19,800 mijë lekë, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit (<i>Të dhënat e mësipërme paraqiten në Aneks 2.1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit</i>).</p> <p>Mos zbatimi i kontratave të lidhura dhe planifikuara në buxhetin e vitit 2021, nga të ardhurat e veta, vjen si rezultat i mos planifikimit të të ardhurave për likuidimin e këtyre faturave, pasi një pjesë është destinuar për pagesën e detyrimeve të prapambetura nga vitet e kaluara. Gjithashtu sipas Drejtorisë Ekonomike, kjo vjen për faktin se nga subjektet zbatuese dokumentacioni shoqërues nuk është në përputhje me ligjin, pasi ka mangësi në plotësimin e tij. Këto veprime vënë bashkinë në vështirësi financiare, si dhe rrisin detyrimet kreditore në fund të periudhave ushtrimore (fatura të palikujduara), ku pavarësisht se vijnë në ulje nga njëra periudhë në tjetër përsëri më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 30,401,541 lekë.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime.</p>	I lartë	31-43	<p>Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse si dhe të monitorohet ecuria e të ardhurave, duke vlerësuar risqet që mund të ndikojnë në mosrealizimin e vlerës së planifikuar dhe mbi bazën e tyre.</p> <p>Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrë masa që shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim i plotë në kontabilitet.</p> <p>Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, për të gjitha rastet e paraqitjes nga subjekti zbatues me vonesë të faturave për likuidim të situacioneve mujore, progresive ose përfundimtare, me dokumentacion jo të rregullt dhe në kundërshtim me kushtet e kontratës, të aplikohet penalitet (kamatëvonesë) për deklarim me vonesë, si dhe të kërkohet Drejtorisë Rajonale Tatimore Dega Sarandë zbatimin e procedurave për mos deklarim në afat të TVSh në shitje nga mos depozitimi i faturës në afatin e caktuar sipas ditarit të punimeve.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
2	<p>Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton gjendje e konsiderueshme e llog. 468 "Debitorë të ndryshëm" me vlerë 481,241,985 lekë, ku përveç debitorëve të taksave ka ndikuar dhe vlera e lartë e gjendjes në vlerën 162,031,719 lekë të debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të rekomanduara nga KLSH-ja në vite për Bashkinë dhe ish-Komunat, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtim, duke kaluar afatet e kërimit. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 10 296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin e ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 9, 11 dhe 12, me ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017 për financat e vetëqeverisjes vendore e ndryshuar, neni 40.</p>	I lartë	65-82	<p>Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë Juridike të marrë masat që për vlerën e debitorë prej 162,031,719 lekë të rekomanduara në vite nga KLSH-ja por të paarkëtuara, të cilave po ju kalon afati ligjor i kërimit, të zërthejë dokumentacionin ligjor për to, duke i klasifikuar sipas afateve dhe për detyrimet deri në 5 vjet të nxjerrë akte administrative për rivendosjen e afateve dhe kërkimin e tyre në rrugë administrative dhe ligjore.</p> <p>Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me (Drejtorinë Juridike (Sektorin Procedurave të Prokurimit), të mos lidhin kontrata dhe të përjashtohen nga procedurat e prokurimit pa bërë më parë likuidimin e detyrimeve që ato kanë ndaj Bashkisë Sarandë dhe të pa ankimuar.</p>
3	<p>Gjendja e llog. 202 "Studime dhe kërkime" në mbyllje të vitit 2021 paraqitet me vlerë neto 15,940,245 lekë dhe me vlerë bruto prej 119,561,177 lekë (kosto historike), që i përket 113 projekt-studimeve për investime. Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 14,433,919 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llog. 202 "Studime dhe Kërkime", për 112 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ÷ Aneksi 1. pika 2, Klasa 2 ÷ Aktivitet Afatgjatë, pika 3.3 nën-pika 62.</p>	I lartë	65-82	<p>Drejtoria Ekonomike të marrë masa që gjendja prej 14,433,919 lekë e llog. 202 "Studime dhe kërkime", të analizohet dhe të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktiviteti afatgjatë material si pjesë e kostos së tij.</p>
4	<p>Nga analiza e inventarit kontabël të llog. 210 "Toka Troje Terrene", rezulton se në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 14 artikuj aktive materiale në vlerën 38,081,192 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 212 "Ndërtesa Konstruksione". Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme, Aneksi 1, pika 2. Klasa 2, dhe me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik.</p>	I lartë	65-82	<p>Drejtoria Ekonomike të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 210 "Toka Troje Terrene", sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 212 "Ndërtesa Konstruksione".</p>
5	<p>Nga analiza e inventarit kontabël të llog. 212 "Ndërtesa Konstruksione" rezulton se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 8 artikuj aktive materiale në vlerën 9,074,339 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" në vlerën 7,343,493 lekë, llog. 210</p>	I lartë	65-82	<p>Drejtoria Ekonomike të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 212 "Ndërtesa Konstruksione" sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>“<i>Toka, Troje, Terrene</i>” në vlerën 1,730,846 lekë. Gjithashtu vlera prej 1,761,146 lekë është emërtuar òAktive te trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)ò, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.8.2022 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 Pika 2. Klasa 2, me Nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.</p>			<p>debi të llog. 213 “<i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i>” dhe llog. 210 “<i>Toka, Troje, Terrene</i>”.</p> <p>Drejtoria Ekonomike të marrë masa për inventarizimin e aktiveve në vlerën 1,761,146 lekë përfshirë në gjendjen e llog. 212 “<i>Ndërtesa Konstruksione</i>”. Të kryej zberthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.</p>
6	<p>Nga analiza e inventarit kontabël të llog. 213 “<i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i>” rezulton se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 19 artikuj aktive materiale në vlerën 48,367,346 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 212 “<i>Ndërtesa Konstruksione</i>” në vlerën 36,403,544 lekë dhe llog. 210 òToka, Troje, Terreneò në vlerën 11,963,802 lekë. Gjithashtu vlera prej 29,568,137 lekë është emërtuar òRikonstruksionò, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 pika 2. Klasa 2, , me Nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.</p>	I lartë	65-82	<p>Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 213 “<i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i>”, sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 212 “<i>Ndërtesa dhe Konstruksione</i>” llog. 210 “<i>Toka, Troje, Terrene</i>”.</p> <p>Kryetari i Bashkisë Sarandë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimin të aktiveve në vlerën 29,568,137 lekë përfshirë në gjendjen e llog. 213 “<i>Rrugë, rrjete, vepra ujore</i>” dhe në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të kryejë zberthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.</p>
7	<p>Nga analiza e inventarit kontabël të llog. 214 “<i>Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune</i>” rezulton se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 7 artikuj aktive materiale në vlerën 3,766,818 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 218 “<i>Inventar Ekonomik</i>”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 pika 2. Klasa 2, , me Nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik.</p>	I lartë	65-82	<p>Drejtoria Ekonomike të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 214 “<i>Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune</i>” sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 218 “<i>Inventar Ekonomik</i>”.</p>
8	<p>Gjendja e llog. 26 “<i>Pjesëmarrje në kapitalin e vet</i>” e cila si në mbyllje të vitit 2021 paraqitet me gjendje 0, kur në fakt ka investime kapitali në formë aksionesh tek B... sha. Në këtë llogari duhet të</p>	I lartë	65-82	<p>Drejtoria Ekonomike të marrë masa, që të kryejë veprimet kontabël për pasqyrimin në PF të investimeve kapitale në vlerën 2,000,000 lekë të kryera në vitet e</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>kishte të evidentuar vlerën e kapitalit të derdhur në bazë të % së zotërimit të aksioneve nga Bashkia Sarandë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Bashkia Sarandë është aksionere me 100% të aksionevetë K... sh.a. NUIS..., e cila është shoqëri aksionere me objekt òOrganizimi i aktiviteteve sportive ne fushën e futbollit....ò, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e sajò.</p> <p>Bashkia Sarandë zotëron në K... Sha 2000 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksioni, me vlerë kapitali 2,000,000 lekë. Për vlerën e kapitalit prej 2,000,000 lekë të derdhur nga Bashkia Sarandë, duhet të ishin kryer veprimet e kontabël në debi të llog. 26 òPjesëmarrje në kapitalin e vetò në kredi të llog. 1011 òShtesa të fondit bazëò.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i MFE nr. 5 datë 21.2.2022 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Kreu III. òProcedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò pika 31.</p>			<p>mëparshme, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere në SH.A òNUIS..., për vlerën 2000,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 100% të aksioneve të B... sha.</p>
9	<p>Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH rezultojn se:</p> <p>Nga Bashkia Sarandë është respektuar afati 20 ditore për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve (<i>shkresa nr. 4891/2, datë 19.10.2021</i>).</p> <p>Nuk është respektuar afati që brenda periudhën 6 mujore, Bashkia Sarandë duhet të informojë mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.</p> <p>Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Sarandë, nuk është raportuar në këshillin e njësisë (këshillin bashkiak), bazuar në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 òPër financat e vetëqeverisjes vendoreò, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij.</p> <p>Është hartuar òPlan veprimi për zbatimin e rekomandimeve në të cilën janë përcaktuar strukturat dhe personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.</p> <p><i>Gjithashtu rezultojn se:</i></p> <p>a. Janë rekomanduar 16 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 9 masa, është në proces zbatimi 1 (një) masë dhe nuk janë zbatuar 6 masa.</p> <p>b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 5 masa me vlerë 6,748,993 lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, por janë në proces zbatimi pasi janë</p>	I lartë	114-115	<p>Kryetari i Bashkisë Sarandë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces zbatimi ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 101/9, datë 01.10.201 òPër zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Sarandëò, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, <i>respektivisht për:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - 7 masa organizative, ku 6 prej tyre nuk janë zbatuar fare. - 5 masa shpërblim dëmi me vlerë 6,748,993 lekë. - 3 masa shpenzime në kundërshtim me 3-E për vlerën 6,748,993 lekë. - 3 masa mungesë të ardhurash në shumën 495,505,008 lekë. <p>Kryetari i Bashkisë Sarandë të marrë masa të menjëshërshme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e KLSH.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>kontabilizuar.</p> <p>c. <u>Për masa mos efektivitet dhe efikasë</u>, janë rekomanduar gjithsej 3 masa me vlerë 11.236.480 lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, duke mbetur pa zbatuar 3 masa me vlerë 6,748,993 lekë.</p> <p>d. <u>Për masa mungesë të ardhurash</u>, janë rekomanduar gjithsej 4 masa me vlerë 495,505,008 lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, duke mbetur pa zbatuar vlera prej 495,505,008 lekë.</p> <p>e. <u>Për masa disiplinore</u>, janë rekomanduar gjithsej 6 masa të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti.</p> <p>Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 <i>“Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”</i> neni 15, <i>“Të drejtat e KLSHë, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017”</i> për financat e vetëqeverisjes vendore.</p>			
10	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: <i>“Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Kristal”, “Përmeti”, “Papa Gjon Pali i II” dhe riveshje gropash”, Bashkia Sarandë</i>, me vlerë kontrate (pa TVSh)10,814,530 lekë, realizuar nga shoqëria A..., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 235,200 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5 prot., datë 03.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandës dhe shoqëria A....</p>	I lartë	101-114	<p>Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Sarandë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej 235,200 lekë pa TVSh nga shoqëria A..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 5 prot, datë 03.05.2021 me objekt: <i>“Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Kristal”, “Përmeti”, “Papa Gjon Pali i II” dhe riveshje gropash</i>”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.</p>
11	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: <i>“Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. “Ismail Qemali” “Çabej”, “Adem Jashari”, me vlerë kontrate (pa TVSh)9,392,610 lekë, realizuar nga shoqëria 2..., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 317,148lekë pa TVSh</i>. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6 prot, datë 03.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandës dhe shoqërisë 2...</p>	I lartë	101-114	<p>Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 317,148lekë pa TVSh nga shoqëria 2..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5 prot datë 03.05.2021 me objekt: <i>“Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. “Ismail Qemali” “Çabej”, “Adem Jashari”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.</i></p>
12	<p>Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: <i>“Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. Gjergj Fishta , Naim Frashëri, Amantia, Kristoforidhi”, me vlerë të kontratës (pa TVSh)8,530,800 lekë, realizuar nga shoqëria M..., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 77,400 lekë pa TVSh</i>, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7 prot., datë 26.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor</p>	I lartë	101-114	<p>Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 77,400 lekë pa TVSh nga shoqëria M..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7 prot., datë 26.04.2024 me objekt: <i>“Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. Gjergj Fishta , Naim Frashëri, Amantia, Kristoforidhi”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e</i></p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	Bashkia Sarandës dhe shoqëria M...			situacionimit të punimeve të pakryera.
	Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: <i>“Sistemimi i bllokut të banesave në lagjen e Lugut të Dardhës”</i> , me vlerë të kontratës (pa TVSh)4,098,081 lekë, realizuar nga shoqëria I..., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 125,400lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 8 prot., datë 30.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandës dhe shoqërinë I...	I lartë	101-114	Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 125,400 lekë pa TVSh nga shoqëria I..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8 prot., datë 30.04.2024 me objekt: <i>“Sistemimi i bllokut të banesave në lagjen e Lugut të Dardhës”</i> , vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.
13	Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: <i>“Pastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Sarandë”</i> , me vlerë të kontratës (pa TVSh)48,466,088lekë, realizuar nga shoqëria A..., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 4,363,338.20lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së shërbimit nr. 25 prot., datë 01.12.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandës dhe shoqërisë A...	I lartë	82-101	Nga Bashkia Sarandës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 4,363,338 lekë pa TVSh nga OE A..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën së shërbimit me nr. 25 prot., datë 01.12.2020, me objekt: <i>“Pastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Sarandë, Bashkia Sarandë,që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.</i>
14	Nga auditimi i dosjes teknike dhe pagesave të kryera me bankë në lidhje me procedurën me objekt: <i>“Përfundim rrjeti kryesor K.U.Z Sarandë”</i> , rezulton se nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria E... me të cilën është lidhur kontratë nr. 9, datë 6.3.2021, është paraqitur për likuidim fatura nr. 5/2022, datë 28.2.2022. Nga të dhënave të situacionit përfundimtare, vlerë e cila nuk është likuiduar pasi shoqëria nuk ka mbyllur punimet sipas kushteve të kontratë dhe nuk ka aktkolaudim. Sipas të dhënave të njësisë së procedurave (sektori i zbatimit të kontratave), nga shoqëria nuk është paraqitur shkresë për përfundimin e punimeve sipas afatit të përcaktuar në kontratë, si dhe nuk ka shtesë afat punimesh. <u>Referuar të dhënave të situacionit përfundimtar që disponon Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, punimet kanë përfunduar me datë 28.2.2022 ose 257 dite vonesë nga afati i kontratës, nisur nga data e faturës së paraqitur për likuidim.</u> Nga Bashkia Sarandë (personat përgjegjës) nuk është mundësuar llogaritja e kamatëvonesave në masën 4/1000 për çdo ditë vonesë por jo më pak se 25%, në zbatim të nenit 27 të kontratës, në vlerën 4,950,064 lekë (19,800,158 x 25%), veprime financiare me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Sarandë për të cilën ngarkohet me përgjegjësi shoqëria E... si përgjegjëse për mos përfundim të punimeve dhe shtyrjen e kamatëvonesës . Gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosjen teknike rezulton se për makineritë dhe pajisjet është llogaritur TVSh-ja kreditore (e zbritshme) , duke i konsideruar	I lartë	82-101	Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Kontratave, të marrin masa për: a- Llogaritjen, kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës së kamatëvonesës për mos përfundim në afat të punimeve në objektin <i>“Përfundim rrjeti kryesor K.U.Z Sarandë”</i> , për vlerën 4,950,064 lekë nga shoqëriaE..., duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët. b- Arkëtimin e vlerës së TVSh kreditorë të pajisjeve prej 249,000 lekë , zbritur padrejtësisht në vlerën e situacionit përfundimtar nga subjektiE..., duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët. c- Mos kryerjen e pagesave të asnjë vlerë të situacioneve pa bërë dorëzimin e mallit sipas preventivit zërit18, ku thuhet se: <i>“Furnizim/vendosje, Panel komandimi soft-staert 45 kW për lëshimin e tre pompave 38 kW secila dhe komandimi automatik të gjeneratorit 144 kW (demontim i panelit të vjetër, transport në magazinë)</i> , nga shoqëria E....

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>punime ndërtimi punimet e furnizimit të pajisjeve. Ky format i miratuar nga Këshilli i Ministrave me udhëzimin përkatëse parashikon emërtimin e zërave të punimeve, sasi, çmim, vlerë si dhe shuma e tyre, duke i shtuar TVSh-në, pastaj kësaj shume i shtohen vetëm pajisjet.</p> <p>Pra nuk ka më TVSh për pajisjet, pasi si rubrikë për efekt të llogaritjes së kostos janë zë më vete, duke u përfshirë mbrapa TVSh-së.</p> <p>Si pasojë e përfshirjes në situacion të TVSh ó së janë likuiduar tepër në vlerën 249,000 lekë.</p> <p>Si përfundim, janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve në vlerën 249,000 lekë si rrjedhojë e përfshirjes së TVSh së pajisjeve në situacionin e punimeve, vlerë kjo e cila përbën një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.</p> <p>Referuar zërave të preventivit të hartuar nga ing. K. K., konstatohet se në numrin 18 të sajë, thuhet se: <i>“Furnizim/vendosje, Panel komandimi soft-staert 45 kW për lëshimin e tre pompave 38 kë secila dhe komandimi automatik të gjeneratorit 144 kë (demontim i panelit të vjetër, transport në magazinë).</i></p> <p>Nga të dhënat e marra nga magazina Bashkia Sarandë dhe informacionit të marrë në Ndërmarrjen e Ujësjellës Kanalizime SHA Sarandë, rezulton se nga shoqëria E.....nuk është bërë hyrje pjesa e vjetër e panelit e cila është zëvendësuar.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën nr. 9, datë 6.3.2021 të lidhur midis Bashkisë Sarandë dhe shoqërisë E...;</p> <p>i) UKM nr. 2, datë 8.5.2003 <i>“Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”</i>, Kreu I/I <i>“Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”</i>, germa òAö, paragrafi i fundit, pasi të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat në përfshirjen e punimeve të ndërtimit.</p> <p>ii) VKM nr. 514, datë 15/8/2007 <i>“Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”</i>, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8.</p> <p>iii) UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 <i>“Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”</i>, të ndryshuar, pika 1, germa òcö, paragrafi i fundit.</p> <p>Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikö, i ndryshuar, për nenet 34-41.</p>			
15	<p>Nga të dhënat e regjistrimit të procedurave të prokurimit, rezulton se për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2021, rezulton se janë zhvilluar gjithsej 19 procedura me fond limit 433,430 mijë</p>	I lartë	82-101	Kryetari i Bashkisë Sarandë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>lekë dhe vlerë kontratë të lidhur 427,638 mijë lekë, me një ulje nga fondi limit prej 1.3%.</p> <p>Nga auditimi i 10 procedurave të prokurimit të vlerësuara për auditim me fond limit 401,045 mijë lekë ose 92.5% e fondit total dhe në përfundim të punës audituese në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit mbi gjetjet e konstatuara, kanë rezultuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, si më poshtë:</p> <p>a- Në 6 procedura prokurimi, kriteret nuk janë në përputhje me dispozitat e LPP dhe lloje e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar mospjesëmarrjen e OE në procedurë.</p> <p>b- Në 5 procedura prokurimi, OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi ka kriterë të cilat nuk janë plotësuar dhe nga KVO janë vlerësuar si të rregullt. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurën tjetër me kushte më të favorshme, kjo me qëllim përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondit të prokuruar në vlerën 362,987 mijë lekë.</p> <p>Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", neni 3, "Parimet e përzgjedhjeve", nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 "Autoriteti ose enti kontraktor", neni 98, "Anulimi i një procedure", neni 76, "Kriteret detyruese për skualifikim", neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 82, "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave", neni 83, "Njoftimi i fituesit".</p>			<p>teknike dhe kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE.</p> <p>Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.</p> <p>Kryetari i Bashkisë Sarandë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimit të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, por të zhvillojnë procedura të reja, duke aplikuar kriterë më të favorshme për rritjen e numrit të OE pjesëmarrjes në procedura, veprime të cilat do çojnë në mirëpërdorimin e fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve të prokuruar.</p>
16	<p>Referuar Vendimeve të KB për paketën fiskale të vitit 2021, rezulton se taksa e ndërtesës për një pjesë të konsiderueshme të familjeve aplikohet në mungesë të dokumentacionit ligjorë (<i>genplani për sipërfaqet ose të dhënave nga ASHK</i>), duke përdorur tarifë fikse 70 -100 m², mbi të cilën janë aplikuar taksa e pasurisë për ndërtesën. Kjo mënyrë e aplikimit të taksës së ndërtesës për abonentët familjarë nuk është e saktë dhe proporcionale, pasi favorizon disa dhe penalizon disa të tjerë, ku pas viteve 90 ka shumë ndërtime pa leje dhe me sipërfaqe mbi 100 m² dhe nuk janë identifikuar ato, duke bërë që ndaj këtyre subjekteve të mos aplikohet saktë taksa e ndërtesës.</p> <p>Gjithashtu nuk ka një bashkëpunim midis vetë sektorëve të bashkisë dhe jo vetëm, ku mungon informacioni i marrë nga Drejtoria e PZHT për lejet e ndërtimit dhe përdorimit të lëshuar nga kjo strukturë për sipërfaqet e objekteve dhe sipërfaqet e truallit, si dhe të dhënave të dërguara nga ASHK Dega Rajonale Sarandë mbi sipërfaqet e objekteve të legalizuara pa leje ndërtimi.</p>	I lartë	43-65	<p>Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë të gjitha masat për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e PZHT Bashkia Sarandë dhe ASHK Dega Rajonale Sarandë, për sigurimin e të dhënave të nevojshme me dokumentacion ligjorë për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo për një taksim sa më real të taksës së pasurisë (ndërtesës).</p> <p>Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej 285,062 lekë, të taksës së ndërtesës nga 3 investitorë, <i>respektivisht</i>:</p> <ul style="list-style-type: none"> - vlera 134,064 lekë nga investitori E.O. - vlera 40,320 lekë nga investitori D.D. - vlera 110,678 lekë nga investitori G.A.

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>Referuar të dhënave të marrë nga Drejtoria e PZHT për lejet e ndërtimit/përdorimit të lëshuara nga kjo strukturë, konstatohet se për 3 leje taksa e pasurisë (taksa ndërtese), nuk është llogaritur e saktë për sipërfaqen që ato disponojnë, duke evidentuar një të ardhur të munguar.</p> <p>Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 dhe Për Taksat vendore të ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë 07.03.2018 dhe Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme ndërtesa, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës.</p>			
17	<p>Nga auditimi i tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas) dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.</p> <p>Kështu, nga verifikimi në faqen e internetit të QKB-së, u konstatua se në Bashkinë Sarandë, figurojnë rreth 40 subjekte (NUIS-e sekondare, përfshirë autobotet) të cilët kanë si objekt të aktivitetit të tyre tregtinë me pakicë të karburanteve, gazit natyror, lëndëve djegëse për popullatën, etj.</p> <p>Gjithashtu, nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nuk është aplikuar autorizim për tregtim karburanti.</p> <p>Të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e licencës duhet të paguajnë si më sipër.</p> <p>Të dhënat për detyrimet për taksën e licencës për pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njësitëve të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit për taksat dhe tarifatat vendore janë <i>paraqitur në tabelën faqe xxx të Projektraport Auditimit.</i></p> <p>Nga sa mësipërm vlera 17,600,000 lekë, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.</p> <p>Veprime në kundërshtim me VKM-në Nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në Nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: <i>09. Pajisja për dhënie dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës</i></p>	I lartë	43-65	<p>Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Policinë Bashkiake Bashkia Sarandë, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 17,600,000 lekë (sipas tabelës në faqen 60-61 të Projektraport Auditimit), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit.</p> <p>Gjithashtu, të verifikojë nëse edhe subjektet e tjera të cilat në QKB figurojnë aktivë dhe me objekt aktiviteti tregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëse për popullatën, e zhvillojnë këtë lloj aktiviteti dhe të liçencohen apo të pezullohen, sipas rastit.</p> <p>Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencës/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriati Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”... “10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.ö</p>			
18	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të qirave për asetet, që Bashkia Sarandë ka me subjekte të ndryshme, rezulton se janë lidhur gjithsej 39 kontrata qiraje për objekte dhe truall me pretendimin se janë në pronësi të saj për një vlerë qiraje vjetore prej 4,864,860 lekë, nga e cila janë likuiduar për vitin 2021 vlera 3,642,560 lekë, duke mbetur për likuidim vlera 1,222,300 lekë.</p> <p>Për asetet e dhëna me qera nga Bashkia, nga auditimi u konstatua se për asnjë rast nuk është bërë përditësimi i sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në AKSH (nëse ka) apo në listat e transferimit të pasurive nga KM. Kjo nuk është pasqyruar në inventarin e pasurive të paluajtshme dhe i ka hapur rrugë informalitetit. Gjithashtu, deri në periudhën objekt auditimi, asnjë nga objektet e dhëna me qera nuk figuron i regjistruar në AKSH, pra në asnjë rast Bashkia Sarandë nuk rezulton të disponojë Titull (Çertifikatë) Pronësie për objektet e kontraktuara. Nga sa më sipër, rezulton se ligjërisht, Bashkia ka lidhur kontrata për objekte që nuk janë të vetat.</p> <p>Referuar kushteve të kontratës (neni 7 i tyre), të gjithë personat të cilat nuk ka likuiduar në afat detyrimin mbi kontratën e qirasë duhet të paralizohen në masën 0.5% për çdo ditë vonesë, pra në vlerën 2,945,743 lekë (1,222,300 lekë x 0.5% x 482 ditë vonesë), e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Sarandë (të dhënat sipas aneks 1), veprime në kundërshtim me nenin 7 të kontratës së qirave të subjekteve.</p>	I lartë	43-65	<p>Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej 1,222,300 lekë të kontratave të palikujduara.</p> <p>Gjithashtu për të gjithë subjektet që nuk kanë likuiduar në afat detyrimin e qirasë sipas kushteve të kontratës të llogariten penalitetet (kamatëvonesat) në shumën 2,945,743 lekë, dhe të arkëtohen vlera e detyrimit. Në rast mos pagese të detyrimeve të qirasë, Bashkia Sarandë të kërkojë prishjen e kontratës për moszbatim të kushteve të saj.</p> <p>Bashkia Sarandë të marrë masa për të bërë përditësimin e sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në ASHK Dega Sarandë (nëse ka) apo në listat e transferimit të pasurive nga KM, fillimisht për asetet e dhëna me qera dhe më pas me të gjitha asetet e saj. Këto të pasqyrohen në inventarin e pasurive të paluajtshme për të mos i hapur rrugë informalitetit. Të verifikojë gjendjen juridike të pronave të saj dhe të ndërpresë të gjitha ato kontrata për asete të cilat nuk i ka ligjërisht në pronësi.</p>
19	<p>Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga DTV Bashkia Sarandë, rezulton një gjendje e lartë e detyrimeve të paarkëtuara nga subjektet fizik/juridik në vlerën 317,290,273 lekë.</p> <p>Nisur nga fakti se numri i debitorëve është i lartë (aktualisht 2461 me vlerë 317,290,273 lekë), nuk mund të paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe, e cila është në formë dixhitale, me CD.</p> <p>Konstatohet se nga një periudhë në tjetër, niveli i detyrimeve të paarkëtuara vjen në rritje nga viti 2020 në shumën 31,021,793 lekë, pasi nga vlera 286,268,480 lekë në fund të vitit 2021 paraqitet vlera 317,290,273 lekë, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifatat vendore të papaguara, borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë.</p> <p>Nga DTV Bashkia Sarandë, nuk janë pallogaritur</p>	I lartë	43-65	<p>Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën 317,290,273 lekë.</p> <p>Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa për llogaritjen e saktë të vlerës së kamatëvonesave në masën 0.06% për detyrimet e maturuara por të padredhura sipas afateve ligjore nga subjektet dhe më pas të ndërmarrë veprime për arkëtimin e kësaj vlere.</p> <p>Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë të bashkëpunojë me QKB Dega</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	<p>kamatëvonesat për moslikuidimin në afat të detyrimeve në shumën 69,486,569 lekë. Evidentohet fakti që peshën kryesore e zënë debitorët e subjekteve fizik/juridik në vlerën 317,222 mijë lekë ose 78.8% e totalit. Gjithashtu evidentohet fakti se nga DAV Bashkia Sarandë, nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore për arkëtim e tyre, veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhurash në bashki.</p> <p>Referuar të dhënave të buxhetit, vlera e detyrimeve nga taksat e tarifave vendore të subjekteve fizik/juridik dhe abonentë familjarë është 30.5% e planit të buxhetit.</p> <p>Gjithashtu evidentohet një numër i konsiderueshëm subjektësh të cilët dhe pse ushtrojnë aktivitet dhe nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore çdo vit ju rigjenerohet njoftim detyrimi për vitin vijues, janë lejuar që të ushtrojnë aktivitet pa bërë likuidimet e detyrimeve ndërvite.</p> <p>Në lidhje me njoftimin për debitorë, nga inspektorët tatimorë janë bërë disa herë njoftime vlerësimi për detyrimet tatimore vendore për të gjithë subjektet dhe taksapaguesit familjare debitorë, por nga niveli menaxherial nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të kaluar në masat shtrënguese dhe në mbledhjen me forcë të detyrimit.</p> <p>Nga të dhënat evidentohet se një numër i konsiderueshëm subjektet me status pasiv/mbyllur me detyrime të paarkëtuara, gjithsej nga 138 subjekte që kanë mbyllur aktivitetin, 60 prej tyre janë me detyrime me vlerë 9,971,459 lekë, ku përgjegjësia është si Administratës së QKB Njësia Sarandë, po ashtu dhe DTV Bashkia Sarandë, e cila ka lejuar mbylljen e tyre subjekteve pa likuiduar detyrimet fiskale, duke u bërë premisë për kalimin e tyre në borxh të paarkëtueshëm ose të keq</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 ó “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, òKodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, neni 15 dhe 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve³, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit òPër Kundërvajtjet Administrative (brenda 2 viteve), duke u bërë përgjegjës për rritjen e nivelit të borxhit.</p>			<p>Sarandë që në zbatim të dispozitave ligjore të ligjit për procedurat tatimore dhe QKB, të mos lejojnë që për subjektet debitorë të bëhet mbyllja e aktivitetit ose lejimin e administratorëve për hapjen e aktiviteteve të tjera me Nipt tjetër, kjo për të eliminuar në maksimum borxhin e keq.</p>

³“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
20	<p>Në lidhje me abonentët familjarë situata është pak më mirë, kjo si rezultat i bashkëpunimit me agjentin tatimorë Ndërmarrjen e Ujësllës Kanalizime Sarandë. <i>Kështu:</i></p> <p>Për periudhën 2015 ó 2021 është faturuar gjithsej vlera 558,989,049 lekë, nga e cila: tarifë shërbimi 350,056,918 lekë dhe taksa ndërtesë në vlerën 208,932,032 lekë. Janë likuiduar për këtë periudhë shuma 474,057,147 lekë, kjo sipas akt akordimeve mujore dhe vjetore me agjentin tatimorë, duke mbetur për likuidim shuma 84,931,902 lekë për 16067 familje, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.</p> <p>Referuar të dhënave të paraqitura mbi likuidimet, konstatohet se sipas akt akordimeve që abonentët familjarë të kenë paguar më shumë se detyrimi, gjë e cila nuk mund të ndodh, <u>por nga DTTV Bashkia Sarandë nuk ka informacion të saktë mbi debitorët familjarë që janë të kontabilizuar në Ndërmarrjen e Ujësllës Kanalizime sha.</u></p> <p>Gjithashtu, konstatohet se nga DTV Bashkia Sarandë, nuk ka informacion mbi familjet që janë pa kontratë me ujësllësin, duke mos aplikuar detyrimet fiskale për taksat e tarifave vendore.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, me ndryshime.</p>	I lartë	43-65	Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë të bashkërendojë punën me Ndërmarrjen e Ujësllës Kanalizime Sarandë, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur më 31.12.2021 prej 84,931,902 lekë.
21	<p>Nga të dhënat konstatohet se në vitin 2021 kemi një rënie të nivelit të arkëtimeve nga taksa e ndikimit të infrastrukturë (TNI), ku nga 113,920 mijë lekë të arkëtuara në vitin 2020 në vitin 2021 është arkëtuar vlera prej 55,704 mijë lekë, kjo si rezultat i uljes së kërkesave për leje ndërtime.</p> <p>Në këtë zë bën pjesë dhe taksa nga ndërtimet e reja (ALUIZNI), ku referuar të dhënave, detyrimi për këtë taksë në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën 74,206,014 lekë.</p> <p>Vlera prej 74,206,014 lekë, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë, ku në mënyrë analitike, pasqyra në Drejtorinë e Taksave Vendore.</p> <p>Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia Sarandë ti jetë drejtuar ASHK Dega Sarandë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes e lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 òPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje.</p> <p>Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, òPër legalizimin,</p>	I lartë.	43-65	<p>Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e PZHT Bashkia Sarandë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej 74,206,014 lekë, sipas listës që disponon DTV Bashkia Sarandë.</p> <p>Kryetari i Bashkisë Sarandë nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'ò kërkojë ASHK-së Drejtoria Rajonale Sarandë, që të mos pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.</p>

Gjetja Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Rëndësia	Referenca me Raportin	Rekomandimi
	urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeë i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, neni 23, pika 2/1 e nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, òPër sistemin e taksave vendoreë të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 òPër përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizimë i ndryshuar.			

I.2. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

- Në përfundim të auditimit të pasqyrave financiare (bilance) të vitit 2021, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, arrin në konkluzionin për një **opinionit të modifikuar/kualifikuar**, për llogaritë vjetore të Bashkisë Sarandë, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura.

- Në zbatimin e procedurave të prokurimit për periudhën 01.01.2021 ó 31.12.2021, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, mbi të cilat është rënë dakord (*kriteret e auditimit të përputhshmërisë*), mbi bazë testimesh, të dokumenteve që vërtetojnë veprimtarinë e subjektit Bashkia Sarandë bazuar në analizën e riskut⁴, janë konstatuar disa anomali në vendosjen e kriterëve dhe shpalljen fitues të OE me kriterë jo të plotësuar, *materiale dhe të përhapura* që janë baza për dhënien **enjëopinionit të kundërt**, në paligjshmëri të përdorimit të fondeve publike me vlerë **362,987 mijë lekë**.

Gjithashtu:

- Në fushën e menaxhimit të të ardhura, janë evidentuar veprime në mospërputhje me kuadrin ligjor me efekt financiar prej **528,143 mijë lekë**, nga e cila: mungesë të ardhura me vlerë 49,645 mijë lekë dhe mos arkëtim debitorë me vlerë 476,428 mijë lekë.

- Mos zbatim i kushteve të kontratës në zbatimin e afatit dhe mos kryerjen e punimeve sipas preventivit me vlerë **10,052,650 lekë**, si dëm ekonomik në buxhet.

- Mos llogaritje e saktë e fondit limit, duke renduar buxhetin me vlerë **2,509,000 lekë**, si dëm ekonomik.

- Rëndim të TVSh kreditore të makinerive e pajisjeve me vlerë **249,000 lekë**, si dem ekonomik.

Për këto u analizuan pyetësorët e vetëvlerësimit, akt akordimin me thesarin, u krye analiza e posteve të bilancit dhe llogarive analitike me formatet shoqëruese të tyre, duke prekur zonat e llogarive, 600-paga; 202- Studime dhe kërkime; 401-408-Furnitorë e llogari te lidhura me to; 467-Kreditore te ndryshëm; 602-shpenzime operative; 215-Mjete transporti; 218-Inventar ekonomik; 32-Objekte inventari dhe 230- 231-investime.

OPINIONI I AUDITIMIT

I. Opinioni i pasqyrave financiare viti 2021:

⁴Sipas ISSAI 1315 (ISA 315), objektivi i audituesit është të verifikojë dhe vlerësojë risqet e mospërputhshmërisë me ligjet dhe rregullat në fuqi, duke siguruar kështu bazën për hartimin dhe zbatimin e procedurave të auditimit.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përmbledhëse vjetore të konsoliduara të Bashkisë Sarandë për vitin e ushtrimor 01.01.2021 - 31.12.2021, ku përfshihet pasqyra e pozicionit financiar, performancës financiare, pasqyra e flukseve monetare, ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto etj., në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në to, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të tyre si dheshënime dhe relacioni për llogaritë që shoqëronin këto pasqyra.

*“Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të **modifikuar/ kualifikuar**⁵ për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Sarandë, duke arritur në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2021”, të shprehura në bazën për opinion (trajtuar më poshtë).*

Baza për opinion:

Në planifikim ne kemi llogaritur vlerën e materialitetit, bazuar në ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke marrë parasysh riskun e lartë të auditimit, ndaj të cilit për të marrë një siguri të arsyeshme, audituesi duhet të tolerojë një normë më të ulët të gabimit material. Materialiteti i llogaritur nga audituesit e Kontrollit të Lartë të Shtetit bazuar në Manualin e Auditimit Financiar të KLSH-së për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 është 11,658 mijë lekë.

Nga auditimi i pasqyrave financiare të vitit 2021, u evidentuan gabime materiale të cilat individualisht dhe si shumë janë nën nivelin e materialitetit të përcaktuar për vitin financiar të mbyllur në 2021, gabime *materiale por jo të përhapura*, fakt ky që përbën bazën për opinion (ISA-705; ISSAI-1705). Për këto arsye kemi dhënë opinion të **modifikuar/ kualifikuar**, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

- Në gjendjen e konsiderueshme të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” prej 481,241,985 lekë, përveç debitorëve të taksave ka ndikuar dhe vlera e lartë e gjendjes në vlerën 162,031,719 lekë të debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të rekomanduara nga KLSH në vite për Bashkinë dhe ish-Komunat, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkitimit.

- Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 14,433,919 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 112 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme..

- Nga analiza e inventarit kontabël të llogarisë 210 “Toka Troje Terrene”, konstatohet se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 14 artikuj aktive materiale në vlerën 38,081,192 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa Konstrukione”.

- Në inventarin kontabël të llogarisë 212 “Ndërtesa Konstrukione” janë kontabilizuar gabim 8 artikuj aktive materiale në vlerën 9,074,339 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 7,343,493 lekë, llogarisë 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 1,730,846 lekë. Gjithashtu vlera prej 1,761,146 lekë është emërtuar *ōAktive te trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)ō*, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson..

⁵Audituesi duhet të shprehë një opinion të kualifikuar:

Kur audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë; ose

2. kur audituesi nuk është në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit ku të bazojë opinionin, dhe efektet e mundshme mbi llogaritë vjetore apo transaksionet të kësaj pamundësie janë materiale por jo të përhapura

- Në inventarin kontabël të llogarisë 213 “*Rrugë, rrjete, vepra ujore*”, janë kontabilizuar gabim 19 artikuj aktive materiale në vlerën 48,367,346 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 212 “*Ndërtesa Konstruksione*” në vlerën 36,403,544 lekë dhe llogarisë 210 “*Toka, Troje, Terrene*” në vlerën 11,963,802 lekë. Gjithashtu vlera prej 29,568,137 lekë është emërtuar “*Rikonstruksionë*, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.
- Në inventarin kontabël të llogarisë 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” janë kontabilizuar gabim 7 artikuj aktive materiale në vlerën 3,766,818 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 218 “*Inventar Ekonomik*”.

II. Opinioni mbi përputhshmërinë.

Në audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Sarandë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Sarandë, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës.

“Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Sarandë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale dhe të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të kundërt të përputhshmërisë.

Baza për opinion:

Auditimi u krye në përputhje me Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), të cilat janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, subjekti i audituar në një pjesë të procedurave nuk ka vepruar në përputhje me aktet ligjore/ nënligjore në fuqi, veprime të cilat kanë sjellë anomali materiale por jo të përhapura, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e *opinionit të kundërt*, pasi kriteret nuk janë vendosur në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe se OE/BOE të shpallur fitues nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST miratuara nga AK, për të cilën KVO duhej të anulonte procedurat dhe vijonte me procedura të reja, kjo për të rritur numrin e OE pjesëmarrjes në procedura dhe mundësinë e përdorimit të fondeve me efektivitet, ekonomikitet dhe efikasitet (3-E) me vlerë 362,987 mijë lekë.

- Në fushën e menaxhimit të të ardhura, janë evidentuar veprime në mospërputhje me kuadrin ligjor me efekt financiar prej **514,546 mijë lekë**, nga e cila: mungesë të ardhura me vlerë 38,117 mijë lekë dhe mos arkëtim debitorë me vlerë 476,428 mijë lekë.

- Mos zbatim i kushteve të kontratës në zbatimin e afatit dhe mos kryerjen e punimeve sipas preventivit me vlerë **10,317,550 lekë, si dëm ekonomik në buxhet.**

- Mos llogaritje e saktë e fondit limit, duke renduar buxhetin me vlerë **2,509,000 lekë.**

- Rëndim të TVSh kreditore të makinerive e pajisjeve me vlerë **249,000 lekë**, si dëm ekonomik në buxhet.

Ne besojmë se evidencat e auditimit që kemi siguruar janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme, për të siguruar bazën për opinion.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Sarandë:

Strukturat drejtuese të Bashkisë Sarandë, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (*kriteret e vlerësimit*). Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullativ në prokurimin e fondeve publike. Gjithashtu, strukturat drejtuese të Bashkisë Sarandë janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave

financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH-së:

Përgjegjësia e audituesit të KLSH-së është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijojmë bindje, të cilat do të shprehen në opinionin e grupit të auditimit mbi saktësinë, vërtetësinë dhe besueshmërinë e hartimit të pasqyrave financiare dhe raportimit financiar, nëse pasqyrat financiare janë përgatitur në të gjitha aspektet materiale në përputhje me kuadrin e rregullator të raportimit financiar. Audituesi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare dhe i përshkruan ato në raportin e auditimit. Siguria që jepet nga audituesi është një siguri e arsyeshme e cila është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet, mundëson identifikimin e çdo gabimi material apo anomalie që mund të ekzistojë.

II.HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *Ë*Për Organizimin dhe Funkcionimin e KLSH^o, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 370/1, datë 8.4.2022, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 8.4.2022 deri në datë 20.5.2022, në subjektin Bashkia Sarandë, për periudhën nga 01.01.2021 deri në 31.12.2021, u krye auditimi me objekt *Ë*Mbi auditimin financiar dhe përputhshmëri^o nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. K.GJ., *Përgjegjës Grupi*
2. I.SH., *auditues*
3. G.K., *auditues*

a- Objekti i auditimit, është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën 01.01.2021 ó 31.12.2021, të transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

b- Qëllimi i auditimit, është dhënia e opinionit dhe hartimi i Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse. Vlerësimi nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë, në të gjitha aspektet materiale ose jo dhe në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit e ushtron veprimtarinë subjekti që auditohet. Të identifikojë dhe vlerësojë zbatimin e kuadrin ligjor në fuqi, si dhe vlerësojë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)⁶.

Në bazë të vlerësimit të risqeve, nivelit të materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, në mbështetje të ISSAI 1700, ne synojmë të japim opinionin tonë mbi pasqyrat financiare, të shpenzimeve operative dhe investimeve mbi bazën e procedurave të prokurimit të realizuara për to, si dhe menaxhimit të të ardhurave, bazuar në vlerësimin e konkluzioneve të nxjerra nga evidencat e mbledhura.

⁶Në përputhje me kërkesat e Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

c- Identifikimi i çështjes: Ky Raport Auditimi, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmisimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Sarandë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektesë dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

d- Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar.

Strukturat drejtuese të Bashkisë Sarandë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjës për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditime brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

e- Përgjegjësitë e audituesve.

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe menaxhimit të të ardhurave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI sipas INOTSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryej auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, sipas evidencës së mbledhur të auditimit.

f- Kriteret e vlerësimit.

- ✓ Legjislacioni bazë e dytësor, dhe dispozita të tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe iu jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit;
- ✓ Ligji organik i KLSH-së nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *“Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;*
- ✓ Rregullore e Brendshme *“Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ të KLSH-së”*, miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 85, datë 30.06.2015 e ndryshuar;
- ✓ Rregullore e Brendshme *“Mbi Procedurat e auditimit në KLSH”*, miratuar me vendimin nr. 107, datë 08.08.2017 të Kryetarit të KLSH-së ndryshuar me nr. 63, datë 22.6.2020;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
- ✓ Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi "Auditimin e përputhshmërisë", Manuali i Auditimit Financiar dhe Përputhshmërisë, të miratuar nga Kontrollit i Lartë i Shtetit;
- ✓ Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *“Për financat e vetëqeverisjes Vendore”;*
- ✓ Ligjinr. 137/2020, datë 16.11.2020 *“Për buxhetin e vitit 2021”*, i ndryshuar dhe aktet normative që e ndryshojnë këto ligje;
- ✓ Udhëzimin i MF nr. 22, datë 30.07.2018 *“Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit të Njësive të vetëqeverisjes vendore”*, i ndryshuar;
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 26, datë 27.12.2007, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e MF nr. 14, datë 28.12.2006”;*
- ✓ Udhëzimi i MF nr. 5, datë 21.2.2022 *“Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”;*
- ✓ Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2000, datë 23.12.2000 *“Për Prokurimin Publik”;* VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik dhe Udhëzimi i APP nr. 2, datë 24.04.2017 “Për procedurën e prokurimit me vlerë të vogël”;* etj. dhe kuadri rregullues i brendshëm i bashkisë.

g- Standardet e auditimit:

- ✓ ISSAI 100 *“Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”*, që përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi;
- ✓ ISSAI 400 *“Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”*, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ✓ ISSAI 4000 *“Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”*; si dhe ISSAI 4200;
- ✓ Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC;
- ✓ Praktika të mira të fushës si: Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t,
- ✓ INTOSAI *“Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”*; etj.
- ✓ Manuali i Auditimit Financiar dhe të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve; Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI *“Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”*; etj.

h- Metodatat e auditimit:

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim. (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të UMF nr. 30, dt. 27.12.2011 oMbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminon përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët.

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna *“jashtë normales”*, që përbëjnë tregues të parregullsive kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

8. Raporte dhe Informacione

9. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm.

i-Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit.

Mbështetur në ISSAI 1315, objektivi i audituesit është identifikimi dhe vlerësimi i risqeve e anomalive materiale në pasqyrat financiare si edhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale.

Në këtë kontekst merr rëndësi vlerësimi i materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, i cili përcakton nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për të audituar, ku si bazë për përlogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga (600), shpenzimet operative (602) dhe shpenzimet për investime (231), ku vlera e precizonit për vitin 2021 është në shumën 11,658 mijë lekë (gabim lejuar), të dhëna të paraqitura në *Aneks 1 bashkëlidhur Projekt Raport Auditimit*.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e Audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH⁷ aplikon⁷.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej **5%**, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (**ISSAI 1520**) dhe testeve thelbësore të kryera.

Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ ditarë/ partitarë, ose në trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur; *dhe së fundi kërkimi/hetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

j- Dokumentimi i auditimit:

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

⁷Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

Me shkresën nr. 370/5, datë6.6.2022, nga grupi i auditimit të KLSH është nisur Projektraport Auditimi në të cilën u evidentuan mangësitë e konstatuara gjatë procesit të auditimit, mangësi të cilat nuk gjeten argument dhe nga observacionet e paraqitura nga subjekti në fazën e aktkonstatime.

Me shkresën nr. 2524/2, datë4.7.2022(*prot KLSH nr. 370/6, datë6.7.2022*), nga subjekti Bashkia Sarandë u paraqitën kundërshtitë e Projektraport Auditimit, të cilat pasi u lexuan nga grupi, gjetjet mbi për të cilat nuk kishin argumentin e duhur ligjorë gjejnë pasqyrim në këtëRaport Përfundimtar Auditimi, i cili i përcillet subjektit për përmisimin e gjendjes në të ardhmen.

III.PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacioni i Përgjithshëm:

Auditimi në BashkinëSarandë u krye në kuadër të planifikimit vjetor të subjekteve të përzgjedhura për tu audituar. Në këtë subjekt, u evidentuan shmangie dhe të meta në fushën e financës *materiale po jo të përhapura*,si dhe të meta e dobësi në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat dhe kriteret e vlerësimit sipas kuadrit rregullator në fuqi të shoqëruara me shpenzime jo sipas 3-E, në fushën e prokurimevedhe menaxhimit të të ardhurave.


Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, të reflektuara në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e konkluzioneve.

Dokumentacioni i marrë për auditimin është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e Audituesve dhe shërbeu si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Në përgatitjen e materialit dokumentar për planifikimin e auditimit, grupi i auditimit i është referuar auditimeve të kryera në periudhat e mëparshme, dokumentacionit të kërkuar dhe paraqitur nga subjekti, të dhënat e grumbulluara për demografinë, fondet e realizuara nga kjo njësi vendore të publikuara në faqen e Thesarit të Ministrisë së Financave dhe të APP, për realizimin e prokurimit me fonde publike dhe të ardhurat e veta, aktivitetet kryesore dhe problematikat e trajtuara nga media, të realizuara këto nëpërmjet hulumtimeve dhe kërkimeve në internet dhe në median vizive.

Bashkia Sarandë është e organizuar dhe funksionon në bazë ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 òPër Vetëqeverisjen Vendoreò dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 òPër financat e vetëqeverisjes Vendoreò, Rregulloren e funksionimit të Bashkisë dhe akteve të nxjerra nga Këshilli Bashkiak Sarandë.

Bashkia Sarandë është një institucion i rëndësishëm, i cili funksionon në bazë të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 për vetëqeverisjes vendore dhe ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 për financat e vetëqeverisjes vendore. Në kuadër të reformës territoriale, **Bashkia Sarandë** ka pësuar ndryshime të konsiderueshme në sipërfaqe, në territor dhe në popullsinë e saj, ku veçori kryesore është dhe bashkimi i territorit të njësisë administrative e Ksamilit me të.



Bashkia Sarandë përbëhet nga qytetet e Sarandës dhe qytezën e Ksamilit si dhe nga fshatrat Çukë, Metoq, Gjashtë dhe Shelegar. Pas ndryshimeve si rrjedhojë e reformës territoriale, **Bashkia Sarandë** gjendet në një situatë ku parashikohet një zgjerim i territorit ekzistues si dhe i popullsisë banuese. Sipërfaqja administrative e saj arrin në rreth **5200 ha**, me një rritje gati **dy here** dhe popullsia civile arrin në **55000 banorë**.

Qyteti i Sarandës ka **36500 banorë**.

Saranda, është një ndër destinacionit kryesore turistike për Shqipërinë prandaj është e nevojshme hartimi i një vizioni të qartë mbi të cilin të bazohet edhe strategjia vendore e turizmit. *Forcimi i pozicionit të bashkisë në fushën e turizmit në raport me destinacionit e tjera rajonale, dhe vendosja e një raporti të drejtë midis konkureshmërisë dhe komplimentaritetit* është një ndër pikat më të rëndësishme për të cilat nevojitet vizioni strategjik. Zhvillimi intensiv urban, ka krijuar mundësinë që në qytet të vendosen një numër i konsiderueshëm strukturash hotelerie të cilat e shndërrojnë Sarandën (së bashku me Ksamilin) në një prej destinacioneve më të rëndësishme turistike. Në këtë fushë kërkohet një ridimensionim e mbështetje për zhvillimin e infrastrukturës publike e veçanërisht të asaj rrugore, ku mbulohen vetëm 40-45 % e nevojave.

Rehabilitimi dhe vitalizmi i zhvillimit urban i gjithë qytetit e zonës përreth mund të përmirësojë përbërjen urbane dhe të rritë asetet e kapacitetet ekzistuese. Rritja e strukturave standarde do të përmirësojë sistemin urban e peisazhin e qytetit si dhe rrit imazhin e tij.

Për zhvillimin e territorit, Bashkia synon krijimin e centraliteteve të reja në territorin e ri të Bashkisë. Në këtë mënyrë do të eficientohet ofrimi i infrastrukturës dhe përmirësimi i cilësisë së jetesës duke rritur aksesueshmërinë në shërbime dhe hapësira publike. Saranda policentrike mbron dhe lejon mirë menaxhimin dhe valorizimin e resurseve natyrore si dhe të tokave bujqësore. Gjithashtu me anë të aplikimit të policentrizmit, mundësitë për rritjen e kohezionit territorial janë reale dhe të mundshme. Në mbështetje të idesë së policentrizmit do të krijohet gjatë viteve në vijim dhe brezi i gjelbër i Sarandës i cili do të kufizojë shpërhapjen e vendbanimeve si dhe do të rrisë kapacitetin e gjelbër të Bashkisë e të krejt zonës turistike.

Aksesueshmëria e Bashkisë do të rritet duke përmirësuar dhe ndërlidhjet me portin dhe në një periudhë afatmesme me aeroportin. Transporti publik kërkohet të përmirësohet dhe të shtohet në mënyrë që ti përgjigjet kërkesave në rritje të banorëve dhe të turistëve. Parkimi në bashki do të përmirësohet duke ndihmuar në zbutjen e efekteve të trafikut të rënduar, veçanërisht gjatë periudhës së verës.

Cilësia e mjedisit dhe e jetës duhet të vazhdojë të përmirësohet duke rritur aksesin në hapësira të gjelbëra dhe gjelbërim, duke përcaktuar kufirin e brezit të gjelbër i cili të mbrohet dhe pasurohet me bimësi të ndryshme për të rritur cilësinë e mjedisit dhe frymëmarrjen e vendbanimeve urbane.

Ekonomia mbështetet në zhvillimin e saj, duke *promovuar turizmin dhe bujqësinë*. Kujdes i veçantë duhet treguar për integrimin e brezave të reja në ekonomi, dhe krijimin e mundësive për iniciativat në kuadër të rritjes së ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

Pika 2.1 e programit. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin.

Titulli gjetjes 1: *Mbi mangësitë e konstatuara në funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.*

Situata:

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm sipas komponentëve u konstatua se në lidhje me:

“Mjedisin e kontrollit”

Bashkia Sarandë nuk ka Kod të Etikës. Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, Mungon një program strategjik institucional me prioritetet dhe objektivat dhe plan-veprimet e realizimit të tyre. Mungon dokumentacioni që vërteton se GSM është mbledhur dhe është angazhuar për monitorimin e sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Rregullorja e brendshme e miratuar me VKB nr.34 datë 05.06.2008 është shumë e vjetër dhe nuk përshtatet me strukturën organike aktuale, por Projekt-Draft Rregullorja e Re e Brendshme e hartuar është e cila edhe kjo është e mangët, pasi mungon Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit të Bordit të Kullimit. Përshkrimet e punës nuk janë rishikuar për çdo vit dhe nuk janë miratuar në DAP. Nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve, si dhe mungon një program trajnimi për to.

“Menaxhimi i Riskut”

Është përcaktuar koordinatori i riskut, dhe është hartuar regjistri i riskut, ku janë identifikuar dhe vlerësuar risqet vetëm në fushën e taksave detyrimeve dhe prokurimeve dhe jo në të gjitha fushat. Nuk është bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut. Nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

“Aktivitetet e Kontrollit”

Bashkia Sarandë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve

“Informimi dhe Komunikimi”

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen e b mungon programi i transparencës. Gjithashtu mungon edhe regjistri me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve.

“Monitorimi”

Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Auditimi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm.

Kriteri:

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 për Menaxhimin financiar dhe kontrollin e ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e

Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitullin III, pika 3.1. ligjit nr. 119/2014 -Për të drejtën e informimit nën 4,8.

Impakti:

Mosnjohje e plotë dhe sa duhet i koncepteve të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin nga niveli i lartë drejtues i kriterëve të MFK, duke sjellë një nivel mesatar të riskut të funksionit të sistemeve të kontrollit të brendshëm.

Shkaku:

Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin në drejtim të njohjes së dispozitave të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.

Rëndësia: i mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Bashkia Sarandë, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë risqeve; për miratimin dhe përmirësimin e rregullores së brendshme në përshtatje me strukturën organike; të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara dhe ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara; gjithashtu zhvillimin e programeve të trajnimeve nga punonjës brenda Bashkisë si dhe të punohet për plotësimin e kërkesave të komponentëve të MFK.

Nënpika 2.1.2 e programit. Mbi vlerësimin e Auditimit të Brendshëm Publik.

Organizimi dhe Funkcionimi: Bazuar në VKM nr. 83, datë 03.02.2016, për miratimin e kriterëve për ngritjen e NJAB në sektorin publik Bashkia Sarandë ka ngritur NJAB. Për vitin 2021 NJAB ka funksionuar me 1 drejtues dhe 2 punonjës, sipas strukturës organizative të përcaktuar nga Titullari i Bashkisë me Urdhrin nr. 14 datë 09.02.2020 mbi bazën e miratimit me VKB nr.204 datë 24.12.2020.

Detyrat dhe kompetencat e NJAB janë përcaktuar në Projekt-draftin e Rregullores së Brendshme të funksionimit të Administratës së Bashkisë Sarandë akoma të pa miratuar mbi bazën e të cilës funksionojë të gjitha strukturat e Bashkisë. Struktura e NJAB, niveli i arsimit, certifikimi, përvoja dhe trajnimet e audituesve paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

PERIUDHA 2021	FUNKSIONI	ARSIMIMI	VJ ETËRSI NE PUNE	VJETË RSI NË AUDITIM/VIT E	CERTIFIKIMI	TRAJNIME TE VIJUESHME
M.M.	DREJTOR	EKONOMI FINANCE	42	11	CERT.2012	PO
K.H.	SPECIALISTE	EKONOMI STATISTIKE	34	5	CERT.2018	PO
S.P.	SPECIALISTE	EKON.ADMIN.BIZN	6	3	CERT.2021	PO

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjeve të punonjësve të strukturës së Auditit të Brendshëm rezulton se këta punonjës janë të certifikuar dhe kanë ndjekur në mënyrë të vazhdueshme trajnime për kualifikimin profesional të tyre, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 për auditimin e brendshëm në sektorin publik nën 11, për Punësimin e Auditit të Brendshëm, neni 19 për Certifikimin e Audituesve të brendshëm dhe neni 20 për Trajnimin e vijueshëm profesional të Audituesve të brendshëm.

- Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik.

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik ka hartuar Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik në Bashkinë Sarandë, e cila është miratuar nga titullari.

- Planet Strategjike dhe Vjetore:

Në mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik janë hartuar dhe miratuar planet strategjike sipas viteve:

Per vitin 2021 me shkresën nr.4264, datë 12.10.2020 është miratuar plani strategjik për vitet 2021 ó 2023 dhe plani vjetor i auditimeve për vitin 2021.

Këto plane janë dërguar zyrtarisht (*por edhe me postë elektronike*) në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, në përputhje me Ligjin nr.114/2015, datë 22.10.2015 oPër auditimin e brendshëm në sektorin publikó, si dhe urdhrin e Ministrit të Financave nr. 100, datë 25.10.2016 oPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikó.

-Realizimi i Planeve Vjetore:

Për vitin 2021 janë parashikuar gjithsej 8 auditime në Drejtori dhe NJA, ku sipas llojit janë të përputhshmërisë dhe financiar. Plani i angazhimeve në fillim të vitit përputhet me realizimin e auditimeve në fakt si për nga numri, objekti dhe lloji, duke u realizuar në masën 100%. Nuk ka patur ndryshime. Realizimi e auditimeve paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT						
		Auditim e ta planifikuara	Auditime te realizuara	Nga te realizuarat, sipas llojit				
				Përputh	Financë	Kombinuar	Performancë	Tjera
4	Viti 2021	8	8	5	3			

Raportimi: Për veprimtarinë e NJAB Në Bashkisë Sarandë për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB te Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht: Me shkresën nr.86/1, datë 26.01.2022, është dërguar Raporti Vjetor i Veprimtarisë së NJAB, Bashkia Sarandë për vitin 2021. Të dhënat për realizimet e angazhimeve nga AB për auditimet e kryera paraqiten në tabelat e mëposhtme:

Nr	Subjektet e Audituar	Realizimi i angazhimeve të auditimit										
		Auditime të realizuara sipas llojit të tyre									Statusi i Angazhimit	
		Gjithsej	Shërbime të Sigurisë nga të cilat:					Shërbi me Këshillimi	Angazhi me me kërkesë të titullarit	Angazhi me të përfunduar	Angazhime në proces	
			A. të përputhsh mërisë	A. të performancë	A. financiare	A. tek. Informacionit	A. të kombinuara					
1	Dr.Ekon./Z/Ek/Arsim,N/Shërbi	1	1							1		
2	Drejt. Burimeve Njerëzore	1	1							1		
3	Drejt. Taksave dhe Tarifave Vendor	1	1							1		
4	Drejt.Planif.Zhvillimit Territorit	1	1							1		
5	Qendra e Kulturës	1		1						1		
6	Klubi i Futbollit B... sha	1		1						1		
7	Qendra Polivalente	1		1						1		
8	Subjekte audit.20, zbatim Rekoma	1	1							1		

- Gjetje-Rekomandimet

Një aspekt mjaft i rëndësishëm i aktivitetit auditues është dhënia e rekomandimeve në përfundim të auditimeve, ku:

Për vitin 2021 Nga auditimet janë evidentuar 36 gjetje, për të cilat janë dhënë 36 rekomandime, nga të cilat 33 janë rekomandime të karakterit organizativ dhe 3 rekomandime shpërbllim dëmi të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	PERIUDHA	TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT				SIPAS Raportimit			
		Rekomandime te shprehura ne numër				Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërbllim dëmi)			
		Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar	Gjithsej ne numër	Zbatuar	Ne proces	Pazbatuar
4	Viti 2021	36	24	12		3		3	
	TOTALI	0	0	0	0	3		3	

Të dhënat e gjetjeve sipas fushave të auditimit dhe subjekteve të auditimit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	SUBJEKTI AUDITUAR	GJETJET SIPAS FUSHËS OSE SISTEMEVE NE NUMER										
		Sistemi i prokurimeve, blerjeve & investimeve	Sistemi i pagesave, shpërblime, trajtime, komisione.	Fondet e sig. Shoq, sig.shendetesore, përkuajtjes shoqërore	Sistemet e tatimeve, taksave, doganave	Sistemet e administrimit pronës, pasurisë	Sistemet e privatizimit, shitjes, qiradhënies	Sistemet e koncesioneve, ankandeve	Sistemet e legalizimeve, urbanistikës, këhim pronash	Sistemet e kreditimit, subvencioneve	Të tjera	Audituesi mbuluar me auditim
1	Dr.Ekonom.Z/Ek/Arsim,Nd/Shërbime										5	3 special
2	Drejt. Burimeve Njerëzore										5	0
3	Drejt. Taksave dhe Tarifave Vendore				3						2	0
4	Drejt.Planif.Zhvillimit Territorit							2				0
5	Qendra e Kulturës	4	1			2					3	0
6	Klubi i Futbollit B... sha	3	2									0
7	Qendra Polivalente	1	1									0
8	Subjekte të audit.2020, zbatim i rekoma										2	0

Ndjekja e zbatimi i rekomandimeve për periudhën audituese është bërë sipas përcaktimeve të manualit të A.B. NJAB u ka dërguar shkresa njësisive të audituara për informim mbi nivelin e zbatimit të tyre dhe në auditimin e radhës është çështja e zbatimit të rekomandimeve trajtohet si çështje kryesore. Rekomandimet sipas llojit dhe statusit të realizimit në subjektet e audituara, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr	Subjekti Audituar	Rek. të dhëna në vitin 2021	STATUSI I REKOMANDIMEVE				REKOMANDIMET SIPAS LLOJIT				
			Rekomandim i dhënë	Rekomandim i pranuar	Rekomandim i zbatuar	Në proces zbatimi	Rekomandime të përmirësimit e sistemeve	Rekomandime të përmirësimit e kuadrit ligjor	Rekomandime të karakterit organizativ	Rekomandime për arkëtime	Rekomandime të tjera
1.	Dr.Ekon.,Z/Ek/Arsim,N/Shërbi	5		5	3	2	2	1	2		
2.	Drejt. Burimeve Njerëzore	5		5	3	2		5			
3	Drejt. Taksave dhe Tarifave Vendore	5		5	3	2	5				
4	Drejt.Planif.Zhvillimit Territorit	2		2		2				2	
5	Qendra e Kulturës	10		10	6	4	5		2	2	1
6	Klubi i Futbollit B... sha	5		5	5		2	1	2		
7.	Qendra Polivalente	2		2	2		1		1		
8.	Subjekte audit.20, zbatim Rekoma	2		2	2		2				

Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve, rezulton se nga 36 masa të rekomanduara, janë pranuar 36 rekomandime, nga këto 24 rekomandime janë zbatuar, 12 rekomandime janë proces zbatimi, ndërsa rekomandime të pa zbatuara nuk ka.

- Vlerësimi i procedurave dhe standarteve të kryerjes së auditimit të brendshëm.

Nga auditimi i detajuar i dosjeve të auditimeve të kryera në subjektet:

Për vitin 2021 dosjet: Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit Territorit, Klubi i Futbollit B... SHA, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, Qendra e Kulturës, Qendra Polivalente, Detyrimet e prapambetura (Drejtoria e Financës (Aparati), Zyra Ekonomike e Arsimit, Ndërmarrja e Shërbimeve), Zbatim i rekomandimeve.

- Në lidhje me respektimin e kërkesave të manualit në hartimin e materialeve të auditimit për:

a- Letrat e punës së auditimit në fazën përgatitore të programit ;

b- Letrat e punës në fazën e ekzaminimit të dokumentacionit të subjektit, hartimit të Projekt Raportit dhe Raportit Final nga audituesit ;

c- Bazueshmëri në ligjore të gjetjeve, argumentimin e konkluzioneve të nxjerra nga audituesit në përputhje me standartet e auditimit, rezultoi se nuk janë respektuar me kërkesat e ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 òPër auditimin e brendshëm në sektorin publikò neni 11, neni 12, shkronja òdò, neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave òPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikò i ndryshuar me Urdhrin e Ministrisë të MFE nr.4 datë 10.01.2020 òPër miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016ò, Kapitulli II 2.4.1 òAuditimi i përputhshmërisëò dhe 2.4.2 òAuditimi financiarò; Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1 òplanifikimi i një angazhimi auditimiò, pikës 4.1.11 dhe 4.1.12; kapitulli VI òEvidentimi dhe dokumentimi i punës auditueseò pika 6.1 òNiveli i dokumentimitò;

Në të gjitha dosjet e auditimit mungon MEMO e planifikimit, pra projektdrafti i programit të auditimit në fazën përgatitore të hartimit të programit të angazhimit.

- Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim òvlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07,2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar. Për pasojë nuk është bërë trajtimi si çështje më vehte vlerësimi dhe analizimi e komponentëve të kontrollit të brendshëm për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të qenë më të qarta rekomandimet për të ardhmen dhe të përfshihej opinioni i përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm (referuar dosjeve të shqyrtuara). Audituesit e Brendshëm nuk ka dhënë asnjë opinion të përgjithshëm mbi funksionimin dhe vlerësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për çdo sistem të audituar, vlerësimin dhe analizën e riskut, përcaktimin e faktorëve kryesorë në rezultatet e vlerësimit të riskut, si dhe kritereve për vlerësimin e nivelit të riskut (i lartë, i mesëm dhe i ulët).Opinionin e përgjithshëm për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm duhet të jetë prezent si në përmbledhësen ekzekutive dhe në memorandumun e çdo raporti angazhimi.

- Në gjetjet dhe rekomandimet përkatëse nuk janë reflektuar lidhjet organike gjetje-konkluzion dhe rekomandime. Opinionin e përgjithshëm mbi funksionimin dhe rezultatet e vlerësimit të sistemeve të audituar nuk e kanë paraqitur në përmbledhjen ekzekutive.

- Projektraporti i përcjellë subjektit të audituar nuk është shoqëruar me Formatin e sugjeruar të Plan-Veprimit për zbatimin e rekomandimeve.

- Në të gjitha dosjet nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim).

- Në disa raste rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirpërcaktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra ònë zbatim të akteve ligjoreò duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem. Për rekomandimet në të gjitha rastet nuk është përcaktuar nivelin i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët);

- Raportet nuk janë koncize në përmbajtjen e tyre ka rubrika dhe përshkrime jo korrekte, të panevojshme, ka përshkrime të gjata, të tepërta, të detajuara dhe të parëndësishme që nuk mbështesin dhënien e ndonjë opinionin apo vlerësim përfundimtar.

- Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi në të shumtën e rasteve situata e përshkruar është i karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë, hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si dhe nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë apo raportimit financiar për problematikën e konstatuar nga auditimi në kundërshtim me pikën 2.4.1 òAuditimi i përputhshmërisëò dhe 2.4.2 òAuditimi financiarò.

- Nga shqyrtimi i përmbajtjes së MEMO, rezulton se janë tejet të gjata dhe nuk janë një përmbledhje e shkurtër e Raportit Përfundimtar, nuk është e qartë se kur është dërguar titullarit para apo pas plan-veprimit (pa datë) të dërguar nga Subjekti i audituar, nuk paraqet konkluzionet dhe rezultatet pas vlerësimit të sistemeve të audituar, por vetëm gjetjet dhe rekomandimet e adresuara, si dhe i mungon dhënia e opinionit mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit dhe cilat sisteme janë vlerësuar me risk.

- Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Sektori i Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 nuk janë realizuar auditime në sistemet objekt auditimi, ku shfaqen problematika me prioritet të lartë risku si: në sistemin e pagesave, sistemin e prokurimeve, sistemin e raportimit të pasqyrave financiare, në sistemin administrimin dhe menaxhimin e aseteve etj.

Titulli gjetjes 1: *Mbi mangësitë e konstatuara në organizimin, funksionimin dhe aktivitetin e Auditit të Brendshëm.*

Situata:

Për periudhën 2021 realizimi i planit është në masën 100%. NjAB në hartimin e planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuar, por nuk ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve. Në të gjitha dosjet e auditimit mungojnë: projektdrafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit me të gjitha elementët e tij; Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim ÷vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të dhënë një opinion për funksionimin e kontrolleve në çdo sistem e për të qenë më të qarta rekomandimet; Në disa raste formulimi i gjetjeve ka mangësi, pasi situata e përshkruar është i karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, në ndonjë rast nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si apo nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë apo raportimit financiar për problematikën e konstatuar nga auditimi; Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirpërcaktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra ÷në zbatim të akteve ligjore, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve, të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem, në të gjitha rastet nuk është përcaktuar nivelin i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët). Projektraporti i përcjellë subjektit të audituar nuk është shoqëruar me Formatin e sugjeruar të Plan-Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Në disa raste nuk është në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar; Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Auditimit të Brendshëm për vitin 2021 mungojnë auditimet në sistemin e prokurimeve, në sistemin e pagesave sistemin e raportimit të pasqyrave financiare, në sistemin administrimin dhe menaxhimin e aseteve etj.

Kriteri:

Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 ÷Për auditimin e brendshëm në sektorin publikë neni 11, neni 12, shkronja ÷dö, neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave ÷Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publikë i ndryshuar me Urdhrin e Ministrit të MFE nr.4 datë 10.01.2020 ÷Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016, Kapitulli II 2.4.1 ÷Auditimi i përputhshmërisë dhe 2.4.2 ÷Auditimi financiar; Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1 ÷planifikimi i një angazhimi auditimi, pikës 4.1.11 dhe 4.1.12; kapitulli VI ÷Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese, pika 6.1 ÷Niveli i dokumentimit;

Impakti:

Mosrealizim dhe sigurim të cilësisë së veprimtarisë audituese të Auditit të Brendshëm.

Shkaku:

Realizimi i auditimeve jo në shkallën dhe nivelin e duhur në mospërputhje me kriteret e pranuar.

Rëndësia: i mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Njësia e Auditit të Brendshëm të kryejë një planifikim i auditimeve duke marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes të auditimeve, të realizojë auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Pika 2.2 e programit, Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

- Programimi i PBA 2020-2022 dhe programimi i buxhetit vjetor 2021

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2020-2022, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e grupit të punës, Grupi i Menaxhimit Strategjik me urdhër të Titullarit të institucionit, organizimin e mbledhjes së këtij grupi për përcaktimin e taveve të shpenzimeve sipas programeve.

Janë përcaktuar tendencat e politikave të shpenzimeve sipas funksioneve, si menaxhimi i mbetjeve dhe shërbimeve publike, pastrimi, gjelbërimi, ndriçimi, mirëmbajtja e segmenteve rrugore, programi i administrimit të pyjeve dhe bujqësisë, mirëmbajtja e kushteve për infrastrukturën arsimore, konvikteve, promovimi i politikave kulturore dhe sociale, zhvillimi i aktiviteteve kulturore dhe ekspozitave. Është bërë analiza për pagat dhe janë llogaritur pesha specifike e këtyre llojeve të shpenzimit me totalin.

-Fushat me prioritet në shpenzimet për investime:

- a. Përmirësimi i infrastrukturës dhe transportit
- b. Ndërtimi i veprave publike (ujësjellës)
- c. Rikonstrukcion të objekteve shkollore.
- d. Mirëmbajtje të rrugëve dhe ndriçimi i tyre, etj.

Janë organizuar seanca dëgjimore me qytetarët si dhe është prezantuar dokumenti i PBA me shoqërinë civile. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga Njësitë Administrative, sektorët e Bashkisë, sektori i shërbimeve etj. gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktik të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

PBA dhe buxhetet e miratuar në Këshillin Bashkiak, konkretisht:

PBA 2020-2022, bashkë me buxhetin vjetor 2020, janë miratuar me Vendim të KB nr. 43, datë 23/12/2019. Ndërsa buxheti vjetor 2021 është miratuar në Këshillin Bashkiak me vendim nr. 204, datë 24.12.2020 dhe konfirmuar nga Institucioni i Prefektit Qarku Vlorë me shkresën nr.12/1, datë 18/01/2021.

Tabela 1. Tëdhëna mbi të ardhurat në 000/lekë

Nr.	Përshkrimi	Plani i Viti 2020		Plani i Viti 2021	
		Të ardhurat	Shpenzime	Të ardhurat	Shpenzime
1	Të ardhura të trashëguara nga viti paraardhës nga te ardhurat	124,506		143,792	
2	Transferta e pakushtëzuar trashëguar viti paraardhës	90,876		40,882	
3	Trashëguar nga transferata specifike	6,723		5,326	
4	Të trashëguara nga FZHR				
5	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	426,500		432,000	
6	Granti	544,131		570,312	

Nr.	Përshkrimi	Plani i Viti 2020		Plani i Viti 2021	
		Të ardhurat	Shpenzime	Të ardhurat	Shpenzime
7	Transferta specifike	101,989		103,707	
8	Paga (600) + sigurime shoqërore (601)		292,534		300,433
9	Shpenzime operative (602)		294,192		333,189
10	Investime (230+231) nga të ardhurat dhe tr.e pakushtëzuar		251,499		217,275
11	Fondet emergjencë dhe fondet rezervë		5,000		5,000
12	Investime (230+231) nga buxheti i shtetit		200,000		200,000
13	Shpenzime (603+604+606)		251,500		240,122
Totali i buxhetit		1,294,725	1,294,725	1,296,019	1,296,019

Krahasimi i planeve buxhetore me PBA respektive:

Tabela 2. PBA 2020-2022 me planin buxhetor 2021, paraqitet në tabelën e mëposhtme

Në 000/lekë

Nr.	Përshkrimi	Plan përfundimtar 2021	Sipas PBA 2020-2022	Diferenca
1	Shpenzimet për pagat (600+601) ó nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	300,433	294,095	6,338
2	Shpenzimet (602, 604, 609) ó nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	578,311	548,588	29,723
3	Investime ó nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	217,275	117,410	99,865
4	Investime nga FZSHS	200,000	962,706	- 762,706
Total i planit fillestar		1,296,019	1,922,799	- 626,780
Shtesat dhe ndryshimet gjatë vitit			-	-
5	Shpenzime për pagat (600+601) ó nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	-	-	-
6	Shpenzime (602, 604, 606,609) ó nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	-	-	-
7	Investime nga Bashkia ó nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	-	-	-
8	Investime nga FZSHS	-	-	-
9	Pagesa 5 % garanci	-	-	-
Totali shtesa + ndryshime		-	-	-
Plani përfundimtar				
	Shpenzime për pagat (600+601) ó nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	300,433	294,095	6,338
	Shpenzime (602, 604,606, 609) ó nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar e specifik	578,311	548,588	29,723
	Investime nga Bashkia ó nga të ardhurat e grant i pakushtëzuar	217,275	117,410	99,865
	Investime nga FZSHS	200,000	962,706	- 762,706
	Pagesa 5 % garanci	-	-	-
Shuma e planit vjetor		1,296,019	1,922,799	- 626,780

- Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas Akteve Normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondeve të çelura.

Në programin buxhetor është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Qeverisja të granteve nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit.

gjatë vitin 2021, nga Bashkia Sarandë nuk janë kryer ndryshim në buxhet, gjë e cila tregon se planifikimi është bërë sipas nevojave të bashkisë.

Në hartimi e projekt buxhetit vjetor, janë marrë në konsideratë kërkesat e dokumentuara të sektorëve, kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse *ËPër procedurat standarde të zbatimit të buxhetit*.

Akordimi fillestar i buxhetit janë të rakorduar me Degën e Thesarit Sarandë dhe janë të raportuara periodikisht pranë Degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

- Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Sarandë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Sarandë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektive të realizuar me Vendim të KB, ose të diktuar nga Transferta e deleguara nga pushteti qendror, si dhe rishikimet e buxhetit e rritjet e limit nga të ardhurat e realizuara, u konstatua se si në planifikim dhe në realizimin është respektuar disiplina buxhetore.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit periudha 2021 referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Përshkrimi	Viti 2020			Viti 2021		
		Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
1	600 ó Paga	249,152	223,885	90	256,572	231,071	90
2	601 ó Sigurime shoqërore	41,990	37,472	89	43,861	38,596	88
3	602 ó Shpenzime operative	294,192	176,245	60	333,189	235,770	71
4	Totali shpenzime të tjera ó (606, 604, 609)	34,108	26,461	78	19,671	15,233	77
5	Ndihma ekonomike	223,284	231,174	104	225,000	225,000	100
6	Investimet (230 + 231)	451,499	162,530	36	417,275	294,617	59
7	Shpërblime lindje ó 606	500	456	91	451	451	100
8	466 ó Garancitë		25,311			34,946	
Totali		1,294,725	883,534	68.2	1,296,019	1,075,684	82

Titulli gjeties 1: *Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli pa garantimin e fondeve për kryerjen e tyre.*

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2021, konstatohet senë total është realizuar në masën 82%, ku nga vlera e planifikuar për zbatim në shumën 1,296 mijë lekë është realizuar në shumën 1,075,684 lekë, ku zëri investime paraqitet në masën 59%, shpenzimet operative në masën 71% dhe shpenzime për paga në masën 90%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara për vitin **2021**, nga vlera planifikuar prej **417,275 mijë lekë** është realizuar vlera prej **294,617 mijë lekë**.

Referuar të dhënave, rezulton se në totalin e procedurave të zhvilluara për vitin 2021 me vlerë të larta, Bashkia Sarandë me të ardhurat e veta mbulon 19%, ku nga vlera e kontratave të lidhura prej 110,616 mijë lekë është likuiduar vlera prej 89,307 mijë lekë, **pra me një diferencë në vlerën 21,309 mijë lekë**.

Pjesa tjetër e kontratave të lidhura e cila paraqitet në vlerën 402,550 mijë lekë, është me financim nga Ministrinë e Linjës dhe FZHR, ku për vitin ushtrimorë 2021 është planifikuar për likuidim vlera 98,059 mijë lekë, duke respektuar kufirin e 20% dhe nga kjo vlerë është likuiduar vlera 78,259 mijë lekë ose më pak për shumën 19,800 mijë lekë, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit. *(Të dhënat e mësipërme paraqiten në Aneksin 2.1, bashkëlidhur Raport Auditimit)*

Mos zbatimi i kontratave të lidhura dhe planifikuara në buxhetin respektiv të vitit 2021, nga të ardhurat e veta, vjen si rezultat i mos planifikimit të të ardhurave për likuidimin e këtyre faturave, pasi një pjesë është destinuar për pagesën e detyrimeve të prapambetura nga vitet e kaluara. Gjithashtu sipas Drejtorisë Ekonomike, kjo vjen për faktin se nga subjektet zbatuese dokumentacioni shoqërues nuk është në përputhje me ligjin, pasi ka mangësi në plotësimin e tij. Këto veprime vënë bashkinë në vështirësi financiare, si dhe rrisin detyrimet kreditore në fund të periudhave ushtrimore (fatura të palikujduara), ku pavarësisht se vijnë në ulje nga njëra periudhë në tjetër përsëri më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 30,401,541 lekë.

Kriteri:

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 *“Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime, duke ngarkuar me përgjegjësi: T.S., me funksion Drejtor Financë/Buxhet.*

Ndikimi/Efekt:

Rritjen e nivelit të faturave kreditore në fund të periudhës dhe vënien në vështirësi të bashkisë në vitin vijues në planifikim e shpenzimeve në interes të bashkisë.

Shkaku:

Planifikimi i procedurave pamundësuar fondet në dispozicion si dhe mos paraqitja e rregullt e faturave nga subjektet zbatuese.

Rëndësia: E mesme

Për këtë rekomandojmë:

- Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse, si dhe të monitorohet ecuria e të ardhurave, duke vlerësuar risqet që mund të ndikojnë në mosrealizimin e vlerës së planifikuar dhe mbi bazën e tyre.
- Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrë masa që shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim i plotë në kontabilitet.
- Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, për të gjitha rastet e paraqitjes nga subjekti zbatues me vonesë të faturave për likuidim të situacioneve mujore, progresive ose

përfundimtare, me dokumentacion jo të rregullt dhe në kundërshtim me kushtet e kontratës, tëaplikohej penalitet (kamatëvonesë) për deklarim me vonesë, si dhe t'aj kërkohet DrejtorisëRajonale Tatimore Dega Sarandë zbatimin e procedurave përmos deklarim në afat tëTVSh në shitje nga mos depozitimi i faturës në afatin e caktuar sipas ditarit të punimeve.

- Miratimi i buxhetit faktik

Në fund të periudhave ushtrimore nga Bashkia Sarandë janë miratuar buxhetet faktik. Në relacionet përfundimtare të zbatimit të buxhetit janë hartuar vetëm realizimin e treguesve buxhetorë për të ardhurat dhe shpenzimet dhe nuk shoqërohen me analizë faktoriale për realizimet e fondeve dhe rekomandimet për përmisimin e situatës.

- Fondi rezervë dhe kontigjencës

Me miratimin e buxheteve është parashikuar dhe miratuar fondi rezervë/dhe kontigjencës, ku për vitin, për vitin **2020**, është miratuar në vlerën 5,000 mijë lekë, e cila nuk është përdorur. Për vitin **2021**, është miratuar në vlerën 5,000 mijë lekë, dhe nuk ka shtesa në buxhet gjatë vitit. Këto fonde nuk janë përdorur nga bashkia për vitet 2020 dhe 2021.

- Mbi financimet për shpenzimet e kryera nga Bashkia Sarandë për përballimin e situatës Covid-19.

Bashkia Sarande për periudhën e vitit 2021 ka planifikuar fonde për përballimin e situatës Covid-19, për dezinfektimin e shkollave dhe ambienteve publike, si më postë vijon:

-*Ndihma ushqimore për familjet në nevojë në shumën 885 mijë lekë, në zbatim të VKM-së nr.329, datë 16.05.2020 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare"*

-*Shpenzime për shërbim dezinfektim në shumën 1,678 mijë lekë, për dezinfektimin e shkollave, institucioneve të bashkisë, ambienteve publike.*

-*Blerje materiali klor për dezinfektim në shumën 179 mijë lekë.*

Shpenzimet e kryera më sipër nga ana e Bashkisë janë bërë nëpërmjet procedurave të prokurimit publik.

- Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Sarandë

Nga dokumentacioni i paraqitur, konstatohet se Bashkia Sarande nuk ka marrë dhe dhënë subvencion për periudhën objekt-auditimi.

Titulli gjetjes 2: *Vlerësimi risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likujduara, vendimeve gjyqësore dhe detyrimet kontraktore*

Situata:

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin afatit **30-ditor** të paraqitjes në Degën e Thesarit Sarandë të urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 01.01.2021 ó 31.12.2021, janë gjithsej 43 fatura me vlerë 146,297 mijë lekë.

Nr.	Periudha	Llog.602		Llog.230+231		Shuma	
		Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	Viti 2021	30	43,992,063	13	102,305,407	43	146,297,470

Gjithashtu konstatohet se nga Bashkia Sarandë nuk është planifikuar e gjithë vlera e detyrimeve të prapambetura, ku sipas disiplinës buxhetore buxheti duhet të fillojë me planifikimin për likujdim të detyrimeve të prapambetura (*fatura të palikujduara në fund të periudhave ushtrimore*), pasi për vitin 2021 nga vlera prej 57,200 mijë lekë është planifikuar vlera 28,936 mijë lekë ose 49%.

Kriteri:

UMF nr. 5, datë 27.12.2014 *ËPër shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*, pikat 82-91; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 *ËPër financat e Vetëqeverisjes Vendore* neni 40, 48; Ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008 *ËPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, neni 52.

Ndikimi/Efekti:

Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikujduara.

Shkaku:

Likuidim me vonese i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesës më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh.

Rëndësia: i lartë**Për këtë rekomandojmë:**

Drejtoria e Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës (*përfshirë kufizimet e transfertave specifike nga Ministritë e linjës dhe donator të ndryshëm*), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të palikujduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrë masa që me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, duke respektuar dhe radhën e pagesave.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve, në hartimin e buxhetit të vitit vijues prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës.

Sipas të dhënave të Bashkisë Sarandë, konstatohet se detyrimet e prapambetura janë planifikuar në plan buxhetor e viteve vijues, konkretisht:

Ne/lekë

PERIUDHA	Detyrimet në fund të periudhës	Vlera e detyrimeve të planifikuara	VKB nr/datë	Llog 602	Llog. 230-231
Viti 2020	67,969,209	64,000,000	43/23/12/2019	28,969,209	39,000,000
Viti 2021	57,200,636	28,936,000	204/24/12/2020	28,000,000	936,000

Nga të dhënat e pasqyrës konstatohet se, në fund të periudhave ushtrimore 2020 dhe 2021, vlera e detyrimeve të planifikuara për vitin buxhetor është më e vogël se vlera e faturave gjendje në fund të periudhave ushtrimore. Në shumën e paplanifikuar përfshihen dhe vendimet gjyqësore dhe detyrimet që rrjedhin nga energjia elektrike, të mbartura ndër vite.

Në lidhje me detyrimet e palikujduara, konstatohet se ato janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, të cilat referuar dhe të dhënave të rubrikës *ËDetyrimet e prapambetura*, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura paraqiten më poshtë si vijon:

Tabela nr. 3 *ó Shuma e detyrimeve të prapambetura në fund të periudhës 31.12.2021*

Detyrime	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur në 31.12.2020	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2021-31.12.2021	Total Detyrime	Shlyerja e detyrimeve gjatë vitit 2021	Mbetja e Detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2021
Investime	936,000	45,667,392	46,603,392	46,603,392	
Investime nga FZSHH	-	70,000,000	70,000,000	70,000,000	
Mallra/shërbime	47,809,153	22,241,259	70,050,412	43,773,102	26,277,310
Vendime gjyqësore	8,455,483		8,455,483	4,331,252	4,124,231
Totali	57,200,636	137,908,651	195,109,287	164,707,746	30,401,541

Nga krahasimi i të dhënave të analizës së faturave të palikujduara me raportet e detyrimeve të prapambetura në MFE dhe me gjendjet e llogarive të klasës 4 në bilanc në fund të periudhave ushtrimore është i njëjtë.

- Mbi vendimet gjyqësore

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2020 ato janë në vlerën 8,455,483 lekë, janë shtuar gjatë vitit 2021 shuma prej 2,293,483 lekë, është likuiduar shuma prej 6,624,281 lekë, duke mbetur për likuidim vlera 4,124,231 lekë (Të dhëna të cilat paraqiten në Aneks 2.2, bashkëlidhur Projektraport Auditimit).

- Raportet e Monitorimit

Për vitet 2020 dhe 2021, janë përgatitur raporte 4-mujore për procesin e buxhetit realizimit të tij në nivel programesh, duke përfshirë misionin dhe objektivat dhe ndjekjen e realizimit të tyre, konkretisht:

Për vitin 2021:

Janë dërguar raportet 4-mujore; me date 12.05.2021 raporti i pare, date 20.09.2021 raporti i dyte, dhe date 03.02.2022 raporti i trete.

Raporti vjetor ó është depozituar per miratim ne në KB, datë 20.04.2022.

- Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara nëpërmjet FZSHH, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

- **Për financimet nga Ministrinë e linjës dhe donator të tjerë (FZHR), janë lidhur për vitin 2021 gjithsej 4 kontrata në vlerën 433,778 mijë lekë, nga të cilat: financuar në gjatë vitit 2021 vlera 91,856 mijë lekë dhe mbetet për likuidim vlera 341,922 mijë lekë.**

Nga auditimi i dokumentacioni në lidhje me financimet për objektin e prokuruar *“Furnizimi me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe lugu i Dardhës. Faza e II (Loti Përfundimtar) ”*, konstatohet se jo i gjithë fondi është aplikuar, megjithëse është lidhur kontrata me sipërmarrësin e punimeve, konkretisht:

Me shkresën nr. 367, datë 12.2.2021 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ka dërguar në Bashkinë Sarandë fondin e detajuar për ndërtimin e ujësjellësit *“Furnizimi me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe lugu i Dardhës. Faza e II (Loti Përfundimtar) ”*, të detajuar si më poshtë:

- Për objektin *“Rikonstruksion i ujësjellësit Ksamil (Depo + Rrjeti shpërndarës), lagj nr.3 dhe nr. 4, financimi është vitin 2021 është parashikuar 20 milionë lekë, për vitin 2022 është parashikuar 20 milionë dhe për vitin 2023 vlera e mbetur prej 115.9 milionë lekë;*

- Për objektin *“Furnizim me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe lugu i dardhës, faza e II (loti përfundimtar), financimi është vitin 2021 është parashikuar 77.3 milionë lekë, për vitin 2022 është parashikuar 25 milionë dhe për vitin 2023 vlera e mbetur prej 25 milionë lekë.*

Nga të dhënat konstatohet se procedura është zhvilluar pa fonde në dispozicion, pasi referuar vlerës së preventivit ajo është në shumën 386,746,637 lekë pa TVSh, ndërsa fondi i flokuar nga ministria është në shumën 283,309,275 lekë.

Me shkresën nr. 234/1, datë 28.01.2021 të AKUM është bërë ndarja e fondit me vlerë 387,429,171 lekë, ku për ndërtim montim vlera 386,746,377 lekë, për drejtim punimesh vlera 4,551,962 lekë dhe kolaudim punimesh vlera 682,794 lekë.

• **Për financimet nga buxheti i Bashkisë Sarandë dhe Grande.**

Janë lidhur për vitin 2021 gjithsej 15 kontrata në vlerën 110,616 mijë lekë, vlerë e cila është planifikuar për likuidim e gjitha për vitin 2021. Nga kjo vlerë është likuiduar gjatë vitit vlera prej 89,307 mijë lekë dhe mbetet për likuidim vlera 21,309 mijë lekë. Sipas të dhënave të buxhetit nuk ka planifikime të detajuara në periudha të ndryshme buxhetore, por janë planifikuar të gjitha në një vit buxhetor, viti 2021.

Kontratat janë regjistruar nga dega e Thesarit Sarandë. Depozitimi i kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është përcaktuar struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit.

- **Realizmi i të ardhurave dhe përdorimi i tyre.**

Për periudhën objekti auditim 01/01/2021 ó 31/12/2021, nga auditim i evidencave të marra në Sektorin Financë/Buxhetit dhe të rakorduar me Degën e Thesarit Sarandë, rezulton se të ardhurat paraqiten në masën 100%, ku nga vlera e planifikuar prej 430,383 mije lekë është arkëtuar vlera 447,577 mijë leke.

Sipas analizës arkëtimet dhe përdorimi paraqiten në tabelat 1 dhe 2, si vijon:

Për vitin ushtrimor 2021

Tabela nr. 1 ó Të ardhurat e vitit 2021

Përshkrimi	Plan 2021	Fakt 2021
Të ardhurat të veta të trashëguara viti 2020	143.792	143.793
Të trashëguara nga transf. Specifike 2020	5.362	5.326
Të trashëguara nga transf. Pakushtëzuara 2020	40.882	40.882
Të ardhurat e veta të vitit 2021	432.000	448.189
Grante të pakushtëzuara viti 2021	249.019	251.851
Grante specifike të vitit 2021, të detajuara:	425.000	399.370
-Nga FZSHH	200.000	162.193
-Nga Ministrinë e Linjës		20.000
-Donatorë të ndryshëm		
-Transf buxheti, invalid, ndihma etj. (606)	225.000	217.177
-Nga Huatë		
Totali	1.296.019	1.289411

Tabela nr. 2 ó Përdorimi i të ardhurave viti 2021

Emërtimi	Fakt 2021				% nga përdorimi i të ardhurave të veta
	Gjithsej	Tr. Pakushtëzuar	Të ardhurat e veta	Transf.e kushtëzuar dhe specifike	
230-Projekte	-	-	-	-	
231-Investime	294,617	70,166	62,395	162,056	21
600-Paga	231,071	46,214	108,867	75,990	47
601-Sigurime shoqërore	38,596	7,719	16,058	14,819	42
602-Shpenzime operative	235,770	34,256	188,616	12,898	80
604-Transf.Institucioneve	19,500	3,900	15,600		80
606-Transf. Buxh.Fam.Ind	220,184	20,500		199,684	-
Kuotë qarku	1,000		1,000		100
SHUMA	1,040,738	182,755	392,536	465,447	

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se në total bashkia me të ardhurat e veta mbulon 37.7% të shpenzimeve buxhetore, ku shpenzimet për investime zënë 21% të totalit, shpenzime për paga zënë 47% dhe shpenzimet operative zënë 80%.

- Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile:

Nga Bashkia Sarandë është krijuar edhe fondi për emergjencat civile, ku për vitin 2021 është në shumën 20,1536 mijë lekë, por i papërdorur.

Konstatohet se fondi i krijuar është në masën 3% e shpenzimeve buxhetore, ku 14,000 mijë lek nga të ardhurat dhe 6.153 mijë lekë nga transferuat specifike të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shteti, ku referuar buxhetit respektiv të vitit 2020 me ligjin nr. 45/2019, datë 18.07.2019 *“Për mbrojtjen Civile”*, pika 1 e nenit neni 65 *“Buxheti i bashkive”* fondi është parashikuar sa duhet. Fondi për emergjencat civile për vitin 2021 ka qenë 19,986 mijë lekë, e cila është përdorur për ndërtimin e një muri emergjent i shkaktuar nga dukuritë natyrore.

- **Buxheti i njësive vartëse**

Nga të dhënat e buxhetit, konstatohet se Bashkia Sarandë ka 4 njësi varësie ndajë të cilave ju delegon fonde për kryerjen e shërbimeve sipas plan buxheteve të hartuara nga vetë njësitë dhe miratuara në Këshillin bashkia. Kështu për vitin 2021, kemi këtë delegim fondesh:

1. Njësia varësie “SHERBIMET PUBLIKE”

Titulli	Programi	Emertimi	Buxheti vjetor plani Fillestar 2021	Buxheti / Plan i periudhes/progresiv	Struktura ne %	Fakt i periudhes/ Progresiv 12 mujor	Struktura ne %	Realizimi ne %
600-601	6260	Shpenzime personeli	60,500	60,500	36.20	58,580	37	97
602-606	6260	Shpenzime korrente	106,610	106,610	63.80	97,741	63	92
230-231	6260	Shpenzime kapitale		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali (shpenzime + kapitale)			167,110	167,110	100	156,321	100	94

2. Njësia varësie: “ARSIMI BAZE DHEPARASHKOLLOR”

Titulli	Programi	Emertimi	Buxheti vjetor plani Fillestar 2021	Buxheti / Plan i periudhes/progresiv	Struktura ne %	Fakt i periudhes/ Progresiv 12 mujor	Struktura ne %	Realizimi ne %
600-601	9120	Shpenzime personeli	62,387	62,387	77.10	59,372	80.36	95
602-606	9120	Shpenzime korrente	18,526	18,526	22.90	14,514	19.64	78
230-231	9120	Shpenzime kapitale	-		0.00		0.00	
Totali (shpenzime + kapitale)			80,913	80,913	100	73,886	100	91

2.1 Njësia varësie: “Çerdhja e fëmijëve”(pjesë e arsimit)

Titulli	Programi	Emertimi	Buxheti vjetor plani Fillestar 2021	Buxheti / Plan i periudhes/progresiv	Struktura ne %	Fakt i periudhes/ Progresiv 12 mujor	Struktura ne %	Realizimi ne %
600-601	4980	Shpenzime personeli	11,436	11,436	77.20	11,342	77.8	99
602-606	4980	Shpenzime korrente	3,378	3,378	22.80	3,244	22.2	96
Totali (shpenzime + kapitale)			14,814	14,814	100	14,586	100	98

3. Njësia varësie: “Qendra kulturore dhe shumesportet”

Titulli	Programi	Emertimi	Buxheti vjetor	Buxheti / Plan i periudhes/prog	Struktura ne %	Fakt i periudhes/P	Struktura ne %	Realizimi ne %
600-601	6260	Shpenzime personeli	19,256	19,256	76.91	17,556	80	91
602-606	6260	Shpenzime korrente	5,780	5,780	23.09	4,277	20	74
230-231	6260	Shpenzime kapitale		0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
Totali (shpenzime + kapitale)			25,036	25,036	100	21,833	100	87

- Struktura organizative e Bashkisë Sarandë

Miratimi i Strukturave për vitin 2021 janë miratuar me Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 204, datë 24.12.2020, për miratimin e strukturës organizative dhe konfirmimi i Prefektit nr. 12/1, datë 18.01.2021, ku janë miratuar struktura, organika dhe numri i punonjësve për funksionimin dhe ushtrimin e aktivitetit të administratës së Bashkisë dhe shërbimeve mbështetëse të cilat janë paraqitur dhe konfirmuar brenda afateve ligjore, sipas tabelës.

Emërtimi	Viti 2021	
	Plan	Fakt
Aparati i Bashkisë.	124	101
Njësia Administrative Ksamil.	6	6
Ndërmarrja e Shërbimeve Publike	113	108
Qendra Kulturore dhe shumesportet	29	26
Qendra Polivalente	4	4
Çerdhja	24	24
Kopshti Nr. 4	3	3
Kopshti Nr. 5	5	4
Konvikti	12	12
Zjarrfikës	17	17
Bujqësi, Pyje	5	5
Arsimi	82	82
Shuma	418	392

-Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia, rregullat e qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit.

Në Bashkinë Sarandë, struktura organizative ka pësuar ndryshime nga viti në vit, ndryshime të cilat janë miratuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë si dhe janë pasqyruar në Rregulloren e Brendshme.

Drejtoria e Burimeve Njerëzore si struktura përgjegjëse për personelin, harton çdo fillim viti Planin Vjetor të pranimit në shërbimin civil për Bashkinë Sarandë, mbështetur në nevojat që pasqyrohen në Strukturat organizative të çdo viti, të miratuara nga Kryetarit të Bashkisë: Për vitin 2021 me vendim nr. 204, datë 24.12.2020, për miratimin e strukturës organizative dhe konfirmimi i Prefektit nr. 12/1, datë 18.01.2021. Vendet vakante kanë qenë prezentë si në strukturën ekzistuese ashtu edhe në ato të reja. Kjo si rezultat i ristrukturimeve të Drejtorive apo sektorëve që janë shoqëruar edhe me pozicione të reja apo suprimime të tyre.

Nga auditimi rezulton se vendet vakante në Bashkinë Sarandë janë krijuar jo vetëm si rezultat i ristrukturimeve, por edhe si rezultat i funksionimit të kontrolleve të brendshme.

Numri i Personelit në Bashkinë Sarandë referuar strukturave organizativeve, ka ardhur në rritje, por i paplotësuar sipas planit ndonëse edhe numri faktik i tyre ka ardhur në rritje.

Në strukturën organizative të Bashkisë Sarandë (me ndërmarrjet e varësisë) ka vende vakante, ku numri më i lartë është në aparatit e Bashkisë dhe më i ulët në ndërmarrjet e varësisë së bashku.

- Aftësitë profesionale të punonjësve.

Për të audituar dosjet e personelit përzgjedhëm dosjet e të punësuarve për vitin 2021 në aparatit e Bashkisë dhe në ndërmarrjet e varësisë për kategoritë: ngritje në detyrë, pranim në shërbimin civil, me Kod Pune. Emërimet i janë nënshtruar, Ligjit 152/2013 oPër nëpunësin civilo dhe Kodit të Punës.

Konstatimi: Nga testimi me zgjedhje të dosjeve të personelit (kampioni që përzgjedhëm), emëruar në 2021 u vu re se nuk zbatohet i njëjti standard për plotësimin me dokumentacionin përkatës të dosjeve të personelit për aparatit e Bashkisë me ato të ndërmarrjeve të varësisë.

- Dosjet e personelit të administratës së Bashkisë nuk kanë të unifikuar Formulari Tip oFletë Inventari, nuk ka të listuar emërtesat e dokumentacionit domosdoshmërisht përbërës të dosjes

ku të jenë të specifikuar dhe dorëzuesi dhe marrësi në dorëzim. Në këto dosje u konstatuan këto mangësi: disa raste të dokumenteve të arsimimit dhe kualifikimeve fotokopje të pa noterizuar; mungesa e vlerësimit 6 dhe 12 mujor; formular i Vetdeklarimit, deklarata e kodit të etikës etj.

Për të gjitha këto konstatime, nuk janë zbatuar: Ligji nr.152/2013 i ndryshuar për nëpunësin civilë neni 17 pika 1,4; VKM nr.117, datë 5.3.2014 Lidhja 1 e 2.

Nga verifikimi për raportin e punonjësve me status dhe me kontratë pune rezulton se:

a. Për vitin 2021:

Nga të punësuarit gjithsej, konstatohet se **76** pozicione pune janë me statusin e nëpunësit civil, ku marrëdhëniet e punës rregullohen me ligjin nr.152/2013 datë 30.05.2013 për Nëpunësin Civilë.

Sipas strukturës së miratuar me VKB, konstatohet se 1 (një) pozicion pune është i kategorisë së lartë, 11 pozicione pune të kategorisë së mesme drejtues, 1 (një) pozicion pune të kategorisë së ulët drejtuese dhe 63 pozicione pune të kategorive ekzistuese.

Nga totali 76 pozicione pune me status të nëpunësit civil, janë të lira 2 pozicione pune të kategorisë së mesme drejtues dhe 7 pozicione pune të kategorive ekzistuese.

Realizimi i fondit të pagave, sigurimeve shoqërore dhe numrit të punonjësve për Bashkinë Sarandë jepet nga pasqyrat në vijim:

Pasqyra e pagave për vitin 2021 Bashkia Sarandë, në 000/lekë

Emërtimi		Plan	Fakt
Kap.1 (Granti)	600	135,782	122,204
	601	25,611	22,538
Kap.5(Te ardhurat)	600	120,963	108,867
	601	18,248	16,058

Nënpika 2.2.6. Burimi i krijimit të ardhurave bazuar në kuadrin rregullator ligjor/nënligjor në fuqi, përdorimi i tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore/nënligjore në fuqi dhe borxhi tatimor.

- Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Në Bashkinë Sarandë, për vitin 2021 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB-në nr. 204, datë 24.12.2020, për strukturën organizative, ku përfshihet edhe struktura e Drejtorisë së të Ardhurave Vendore. Aktualisht, kjo drejtori ka në përbërje 12 punonjës, të ndarë konkretisht: 1 (një) drejtor, 1 (një) specialist për menaxhimin e taksave-tarifave të familjarëve, 1 (një) specialist për menaxhimin e borxhit, 2 specialist vlerësimi të detyrimeve fiskale, 1 (një) specialist kontabilitetit dhe 6 specialist inspektimi në terren.

- Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve

Për vitin 2021, paketa e taksave dhe tarifave vendore në territorin e Bashkisë Sarandë është miratuar me VKB-në nr. 167, datë 27.11.2020 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021. Parashikimi për të ardhurat vendore është pjesë e parashikimeve buxhetore, duke u përgatitur fillimisht në formë relacioni nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore. Në **Tabelën nr. 1** paraqitet i detajuar parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, përkatësisht :

Tabela 1. Parashikimi dhe realizimi i të ardhurave, për vitin 2021. (në mijë lekë)

EMERTIMI SIPAS LLOJIT	VITI 2021		%
	Plan	Fakt	

	EMERTIMI SIPAS LLOJIT	VITI 2021		%
		Plan	Fakt	
A	Te ardhura tatimore	1,000	10,229	1,023
1	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	1,000	7,452	745
2	Tatim mbi te ardhurat personale	-	2,777	-
B	Te ardhura nga taksat	283,883	263,492	93
1	Taksa mbi ndërtesat	88,383	85,388	97
2	Taksa mbi token bujqësore	6,000	4,435	74
3	Takse trualli	3,000	676	23
4	Taksa e mjeteve te përdorura	19,000	24,690	130
5	Taksa per zënien e hapësirave publike	51,000	57,046	112
6	Taksa e fjetjes ne hotel	24,000	18,184	76
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	73,000	55,704	76
8	Taksa mbi kalimin e se drejtës se pronësisë	8,500	10,220	120
9	Taksa per tabelën	3,000	1,010	34
10	Taksa per zënien e hapësirave publike me reklama	6,000	2,478	41
11	Te ardhura nga vitet e kaluara	2,000	3,661	183
C	Te ardhura jo tatimore	145,500	173,856	119
<i>i</i>	<i>Te ardhura nga tarifat</i>	<i>120,000</i>	<i>125,430</i>	<i>105</i>
1	Tarife shërbimi publik	95,000	103,512	109
2	Tarife parkimi	2,500	1,552	62
3	Tarifa te tjera administrative	22,500	20,366	91
II	Te ardhura te tjera	16,000	42,345	265
1	Shitje trualli	4,000	32,303	808
2	Qera trualli + ndërtesë	5,000	4,741	95
3	Bileta kulture+sporte	1,000	389	39
4	Sponsorizime gjithsej	6,000	4,912	82
III	Te ardhura nga institucionet	9,500	6,081	64
1	Te ardhura nga kopshte + cerdhe+konvikt	9,500	6,081	64
	TOTALI A + B + C	430,383	447,577	104

Burimi: Bashkia Sarandë

Të ardhurat totale të Bashkisë Sarandë, referuar të dhënave janë me realizim në masën 104%, ku nga vlera e planifikuar prej 432,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 447,577 mijë lekë.

Me tejkallim paraqiten zërat, si:

- 1- Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin në masën 745%, kjo pasi nga DAV Bashkia Sarandë është planifikuar një vlerë simbolike prej 1,000 mijë lekë, ndërsa arkëtimet janë në shumën 7,452 mijë lekë, pra DAV Bashkia Sarandë nuk ka bërë planifikim të saktë, **duke mos pasur në konsideratë dhe faktin e vitit 2020 e cili është në shumën 17,185 mijë lekë;**
- 2- Zëri tatim mbi të ardhurat personale, konstatohet se nga DAV Bashkia Sarandë nuk është planifikuar asnjë vlerë, ndërkohë që kemi arkëtim në vlerën 2,777 mijë lekë;
- 3- Taksa e mjeteve të përdorura, paraqitet me realizim në masën 130%, ku nga vlera e planifikuar prej 19,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 24,690 mijë lekë. Nga DAV Bashkia Sarandë nuk është bërë planifikimi i saktë, nisur kjo dhe nga fakti i vitit të kaluar ku megjithëse fakti është në vlerën 23.584 mijë lekë planifikimi është bërë sa një vit më parë;
- 4- Taksa e hapësirave publike nga 51,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 57,046 mijë lekë.

Për vitin 2021, disa nga zërat fiskal nuk janë realizuar në krahasim me planin e përgjithshëm të të ardhurave në masën 2.7 % ose 9,702 mijë lekë. Përgjithësisht kjo shumë përbëhet nga mungesa në të ardhurat për shumën **2,134 mijë lekë**, të reflektuara në **Tabelën 2** si vijon:

Nr	Emërtimi	Viti 2021		% e realizimit
		Plan	Fakt	
B	Te ardhura nga taksat	203,383	167,875	83

1	Taksa mbi ndërtesat	88,383	85,388	97
2	Taksa mbi token bujqësore	6,000	4,435	74
3	Takse trualli	3,000	676	23
6	Taksa e fjetjes ne hotel	24,000	18,184	76
7	Taksa e ndikimit ne infrastrukture	73,000	55,704	76
9	Taksa per tabelën	3,000	1,010	34
10	Taksa per zënien e hapësirave publike, rek	6,000	2,478	41

Titulli gjetjes 1: *Gjendja e debitorëve për taksa e tarifa me datë 31.12.2021*

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga DTV Bashkia Sarandë, rezulton një gjendje e lartë e detyrimeve të paarkëtuara nga subjektet fizik/juridik në vlerën 317,290,273 lekë.

Nisur nga fakti se numri i debitorëve është i lartë (aktualisht 2461 me vlerë 317,290,273 lekë), nuk mund të paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe, e cila është në formë dixhitale, me CD.

Konstatohet se nga njëperiudhë në tjetër, niveli i detyrimeve të paarkëtuara vjen në rritje nga viti 2020 në shumën 31,021,793 lekë, pasi nga vlera 286,268,480 lekë në fund të vitit 2021 paraqitet vlera **317,290,273 lekë**, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifat vendore të papaguara, **borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë**.

Nga DTV Bashkia Sarandë, nuk janë pallogaritur kamatëvonesat për mos likuidimin në afat të detyrimeve në shumën **69,486,569 lekë**.

Evidentohet fakti që peshën kryesore e zënë debitorët e subjekteve fizik/juridik në vlerën 317,222 mijë lekë ose 78.8% e totalit.

Gjithashtu evidentohet fakti se nga DAV Bashkia Sarandë, nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore për arkëtim e tyre, veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhurash në bashki.

Referuar të dhënave të buxhetit, vlera e detyrimeve nga taksat e tarifat vendore të subjekteve fizik/juridik dhe abonentë familjarë është 30.5% e planit të buxhetit.

Gjithashtu evidentohet një numër i konsiderueshëm subjektësh të cilët dhe pse ushtrojnë aktivitet dhe nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore çdo vit ju rigjenerohet njoftim detyrimi për vitin vijues, janë lejuar që të ushtrojnë aktivitet pa bërë likuidimet e detyrimeve ndërvite.

Në lidhje me njoftimin për debitorë, nga inspektorët tatimorë janë bërë disa herë njoftime vlerësimi për detyrimet tatimore vendore për të gjithë subjektet dhe taksapaguesit familjare debitorë, por nga niveli menaxherial nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të kaluar në masat shtrënguese dhe në mbledhjen me forcë të detyrimit.

Gjithashtu, nga të dhënat evidentohet se një numër i konsiderueshëm subjektet me status pasiv/mbyllur me detyrime të paarkëtuara, gjithsej nga 138 subjekte që kanë mbyllur aktivitetin, 60 prej tyre janë me detyrime me vlerë **9,971,459 lekë**, ku përgjegjësia është si Administratës së QKB Njësia Sarandë, po ashtu dhe DTV Bashkia Sarandë, e cila ka lejuar mbylljen e tyre subjekteve pa likuiduar detyrimet fiskale, duke u bërë premisë për kalimin e tyre në borxh të paarkëtueshëm ose të keq.

Kriteri:

Në kundërshtim me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 ó “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, òKodi Penal i Republikës së Shqipërisë, i

ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -*Mospagimi i taksave dhe tatimeve*⁸, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit *ËPër Kundërvajtjet Administrative* (brenda 2 viteve), duke u bërë përgjegjës për rritjen e nivelit të borxhit, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: L.B., me detyrë Drejtor i Taksave e Tarifave Vendore dhe N.A. me detyrë specialist për mbledhjen e borxhit.**

Ndikimi/Efekti:

Mungesa e të ardhurave në vlerën **317,290,273 lekë**, sipas parashikimit ka sjell mosrealizimin në masën e planifikuar të shërbimeve dhe investimeve nga ana e Njësisë së Qeverisjes Vendore.

Shkaku:

Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që dispijlojnë taksat dhe tarifatat vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **317,290,273 lekë**, si më poshtë vijon:

a-T'u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme).

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Sektori i Taksave dhe Tarifave, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

e- Të bashkërendojë punën me QKB bashkia Sarandë për mos kalimin e subjekteve debitorë me status pasiv/ mbyllje dhe lejimin e tyre në debitorë të keq.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa për llogaritjen e saktëtë vlerë sëkatatëvonesave në masën 0.06% për detyrimet e maturuara por tëpadredhura sipas afateve ligjore nga subjektet dhe më pas të ndërmarrë veprime për arkëtimin e kësaj vlere.

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë të bashkëpunojë me QKB Dega Sarandëqë në batim të dispozitave ligjore të ligjit për procedurat tatimore dhe QKB, të mos lejojnë që për subjektet debitorë të bëhet mbyllja e aktivitetit ose lejimin e administratorëve për hapjen e aktiviteve të tjera me Nipt tjetër, kjo për tëeliminuar në maksimum borxhin e keq.

Për sa është në këtë pjesë të Raportit përfundimtar të auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën nr. 2524/2, datë 4,7,2022 ëMbi Projekt raportin e Auditimit nga L.B., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

⁸ "Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet."

Në lidhje me konstatimin tuaj se likujdimet janë më të larta se detyrimet, sqarojmë se abonentët familjarë kanë paguar më shumë se fatura mujore, në rastet kur kanë rezultuar debitorë ndër vite dhe me vullnet kanë marrëpërsipër të paguajnë detyrimin e faturës.

Pagimi më shumë se detyrimi ka lidhje me faktin se pas 1 (një) viti e gjysmë nëqytetin e Sarandës gjatë vitit 2021 pati shumë emigrant të ardhur, ku njëpjesërezultonin debitorë ndër vite dhe nisur nga masat shtrënguese të marra nga bashkia në bashkëpunim me ND/Ujësjetellës kanalizim është bërë i mundur arkëtimi i debitorëve në vite.

Në lidhje me abonentët e pataksuar, sqarojmë se në zbatim të ligjit nr. 106/2017, neni 22 pika 6 germa (ë), ku përfshihen kategoritë e të përjashtuarve.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Argumentet qëparaqisni nuk sqarojnë situatën, pasi asnjëabonentët nuk mund të likujdojë detyrime më shumë se fatura e paraqitur për likujdim. gjithashtu ne kemi theksuar se nga ana juaj nuk njohët sa duhet situata e detyrimeve të palikujduara në Nd/Ujësjetellës Sarandë ndër vite për debitorët dhe rezulton që likujdimet të jenë më shumë se detyrimet. Prandaj ne kemi kërkuar që të bëhet një rakordim përfundimtar në lidhje me këto detyrime.

Merret në konsideratë gjetja në lidhje me familjet e pa taksuara.

Titulli gjetjes 2: Nga auditimi, KLSH-ja konstatoi se taksa e pasurisë (ndërtesës), nuk është llogaritur në raport me sipërfaqen e disponueshme.

Situata:

Referuar Vendimeve të KB për paketën fiskale të vitit 2021, rezulton se taksa e ndërtesës për një pjesë tëkonsiderueshme të familjeve aplikohet në mungesë të dokumentacionit ligjorë (genplani për sipërfaqet ose të dhënave nga ASHK), duke përdorur tarifë fikse 70 -100 m², mbi të cilën janë aplikuar taksa e pasurisë për ndërtesën. Kjo mënyrë e aplikimit e taksës së ndërtesës për abonentët familjarë nuk është e saktë dhe proporcionale, pasi favorizon disa dhe penalizon disa të tjerë, ku pas viteve 90 ka shumë ndërtime pa leje dhe me sipërfaqe mbi 100 m² dhe nuk janë identifikuar ato, duke bërë që ndaj këtyre subjekteve të mos aplikohet saktë taksa e ndërtesës.

Gjithashtu nuk ka një bashkëpunim midis vetë sektorëve të bashkisë dhe jo vetëm, ku mungon informacioni i marrë nga Drejtoria e PZHT për lejet e ndërtimit dhe përdorimit të lëshuar nga kjo strukturë për sipërfaqet e objekteve dhe sipërfaqet e truallit, si dhe të dhënave të dërguara nga ASHK Dega Rajonale Sarandë mbi sipërfaqet e objekteve të legalizuara pa leje ndërtimi.

Kështu referuar të dhënave të marrë nga Drejtoria e PZHT për lejet e ndërtimit/përdorimit të lëshuara nga kjo strukturë, konstatohet se për 3 subjektetaksae pasurisë (taksa ndërtesë), nuk është llogaritur e saktë për sipërfaqen që ato disponojnë, duke evidentuar një të ardhur të munguarë në shumën 285,062 lekë, konkretisht pasqyra:

Nr	Emërtimi	Leje Ndërtimi		Investitori	Sip ndërtimi mbi dhe nën toke m ² , sipas DPZHT	Sip sipas DTTV	Dif pataksuar	Vl. Taks ndertës munguar
		Nr	Datë					
1	Hotel 3 dhe 4 kate me 1 kat parkim nën tokë	71	09.05.2018	E.O.	1412	747	665	134,064
2	"Njësi akomoduese Hoteliere 4 kat me 1 kat parkim nëntokë	95	25.09.2018	D.D.	1260	1060	200	40,320
3	Hotel 4kat me 1kat parkim nëntokë	111	01.11.2018	G.A	1329	780	549	110,678
	SHUMA							285,062

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 òPër Taksat vendoreò i ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë07.03.2018 òPër metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme òndërtesaò, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës. Ku thuhet se:

1. Burimet e informacionit (të dhënat parësore)

Burimet e mundshme të informacionit, për efekt të administrimit të taksës mbi ndërtesat, janë:

- a) Të dhënat e vetë deklaruara nga taksapaguesi mbi ndërtesën/njësini e ndërtesës në pronësi/ përdorim të tij;*
- b) Të dhënat e disponuara nga ZVRPP-të lidhur me vlerësimin dhe rivlerësimin e ndërtesave, si dhe titujt e pasurisë mbi to;*
- c) Të dhënat e zyrave të urbanistikës për lejet e dhëna të ndërtimit;*
- ç) Të dhënat e zyrave të noterisë për transaksionet e shitblerjeve të ndërtesave;*
- d) Të dhënat e ALUIZNI-t për ndërtesat në proces legalizimi;*
- dh) Të dhënat e siguruara nga verifikimi në terren nga vetë njësitë e vetëqeverisjes vendore;*
- e) Të dhënat nga Regjistri Qendror i Gjendjes Civile;*
- ë) Të dhënat nga subjekte ekonomike që kanë kontakte me konsumatorët, si: Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, ndërmarrjet e ujësjellës-kanalizimeve apo dhe institucione të tjera të papërmendura më lart, të cilat disponojnë informacion mbi pasurinë ndërtesë/njësi ndërtesë, tituj pronësie apo statusin juridik të marrëdhënies së taksapaguesit në marrëdhënien e tij me pasurinë e paluajtshme, objekt taksimi, si dhe për vetë taksapaguesin;*
- f) Të dhënat nga Agjencia e Trajtimit të Pronave për pasuri të trajtuara me vendime të KKKP-së.*

Ndikimi/Efekt:

Mungesa e bashkëpunimit midis sektorëve, çojnë nëmungesën të ardhurash në shumën 285,062 lekë.

Shkaku:

Mungesa e zbatimit me rigorozitet akteve ligjore dhe nënligjore që disiplinojnë taksat dhe tarifatat vendore nga strukturat përkatëse në njësinë e vetëqeverisjes vendore

Rëndësia: E mesme

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë të gjitha masat për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e PZHT Bashkia Sarandë dhe ASHK Dega Rajonale Sarandë, për sigurimin e të dhënave të nevojshme me dokumentacion ligjorë për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo për një taksim sa më real të taksës së pasurisë (ndërtesës) dhe arkëtimin e vlerës prej **285,062 lekë** të taksës së ndërtesë për 3 investitorë, respektivisht:

- vlera **134,064 lekë** nga investitori **E.O.**
- vlera **40,320 lekë** nga investitori **D.D.**
- vlera **110,678 lekë** nga investitori **G.A.**

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave Vendore dhe Drejtorinë e PZHT, të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për evidentimin dhe plotësimin me dokumentacion ligjorë të subjekteve fizikë/juridikë dhe abonentë familjarë të sipërfaqes së ndërtesave që ato disponojnë dhe taksimin e tyre.

Për sa është në këtë pjesë të Raportit përfundimtar të auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën nr. 2524/2, datë 4,7,2022 òMbi Projekt raportin e Auditimitò nga L.B., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

-Nuk shprehim dakortësi për rekomandimin 1

Subjektet e cituara prej jush ne këtë tabelë janë taksuar bazuar ne procesverbalin e inspektoreve te verifikimit ne terren.

Vlerësimi qe ju bëni per subjektet e cituar ne këtë tabelë respektivisht:

		Total	Sip/taks	Parkim	Banim familjar
1.	E.O.	1412m ²	747m ²	412m ²	253m ²
2.	D.D.	1260m ²	600m ²	460m ²	200m ²
3.	G.A.	1329m ²	780m ²	429m ²	120m ²

Ju bëjmë me dije se llogaritja tuaj e bere si takse ndërtese nuk i referohet faktit dhe as lejes se ndërtimit pasi këto sipërfaqe janë te dedikuara parkim, si dhe hapësira e dedikuar per banim familjar. (Bashkangjitur procesverbali i inspektorëve)

Qëndrimi i grupit të KLSH-së:

Nga sa është kundërshtuar në lidhje me mos aplikimin e taksës së pasurisë (ndërtesës), sqarojmë se nga subjekti nuk është paraqitur asgjë e re nga ato të paraqitura në fazën e aktkonstatime, për të cilën nga KLSH janë dhënë shpjegimet e mos marrjes në konsideratë.

-Taksë për fjetjen në hotele. Sipas të dhënave të pasqyrës, konstatohet se nga vlera e planifikuar prej 24,000 lekë është arkëtuar vlera prej 18,184 mijë lekë ose 76% e planit të të ardhurave. Aplikimi i tarifës bëhet sipas deklarimeve të vetë subjekteve, duke mos ushtruar asnjë kontroll nga sektori i terrenit nëse deklarimi i subjektit ose regjistrimi në librat përputhet me numrin e pushuesve dhe numrin e dhomave për hotel.

Gjithashtu nga një verifikim i thjeshtë në internet, në faqet që paraqesin hotele, motele, bujtina, vila apo apartamente, figurojnë me qindra të tilla, të cilat janë krejt informale dhe zhvillojnë aktivitetin duke mos paguar asnjë lloj detyrimi vendor, sigurime shoqërore dhe shëndetësore, etj.

Tabela 4. Të dhënat për taksën e fjetjes

Nr. i Subjekteve	Nr. dhomave	Nr i klientëve	Vlera për page
	2021	2021	2021
630	4,292	439,444	30,761,080

Nga samësipër nga mos kryerja e kontrole në terren, evidentohet një e ardhur e munguar prej 30,761,080 lekë.

Titulli gjetjes 3: Mbi menaxhimin e taksës sëndikimit nëinfrastrukturë.

Situata:

-Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë dhe ALUIZNI. Sipas të dhënave të ardhurat nga ky zë janë realizuar për vitin 2021 në masën 76% ose nga 73,000 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 55,704 mijë lekë.

Nga të dhënat konstatohet se në vitin 2021 kemi një rënie të nivelit të arkëtimeve, ku nga 113,920 mijë lekë të arkëtuar në vitin 2020 në vitin 2021 është arkëtuar vlera prej 55,704 mijë lekë, kjo si rezultat i uljes së kërkesave për leje ndërtimi.

Në këtë zë bën pjesë dhe taksa nga ndërtimet e reja (ALUIZNI), ku referuar të dhënave, detyrimi për këtë taksë në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën 74,206,014 lekë, pasqyra:

V i t e t	Vlera e llogaritur ne leke	Pagesa	Debia progresive
2017	49,816,388	1,019,959	48,796,429
2018	74,442,370	4,262,950	70,179,420
2019	105,980,814	34,649,540	71,331,274

2020	95,693,597	21,600,860	74,092,737
2021	83,798,091	9,592,077	74,206,014

Vlera prej **74,206,014 lekë**, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë, ku në mënyrë analitike, pasqyra në Drejtorinë e Taksave Vendore.

Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia Sarandë ti jetë drejtuar ASHK Dega Sarandë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes e lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 òPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje.

Kriteri:

Ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, òPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa lejeò i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, neni 23, pika 2/1 e nenit 27 tëligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, òPër sistemin e taksave vendoreò të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 òPër përcaktimin e mënyrës se mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizimò i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Mos menaxhim i mirë, veprime në mungesë të ardhurash në buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën**74,206,014 lekë**.

Shkaku:Përgjegjësi e strukturave drejtuese në zbatimin e ligjit.

Rëndësia: i lartë.

Për këtë rekomandojmë:

- Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e PZHT Bashkia Sarandë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **74,206,014 lekë**, sipas listës që disponon DTV Bashkia Sarandë.
- Kryetari i Bashkisë Sarandë nëpërmjet bashkëpunimit institucional, tã kërkojë ASHK-së Drejtoria Rajonale Sarandë, që të mos pajisë me certifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

-Taksa e zënies së hapësirave publike (plazhe). Nga të dhënave të pasqyrës, rezulton se për vitin 2021 është realizuar në masën 112%, ose nga 51,000 mijë lekë të planifikuar është arkëtuar vlera 57,046 mijë lekë.

Në lidhje me këtë taksë për vitin 2021 është ushtruar kontroll nga Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Sarandë, sipas programit nr. 1244, datë 28.3.2022 të miratuar nga Kryetari i Bashkisë Sarandë. Në përfundim ka rezultuar se:

- a- Mos dorëzimi me PV i marrjes në dorëzim të plazhit të nënshkruar nga Agjensia Kombëtare e Bregdetit, Bashkia Sarandë dhe subjekti, në zbatim të VKM nr. 171, datë 27.3.2019 i ndryshuar me VKM nr. 1172, datë 24.12.2020, pika 12 shkronja (a), duke evidentuara se subjekti F.P. nuk ka paguar detyrimin në shumën 400,000 lekë.

Titulli gjetjes 4: KLSH konstatoj probleme në dhënien e hapësirave publike për plazh.

Situata:

Nga auditimi i të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Bashkia Sarandë dhe të dhënave të raport auditimit të kryer nga NJAB sipas programit nr. 1244, datë 28.3.2022, konstatohet se nuk janë prekur disa çështje, si:

- a- Subjekti T... me kontratë nr. 1434, datë 19.8.2021 (Agjensia Kombëtare e Bregdetit) dhe nr. 4821, datë 01.10.2021 (Bashkia Sarandë) **për sipërfaqen 901 m², i është prerë faturë pagesë për sipërfaqen prej 1000 m² ose më shumë prej 99 m².**
- b- Subjekti A... me kontratë nr. 1250, datë 3.8.2021 (Agjensia Kombëtare e Bregdetit) dhe nr. 3986, datë 6.8.2021 (Bashkia Sarandë) për sipërfaqen 1003 m², i është prerë faturë pagesë për sipërfaqen prej 1300 m² ose më shumë prej 297 m².
- c- Dhënia e sipërfaqeve për shfrytëzim të hapësirave për plazhe pa miratim të Agjensia Kombëtare e Bregdetit, konkretisht pasqyra:

Nr	Subjekti	Sip. m2	Afati	Tarifa	Tarifë. shërbimi	Paguar	Vendi
1	D.C.	120		750	50	96,000	Sarandë
2	E.M.	320	1	750	50	256,000	Sarandë
3	F.P.	257	1	750	50	205,600	Ksamil
4	F.P.	500		750	50	375,050	Sarandë
5	K.Z.	204	1	750	50	163,200	Ksamil
6	M.J.	319	1	750	50	255,200	Sarandë
7	R.Q.	345	3	750	50	276,000	Sarandë
8	S.H.	350	1	750	50	280,000	Sarandë
9	T...	182	1	750	50	145,600	Sarandë

Kriteri:

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 171, datë 27.3.2019 i ndryshuar me VKM nr. 1172, datë 24.12.2020, duke ngarkuar me përgjegjësi L.C. me detyrë Specialist projektimi dhe infrastrukture në Drejtorinë e shërbimeve dhe L.B. me detyrë Drejtor i DTTV Bashkia Sarandë.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E mesme

Për këtë rekomandojmë:

- Kryetari i Bashkisë nëbashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Bashkia Sarandë, të marrë masa për mos lejimin e shfrytëzimit të hapësirave publike (për plazh), të subjekteve ose individëve të cilat nuk kanë marrë miratim më parë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe për sipërfaqe jashtë kontratave të lidhura.

- **Agjentët tatimorë.**

Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se në përgjithësi, akt-rakordimet janë mbajtur çdo muaj, janë regjistruar në evidencat përkatëse, pavarësisht se nuk janë protokolluar në përputhje me kërkesat e Nenit 13 të Normave Arkivore në R.Sh.

Të ardhurat nga AKSH-ja derdhen automatikisht në fillim të çdo muaji, për llogari të Bashkisë Sarandë brenda datës 5 të çdo muaji. Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Sarandë janë paraqitur në *Tabelë*.

Tabela 5. *Të ardhurat e vjela nga agjentët tatimorë në Bashkinë Sarandë, në 000/lekë*

Agjenti Tatimor	Lloji i Taksës	2021
D....	Tatim i thjeshtuar mbi fitimin	7,452
D.....	Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	24,690
V.....	Taksa e kalimit të pronësisë	10,220
D.....	Renta Minerare	0
U.....	Taksë ndërtese	40,306
	Tarifë shërbimi	65,606
TOTALI		148,274

Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave të cilat vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, u konstatua se ka një nivel të lartë realizimi.

Bashkia Sarandë nuk ka krijuar baza të plota të dhënash për detyrimet që vilen nëpërmjet agjentëve tatimorë, në bazë të të cilave të bëjë akt-rakordimet. N.q.s. krijohen baza të plota dhe gjithëpërfshirëse për të dhënat, do të jetë e mundur të bëhet një planifikim i saktë, real dhe i realizueshëm.

-Taksa e tokës bujqësore. Nga të dhënat e pasqyrës, kjo taksë është realizuar në masën 74% ose nga vlera e planifikuar prej 6,000 mijë lekë është arkëtuar vlera 4,435 mijë lekë. Sipas të dhënave të marrë nga Drejtoria e Bujqësisë, Bashkia Sarandë disponon gjithsej 2375 ha tokë, nga e cila: NjA Sarandë disponon sipërfaqen 1970 ha, NjA Ksamil disponon sipërfaqe 405 dhe tokë bujqësore e zënë me ndërtime informate me sipërfaqe 140 ha. Në pronësi private janë 1452 ha dhe në pronësi shtetërore me sipërfaqe 923 ha. Sipërfaqja e tokës me pronësi shtetërore prej 710 ha me origjinë nga ish- ndërmarrjet bujqësore, vjen: 180 ha nga diferenca azhornimi, 405 ha NjA Ksamil dhe 125 ha dhënë me qira nga MBZHR. Ndërsa sipërfaqja prej 213 ha me origjinë tokë e ish- ndërmarrjeve bujqësore dhënë në përdorim institucioni tjera. Sipërfaqja prej 1452 ha është ndarë me ligjin nr. 7501. Përmbledhja e pritshmërisë të taksës së tokës bujqësore për vitin 2021 në Bashkinë Sarandë, e llogaritur në bazë të sipërfaqes, është paraqitur në **Tabelën 6**.

Tabela 6. Pritshmëria e taksës së tokës bujqësore për vitin 2021

Kategoria e tokës	Sip/HA Fshati Gjashtë	Sip/HA Fshati Metoq	Sip/HA Fshati Shelegar	Sip/HA Fshati Çukë	Sip/HA NjA.	Vlera/Ha	Plani/Lekë
Kategoria II				100	110	4,900	539,000
Kategoria III	230	336	42	410	1018	4,200	4,275,600
Kategoria IV	260	119	5	110	494	3,600	1,778,400
Totali	490	495	47	620	1652		6,593,000

Burimi: Bashkia Sarandë

Nga krahasimi i të hënave me evidencën e realizimit të të ardhurave, konstatohet se planifikimi është bërë me rezerva afërsisht 10% ose e shprehur në vlerën **prej 598,000 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë.**

- Tarifa e parkimit të mjeteve: Nga të dhënat e pasqyrës, niveli i realizimit të kësaj takse është në masën 60.8% ose nga vlera prej 2,500 mijë leke është arkëtuar vlera prej 1,552 mijë lekë.

Titulli gjetjes5: *Shmangia e tarifimit për parkimet e rezervuara, vendosja e tabelave dhe vijëzimeve fiktive.*

Situata:

Nga auditimi, u konstatua se për tarifën e parkimit, nga administrata e Bashkisë Sarandë nuk është lidhur asnjë kontratë, ndërkohë që rrugët kudo janë të mbushura me tabela treguese për parkime të rezervuara dhe me vijëzimet përkatëse.

Krahas kësaj, vendosja e tabelave për parkime të rezervuara, pa arkëtuar pagesat përkatëse dhe pa lidhur kontrata përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë, evazion fiskal. Pavarësisht se në disa raste thuhet se ndërpritet kontrata për rezervimin e parkimit, tabelat vazhdojnë të qëndrojnë, si për bizneset, familjarët, autobuzat, taksitë, etj., pavarësisht se në paketat fiskale të çdo viti janë parashikuar tarifa parkimi për të gjitha kategoritë e mjeteve.

Edhe në rastet kur subjektet nuk kanë bërë pagesën, nga ana e bashkisë duhet të ishin marrë masat përkatëse sipas akteve ligjore e nënligjore për detyrimet kontraktuale. Ndërkohë që Bashkia ka shpenzuar duke bërë vijëzimet dhe duke vendosur tabelat përkatëse, të cilat nuk janë hequr edhe pas përfundimit të kontratës.

Të dhënat për parkimet e rezervuara të kontraktuara janë paraqitur në **Tabelën**.

Tabela. Të dhënat për parkimet e rezervuara

Nr	SUBJEKTI	AKTIVITETI	DATA E PAGESSES	Detyrimi	Papaguar
1	A...	DYQAN MISHI	24.09.21	40,000	
2	A...	DYQAN MISHI			40,000
3	K...	DYQAN PESHKU	07.09.21	40,000	
4	F...	POSTA	24.05.21	40,000	
5	R...	BANK	31.03.21	40,000	
6	Y...	ZYRE FUNERALE	30.12.21	40,000	
7	A...	FARMACI			40,000
8	A...	ARGJENDARI	04.06.21	40,000	
9	N...	DYQAN			40,000
10	S...	DYQAN HIDRAULIKE			40,000
11	S...	LIBRARI			40,000
12	M...	MARKET			40,000
13	A...	Dyqan Mobileri			40,000
14	A...	KAFENE			40,000
15	F...	BANK	07.10.21	40,000	
16	E...	FARMACI			40,000
17	L...	BANK	13.09.2021	40,000	
18	B...	MARKET			40,000
19	M...	TENDA DIELLI	19.01.21	40,000	
20	E...	MAGAZINE SHUMICE			40,000
21	S...	SHOQERI SIGURIMI	10.06.21	40,000	
22	O...	KEMBIM VALUTE	26.01.21	40,000	
23	L...	TREGTI CELULAR	19.03.21	40,000	
24	L...	SUPERMARKET	06.04.21	40,000	
25	A...	FAST-FOOD	24.05.21	40,000	
26	D...	DYQAN BOJRASH			40,000
27	B...	HOTEL	24.05.21	40,000	
28	M...	HOTEL	17.06.21	40,000	
	Shuma			640,000	480000

Burimi: Bashkia Sarandë

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se DTTV Bashkia Sarandë menaxhon 28 subjekte me parkim me pagesë për vlerën 1,120,000 lekë, nga e cila likuiduar vlera 640,000 lekë dhe nuk është likuiduar vlera **prej 480,000 lekë, e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.**

Gjithashtu konstatohet se për një numër vedparkimesh, bashkia nuk kishte informacion dhe nuk ishin taksuar për vendet që ato shfrytëzonin dhe për të cilat kanë dhe të vendosur tabelë, tabela:

SUBJEKTI	AKTIVITETI	Nr. Vende	Vlera
N...	Dyqan	1	40,000
A...	Supermarket	1	40,000
A...	Hotel	1	40,000
A...		1	40,000
A...	Kazino	2	80,000
B...	Zyrë Funerale	1	40,000
Ç...	Këmbim Valute	1	40,000
E...		1	40,000
F...		1	40,000
L...	Dyqan	1	40,000
K...	pastiçeri	1	40,000
L...	Dyqan peshku	1	40,000

SUBJEKTI	AKTIVITETI	Nr. Vende	Vlera
R...	Dyqan robash	1	40,000
V...	Hotel	4	160,000
SHUMA		18	720,000

Nga tabela, shihet për 18 vendparkime nuk paguar vlera e taksës prej **720,000 lekë**, si ardhur e munguar në buxhet për tabelat dhe vijëzimet që vazhdojnë të qëndrojnë në rrugët e qytetit të Sarandës, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Personat përgjegjës janë: G.D. me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike bashkia Sarandë dhe Inspektori i Zyrës së Shërbimeve për transportin **TH.K.**

Kriteri:

Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, *ËPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre* dhe aktet nënligjore në zbatim të tij;

Ligji Nr. 9920, dt. 19.5.2008, *ËPër Procedurat Tatimore*;

VKM nr. 170, dt. 25.04.2002, nr. 344, dt. 19.4.2017 dhe nr. 970, dt. 02.12.2015 *ËPër Liçencat e tregimit të Hidrokarbureve*;

UMF nr. 26, Dt. 04.09.2008 dhe nr. 12, dt. 4.4.2017, *ËPër Taksat Kombëtare*, etj.

Ndikimi/Efekti:

Bashkia Sarandë nuk ka informacion të saktë dhe të plotë për subjektet që ushtrojnë veprimtari në territorin e saj, gjë që shkakton mosrealizimin e të ardhurave dhe të shpenzimeve buxhetore.

Shkaku:

Mos krijimi i bazave të të dhënave, mungesa e korrespondencës dhe bashkëveprimit me institucionet e tjera, si QKB, ZVRPP, etj.

Indiferenca dhe trajtimi pa përgjegjësi i pronave të bashkisë, të cilat konsiderohen si prona personale të punonjësve apo drejtuesve.

Neglizhenca për vjeljen e të ardhurave vendore. Veprimet abuzive të personelit përgjegjës të Bashkisë Sarandë.

Rëndësia: E mesme

Për këtë rekomandojmë:

- Nga administrata e Bashkisë Sarandë duhet të verifikohen të gjitha tabelat dhe vijëzimet për parkimet e rezervuara, të cilat mbahen në mënyrë abuzive dhe të ndiqen procedurat përkatëse ligjore, sipas rastit. Për personat të cilët i kanë tabelat dhe vijëzimet dhe nuk kanë bërë kërkesa për ndërprerjen e kontratës me bashkinë, të bëhet menjëherë faturimi i vlerës totale të debisë, për të gjithë periudhën e përdorimit të tabelave.
- Bashkia Sarandë të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **720,000 lekë të 18 vendparkimeve** cilëve nuk ju është maturuar detyrimi, pavarësisht faktit se ato i shfrytëzojnë vendparkimet e rezervuara, *konkretisht:* subjekti N... për një vendparkim me vlerë **40,000 lekë**, subjekti A... për një vendparkim **40,000 lekë**, subjekti A... për një vendparkim **40,000 lekë**, subjekti S... për një vendparkim **40,000 lekë**, subjekti A... për dy vendparkim **80,000 lekë**, subjekti B... për një vendparkim **40,000 lekë**, subjekti C... për një vendparkim **40,000 lekë**, subjekti E... për një vendparkim **40,000 lekë**, subjekti F... për një vendparkim **40,000 lekë**, subjekti I... për një vendparkim **40,000 lekë**, subjekti K... për një vendparkim **40,000 lekë**, subjekti L... për një vendparkim **40,000 lekë**, subjekti R... për një vendparkim **40,000 lekë** dhe subjekti V... për katër vendparkim **160,000 lekë**
- Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **480,000 lekë** nga 12 subjekte, sipas tabelës faqe 48 të Projektraport Auditimi.

Titulli gjetjes 6: Mungesë të ardhurash, nga mos lëshimi i Liçencave/Autorizime të subjekteve që tregtojnë karburante.

Situata:

Nga auditimi i tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektesh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas) dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Kështu, nga verifikimi në faqen e internetit të QKB-së, u konstatua se në Bashkinë Sarandë, figurojnë rreth **40 subjekte** (NUIS-e sekondare, përfshirë autobotet) të cilët kanë si objekt të aktivitetit të tyre tregtinë me pakicë të karburanteve, gazit natyror, lëndëve djegëse për popullatën, etj.

Gjithashtu, nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nuk është aplikuar autorizim për tregtim karburanti.

Të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e liçencës duhet të paguajnë si më sipër.

Të dhënat për detyrimet për taksën e licencës për pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njërive të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit për taksat dhe tarifave vendore janë paraqitur në **Tabelë**.

Tabela 7. Të dhënat për subjektet që tregtojnë hidrokarbure

Nr	Subjekti	Adresa	Fillimi i Autorizimit	Përfundimi i Autorizimit	Administrator	Vlera që duhet arkëtuar	
						Për karburante	Për lëndë djegëse
1	K...	Qafë-Gjashta, 1-km larg nga qyteti i Sarandës	14.06.2012	13.06.2017	SH.K.	1,000,000	100,000
2	2...	Lagja nr.1, ne hyrje te Sarandës	27.04.2014	26.04.2019	F.G.	1,000,000	100,000
3	A...	CUKE Godine 1-kateshe,Fshati Çuke, Komuna Aliko	23.08.2020	1,000,000	J.GJ.	1,000,000	100,000
4	C...	KSAMIL Lagjja nr.2,Perballe Parkut te Lojrave	13.02.2020	1,000,000	M.M.	1,000,000	100,000
5	D...	Lagjja Nr. 1 Pike Karburanti	30.11.2016	1,000,000	H.B.	1,000,000	100,000
6	E...	KSAMIL Rruga nacionale Sarande-Ksamil, godine 1-ka			D.SH.	1,000,000	100,000
7	E...		01.12.2011	01.12.2016	A.K.	1,000,000	100,000
8	G...	Berdenesh Sarande				1,000,000	100,000
9	L...	Gjashte	28.07.2015	27.07.2020	K.I.	1,000,000	100,000
10	O...	Lagjanr. 3, 54 portit	01.12.2011	30.11.2016	A.B.	1,000,000	100,000
11	S...		14.07.2015	13.07.2020		1,000,000	100,000
12	S...		04.05.2010	03.05.2015		1,000,000	100,000
13	T...	CUKE Godine 1-kateshe,Rruga Nacionale Metoq-Konisp	14.07.2015	13.07.2020	E.S.	1,000,000	100,000
14	T...		09.08.2014	08.08.2019	E.S.	1,000,000	100,000
15	V...	GJASHTE	11.02.2015	10.02.2020	R.I.	1,000,000	100,000
16	..	BERDENESH Fshati Çuke , Te Ura e Çukes Berdenesh	20.02.2015	19.02.2020	L.K.	1,000,000	100,000

Nr	Subjekti	Adresa	Fillimi i Autorizimit	Përfundimi i Autorizimit	Administrator	Vlera që duhet arkëtuar	
						Për karburante	Për lëndë djegëse
	<i>Shuma</i>					<i>16,000,000</i>	<i>1,600,000</i>
	TOTALI					17,600,000	

Nga sa mësipërm vlera 17,600,000 lekë, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Kriteri:V

Veprime në kundërshtim me VKM-në Nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në Nr. 970, datë 2.12.2015.

Ndikimi/Efekti:

Veprime me efekt financiar negativ në buxhetin e bashkisë me vlerë 17,600,000 lekë.

Shkaku:Përgjegjësi e strukturave në zbatimin e kuadrit ligjorë.

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

- Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Policinë Bashkiake Bashkia Sarandë, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **17,600,000 lekë**, (sipas tabelës në faqen 51 të Projektraport Auditimit), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit ndaj debitorëve. Gjithashtu, të verifikojë nëse edhe subjektet e tjera të cilat në QKB figurojnë aktivë dhe me objekt aktiviteti tregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëse për popullatën, e zhvillojnë këtë lloj aktiviteti dhe të liçencohen apo të pezullohen, sipas rastit.
- Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Për sa është në këtë pjesë të Raportit përfundimtar të auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën nr. 2524/2, datë 4,7,2022 òMbi Projekt raportin e Auditimit nga L.B., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

DTTV Bashkia Sarandë, subjektet që tregtojnë karburante janë taksuar bazuar në ligjin nr. 9920, datë 10.5.2008 “për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar, ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 132, datë 7.3.2018 “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme”, si dhe paketës fiskale të VKB. VKM nr. 970, datë 2.12.2015, VKM nr. 344, datë 19.4.2017 si dhe ligji nr. 10081, datë 23.2.2009, si rregullator për licensimin e subjekteve që tregtojnë karburante, nuk i referohen në asnjë rast DTTV Bashkia Sarandë.

Qëndrimi i grupit të KLSH:

Argumentet e paraqitur nga subjekti nuk qartësojnë situatën, pasi VKM-në Nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në Nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: ò9. *Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera.”... “10. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e liçencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500,000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera.ò, tregohet qartë se subjektet qëpajsen me autorizim, autorizim i cili lëshohet nga njësitë*

vendore ku subjekti ushtron aktivitetin duhet të paguajnë tarifën e mësipërme. **Pretendimi juaj nuk qëndron.**

- **Tatimi mbi qiranë:** Referuar të dhënave mbi realizimin e të ardhura, konstatohet se ky zë është realizuar në masën 95%, ku nga vlera e planifikuar prej 5,000 mijë lekë është arkëtuar vlera prej 4,741 mijë lekë.

Nga krahasimi i dy periudhave (2020/2021), konstatohet se kemi një ulje në planifikim të paargumentuar, ku nga vlera 9,000 mijë lekë që ka qenë plani vitin 2020 në vitin 2021 ky plan është 5,000 mijë lekë, pra me një ulje prej 4,000 mijë lekë. Kjo ulje është e paargumentuar, pasi numri i kontratave të qirave nga njëra periudhë në tjetër nuk ka ndryshuar dhe në këto kushte nuk justifikohet kjo ulje.

Nga të dhënat e Drejtorisë Bujqësisë Bashkia Sarandë, konstatohet se janë lidhur 24 kontrata për kullota dimërore/ verore për një vlerë prej 604,750 lekë, vlerë e cila është likuiduar totalisht.

Nga përpunimi i të dhënave, evidentohet fakti se sipërfaqja e tokës së dhënë me qira nuk korrespondon me numrin e krerëve që operojnë në territorin e Bashkisë Sarandë, pasi numri i krerëve është më i lartë se sipërfaqeve të dhënë me qira. Sipas Drejtorisë së Bujqësisë ky fenomen është evident, por pamundësia e sipërfaqes për shfrytëzim dhe numrin të personave që kërkojnë kullota e bën të pamundur që për çdo person të jepet sipërfaqe për kullotë në raport me bagëtinë.

Gjithashtu në dosjet nuk evidentohet që të jenë kryqëzuar të dhënat me AZHBR mbi numrin e krerëve që ato kanë të deklaruar dhe numrit të krerëve mbi të cilët është lidhur kontrata.

Titulli gjetjes 7: *Mos arkëtimi i kontratave të qirave, mos aplikimi i kamatëvonesave.*

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të qirave për asetet, që Bashkia Sarandë ka me subjekte të ndryshme, rezulton se janë lidhur gjithsej 39 kontrata qiraje për objekte dhe trull me pretendimin se janë në pronësi të saj për një vlerë qiraje vjetore prej 4,864,860 lekë, nga e cila janë likuiduar për vitin 2021 vlera 3,642,560 lekë, **duke mbetur për likuidim vlera 1,222,300 lekë.**

Për asetet e dhëna me qera nga Bashkia, nga auditimi u konstatua se për asnjë rast nuk është bërë përditësimi i sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në AKSH (nëse ka) apo në listat e transferimit të pasurive nga KM. Kjo nuk është pasqyruar në inventarin e pasurive të paluajtshme dhe i ka hapur rrugë informalitetit. Gjithashtu, deri në periudhën objekt auditimi, asnjë nga objektet e dhëna me qera nuk figuron i regjistruar në AKSH, pra në asnjë rast Bashkia Sarandë nuk rezulton të disponojë Titull (Çertifikatë) Pronësie për objektet e kontraktuara. Nga sa më sipër, rezulton se ligjërisht, Bashkia ka lidhur kontrata për objekte që nuk janë të vetat.

Referuar kushteve të kontratës (neni 7 i tyre), të gjithë personat të cilat nuk ka likuiduar në afat detyrimin mbi kontratën e qirasë duhet të paralizohen në masën 0.5% për çdo ditë vonesë, **pra në vlerën 2,945,743 lekë** ($1,222,300 \text{ lekë} \times 0.5\% \times 482 \text{ ditë vonesë}$), **e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Sarandë (të dhënat sipas aneks 1)**

Gjithashtu nëse nga subjektet refuzohet pagesa po në zbatim të këtij neni nga bashkia zgjidhet kontrata për mospërmbushje të kushteve.

Kriteri: Mos zbatim i nenit 7 të kontratës, duke ngarkuar me përgjegjësi **G.K.** me detyrë specialiste juriste.

Ndikimi/Efekti: Mungesë të ardhurash në buxhetin e bashkisë.

Shkaku: Përgjegjësi e strukturave që menaxhojnë kontratat e qirave.

Rëndësia:

Për këtë rekomandojmë:

- Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,222,300 lekë**.
Gjithashtu për të gjithë subjektet që nuk kanë likuiduar në afat detyrimin e qirasë sipas kushteve të kontratës të llogariten penaltitetet (kamatëvonesat) në shumën **2,945,743 lekë**, dhe të arkëtohen vlera e detyrimit. Në rast mos pagese të detyrimeve të qirasë, Bashkia Sarandë të kërkojë prishjen e kontratës për moszbatim të kushteve të saj.
- Bashkia Sarandë të marrë masa për të bërë përditësimin e sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në ASHK Dega Sarandë (nëse ka) apo në listat e transferimit të pasurive nga KM, fillimisht për asetet e dhëna me qera dhe më pas me të gjitha asetet e saj. Këto të pasqyrohen në inventarin e pasurive të paluajtshme për të mos i hapur rrugë informalitetit. Të verifikojë gjendjen juridike të pronave të saj dhe të ndërpresë të gjitha ato kontrata për asete të cilat nuk i ka ligjërisht në pronësi.

Titulli gjetjes 8: *Mos evidentim dhe ndjekje të subjekteve që shfrytëzojnë për karrierë sipërfaqe pyjore/kullimore, viti 2021*

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit, rezultoi se në territorin e Bashkisë Sarandë ushtrojnë aktivitet 3 subjekte për shfrytëzim karriere (gurore) në sipërfaqet pyjore/kullimore, pjesë e territorit të kësaj njësie vendore, kaluar me VKM nr. 684, datë 2.9.2020 òPër disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 433, parcelat 4,17 dhe 18. Nga grupi i KLSH u kërkuar informacion në lidhje me këto subjekte, por që nuk disponohej asnjë e dhënë.

Grupi i KLSH në zbatim të nenit 15 dhe 26, të ligjit 154/20214 òPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, me shkresën prot Bashkia Sarandë nr. 1804, datë 28.4.2022, ju kërkuar Kryetarit të Bashkisë Sarandë ngritjen e një grupi pune mbi verifikimin në terren të këtyre subjekte.

Me datë 15.5.2019 nga M.L. me detyrë specialist i menaxhimit të pyjeve dhe kullotave, konfirmon se:

Në zbatim të udhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 78, datë 29.4.2022 është ngritur grupi i punës për verifikimin e problemit, nga ku rezultoi se në territorin e Bashkisë Sarandë ushtrojnë aktivitet shfrytëzim gurore 3 subjekte, konkretisht: A..., I...sh.p.k dhe P...sh.p.k.

Me shkresat nr. 1893/1,2,3 datë 4.5.2022 i është kërkuar informacion subjekteve në lidhje me detyrimet për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullimore, duke konkluduar se:

1- Shoqëria A...sh.p.k ushtron aktivitet në parcelën kullimore 18 me emërtimin (Gurrës Voller), me sipërfaqe 69.71 ha me leje minerale nr. 59, datë 24.4.2012 për periudhën 3.9.2012 deri më 3.7.2022 me sipërfaqe shfrytëzimi 0.5 km = 5 ha, deri në fund të lejes.

Subjekti ka kontratë me Bashkinë Himarë për një periudhë 4 vjeçare e cila fillon me datë 23.5.2018 dhe mbaron me datë 22.5.2022 për tarifën **148,500 lekë/viti**.

Referuar dispozitave të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 òPër disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò (tabela 6), konstatohet se kontrata e qirasë për shfrytëzim të sipërfaqeve është llogaritur në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, tabela 6, pasi për sipërfaqen në shfrytëzim detyrimi i qirasë vjetore do duhej të ishte në vlerën **2,475,000 lekë** (5 ha x 495,000 lekë/ha/viti x 4 vite).

Pra për kontratën 4 vjeçare shoqëria ka paguar 148,500 lekë x 4 vite = 594,000 lekë ose më pak se vlera reale për shumën **1,881,000 lekë**(2,475,000 – 594,000), **e ardhur e munguar**.

Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar,Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Sarandë në zbatim të VKM nr. 684, datë 2.9.2020 duhet të kishte kërkuar në Bashkinë Himarë dosjen e subjektit dhe arkëtimin e detyrimit që nga datë 2.9.2020, gjë e cila nuk ka ndodhur dhe reflektimin e ndryshimeve për kontratën e qirasë.

2- Shoqëria P...sh.p.k ushtron aktivitet në parcelën 17 me emërtesë (Vollder) me sipërfaqe totale 37.02 ha.

Shoqëria është pajisur me leje minerale nr. 661/1, datë 19.12.2012 për sipërfaqen e shfrytëzueshme prej 0.107 km = 10.7 ha. Sipas të dhënave kjo shoqëria nuk ka kontratë qiraje as me Bashkinë Himarë dhe as me Bashkinë Sarandë. Nga shoqëria janë depozituar dy vendime gjyqësore (nr. 405, datë 20.3.2002 dhe nr. 4, datë 7.2.2021), për njohjen e pronësisë, por që nuk janë përkthyer në certifikatë pronësie.

Nga sa trajtohet shoqëria ka shfrytëzuar pasurinë shtetore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë.

Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 òPër disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò (tabela 6), detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **5,778,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 10.7)**, e ardhura munguar në buxhet. Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që shoqëria ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2021.

3- Shoqëria I...sh.p.k ushtron aktivitet në parcelën 4 me emërtesë (Cerek Uaturica) me sipërfaqe totale 92.08 ha.

Shoqëria është pajisur me leje minerale për sipërfaqen e shfrytëzueshme prej 0.186 km = 18.6 ha për periudhën 26.12.1995 ó 29.12.2017. Sipas të dhënave kjo shoqëria nuk ka kontratë qiraje as me Bashkinë Himarë dhe as me Bashkinë Sarandë.

Shoqëria disponon certifikatë pronësie me nr. 1/269 për sipërfaqen 3.5 ha, duke mbetur sipërfaqe shtet 15.1 ha, për të cilën duhej kontratë qiraje.

Nga sa trajtohet shoqëria ka shfrytëzuar pasuri shtetore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë.

Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 òPër disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò (tabela 6), detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **8,154,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 15.1)**, e ardhura munguar në buxhet. Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që shoqëria ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2021.

Nga sa trajtuam më sipër, Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar,Pyjeve,Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Sarandë duhet të vijojë me procedurat për menaxhimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore në shfrytëzim nga subjektet e mësipërme, ku për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi të sipërfaqeve Pyjore dhe kullosore dhe nuk janë lidhur kontrata, duhet të bëhet pezullimi i veprimtarisë së shfrytëzimit të sipërfaqeve Pyjore dhe Kullosore, deri në momentin e çregjistrim nga fondi pyjorë kullosor për saktësimin e pronarit të pronës.

Nëse pas daljes së VKM për destinacionin se kush është pronarë i ligjshëm i sipërfaqes për të cilën është lëshuar leja minerale dhe nëse ajo është në juridiksion të Bashkisë Sarandë, të lidhen kontratat e qirasë.

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 òPër disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò nenin 24, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 òPër sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisëò, me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, òPër pyjet dhe shërbimin pyjorë, të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, òPër Fondin Kullosorë, me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, òPër rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjorë, ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008,

Ëpër rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullësor i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016.

Ndikimi/Efekti:

Mos kryerja e kontrolleve në territorin e Bashkisë Sarandë nga subjekte që shfrytëzojnë sipërfaqe pyjore/kollusore, çojnë në mos rigjenerim të ardhurash në buxhet dhe dëmtim të këtyre sipërfaqeve.

Shkaku:

Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse të Bashkisë Sarandë.

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Sarandë, të marrë masa për:

- Tërheqjen e dokumentacionit të subjektit A...sh.p.k, me kontratë qiraje me Bashkinë Himarë, por që janë kaluar në juridiksion të Bashkisë Sarandë, si dhe të bëhet rillogaritja e detyrimit për kontratën e qirasë të llogaritur në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke krijuar një të ardhur të munguar në vlerën **1,881,000 lekë**, kjo për shoqërinë A...sh.p.k.
Për sipërfaqet e mbyllura të kërkohet nga subjekti zbatimi i raportit teknik për ripyllëzime zonës së shfrytëzueshme.
- Subjektet P...sh.p.k dhe I...sh.p.k, të cilët nuk kanë kontratë as me Bashkinë Himarë dhe as me Bashkinë Sarandë, por kanë vijuar me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kollusore pronë e Bashkisë Sarandë, të bëhet bllokimi i aktivitetit deri në marrjen e vendimit nga Ministria e linjës për sipërfaqet nën 1 ha ose nga KM për sipërfaqet mbi 1 ha, mbi pronësinë e sipërfaqes që do shfrytëzohet nga subjektet.
- Për sipërfaqen rrugë kalimi dhe vendepozitim që subjektet shfrytëzojnë deri në sipërfaqen e miratuar sipas lejes minerale, të bëhet saktësimi dhe përllogaritjen e detyrimeve për qiranë nga Bashkia Sarandë.
- Për sipërfaqet e shfrytëzueshme nga shoqëritë P...sh.p.k dhe I...sh.p.k pa kontratë qiraje deri më 31.12.2021, të kërkohet detyrimi në vlerën 13,932,000 lekë, nga e cila: për shoqërinë P...sh.p.k në vlerën 5,778,000 lekë dhe shoqërinë I...sh.p.k në vlerën 8,154,000 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, si dhe kërkohet ripyllëzimi i sipërfaqeve sipas raportit teknik të miratuar me marrjen e lejes minerale.

Titulli gjetjes 9: *Mos aplikim i tarifave vendore nga subjektet juridike që lidhin kontratë shërbimi/ investimi me Bashkinë Sarandë, por nuk janë në regjistrin tregtar të kësaj njësie vendore.*

Situata:

Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të lartë dhe të vogël, konstatohet se janë lidhur kontrata për blerje mallrash dhe investime me subjekte të cilat nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtar të Bashkisë Sarandë.

Sipas të dhënave mbi aplikimin e detyrimeve për vitin nga DTV Bashkia Sarandë, konstatohet se për këto subjekte nuk është kërkuar pajisja me Nipt sekondarë për periudhën e zbatimit të kontratës, si dhe nuk është bërë maturimi i detyrimeve për taksa/tarifa vendore në masën 95,000 lekë, siç është përcaktuar në VKB-në nr. 167, datë 27.11.2020 për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021.

Gjithsej evidentohet një detyrim i patakshuar në vlerën 1,615,000 lekë, kjo për 20 subjekte, si e ardhur e munguar.

Gjithashtu nga auditimi mbi procedurën e njoftimit të subjekteve tatimpagues të detyrimeve vjetore për taksa e tarifa vendore, u konstatua se DTV Bashkia Sarandë nuk vepronte në përputhje me dispozitat ligjore, pasi pas nxjerrjes së njoftimit detyrimit, po nga administrata e

DTV Bashkia Sarandë me kërkesë të subjektit nxirrej një mandat pagesë për një shumë të caktuar, e cila nuk është sa shuma e njoftim detyrimit por më e vogël.

Kjo lloj procedura e ndjekur është e kundërligjshme ose njëmarrëveshje për pagesë me këste e paligjësuar, veprime të cilat çojnë në mos arkëtimin e detyrimeve vjetor dhe rritjen e nivelit të borxhit në fund të periudhave ushtrimore, ku për këtë njësi vendore është shumë e lartë prej 430 milionë lekë.

Kriteri:

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, *ōPër Procedurat Tatimoreō*, i ndryshuar, nenin 22 i ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 *ōPër Qendër Kombëtare të Regjistrimit (QKB)*, i ndryshuar; nenin 15 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *ōPër Sistemin e Taksave vendoreō*, i ndryshuar, VKB-në nr. 167, datë 27.11.2020 *ōPër miratimin e paketës fiskale të vitit 2021ō*.

Ndikimi/Efekti:

Mos evidentimi dhe regjistrimi me Nipt sekondarë i subjekteve që ushtrojnë aktivitet jashtë juridiksion ku ato kanë selinë qendrore, çon në të ardhura të munguara në buxhet në shumën 1,650,000 lekë.

Shkaku: Përgjegjësi e strukturave përgjegjëse në menaxhimin e taksave dhe mungesë bashkëpunimi midis drejtorive Bashkia Sarandë

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

- Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Bashkia Sarandë, të bashkërendojnë punën për evidentimin e subjekteve fizik/juridik që nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të kësaj njësie vendore, për pajisjen me Nipt (Nius) sekondarë dhe matarimin e detyrimeve për taksa e tarifa vendore.
- Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të pamatuaruar në vlerën **1,650,000 lekë** ndaj **20 subjekteve**, sipas tabelës faqe 56 të Projektraport Auditimit.
- Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të eliminojë praktikën e nxjerrjes së mandat pagesave pjesore të detyrimeve, pasi subjektet të jenë pajisur me njoftim detyrimi vjetorë ku të ngarkohet dhe për detyrimin e prapambetur.

Për sa është në këtë pjesë të Raportit përfundimtar të auditimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacion me shkresën nr. 2524/2, datë 4.7.2022 *ōMbi Projekt raportin e Auditimitō* nga L.B., ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendim i subjektit:

Në lidhje me subjektet juridike që kanë lidhur kontrata shërbimi me Bashkinë Sarandë dhe nuk janë taksuar, sqarojmë se subjektet që kanë regjistruar aktivitet ose adresë sekondare detyësore janë taksuar konformë ligjit, duke paguar dhe detyrimet fiskale. Ndërsa për subjektet e tjera të cilat nuk kanë nipt sekondarë nuk janë taksuar.

Qëndrim i grupit të KLSH:

Pretendimet që paraqisni nuk argumentojnë gjetjet e KLSH, pasi çdo subjekt që ushtron aktivitet në territorin e Bashkisë Sarandë, duhet të paguaj detyrimet vendore fiskale dhe nuk duhet lejuar të ushtrojnë aktivitet pa regjistruar me nipt sekondarë në zbatim të ligjit nr. 9920, datë 10.5.2008 *ōPër procedurat tatimore në RSHō*, i ndryshuar. **Pretendimi juaj nuk merret në konsideratë.**

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

L.B. me detyrë Drejtor i DTTV Bashkia Sarandë.

N.A. me detyrë Specialiste e borxhit fizik/juridik.

K.K. me detyrë Drejt/Drejtoria e Bujqësisë Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit.

G.K. me detyrë specialiste juriste.

TH.B. me detyrë Specialist transporti në Drejt Shërbimeve Publike.
G.D. me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike.

-Mbi llogaritjet e TNI në subjektet me leje ndërtimi.

Titulli i gjetje 10: *Mos llogaritja e saktë e taksës së ndikimit në infrastrukturë (TNI), në zbatim të ligjit.*

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi llogaritjen e TNI për disa nga objektet me leje ndërtimi dhe përdorimi, rezulton se nuk është llogaritur në zbatim t dispozitave ligjore, veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhurash për Bashkinë Sarandë në shumën **150,332 lekë**, konkretisht:

1. E.R. dhe O.J. - Leje Ndërtimi me nr.1887 prot. datë 20.04.2021 është miratuar me Vendim nr.409, datë 16.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, për objekt: "*Ndërtim pishine dhe 1 kat parkimi nëntokë ne godine banimi 2-kate*" me subjekt zhvillues M...sh.p.k.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukturë behet në bazë të çmimit të shtetit për Bashkinë Sarandë. Fatura e pagesës së TNI datë 02.06.2021 është 144,735 lekë, fatura e aplikimit datë 02.06.2021 është 10,000 lekë, fatura për pajisje me leje ndërtimi datë 18.03.2021 është 10,000 lekë. Sipërfaqja totale e objektit është 127m². Duke e përlllogaritur me 3% x 127 m² x 32,739 = 124,735lekë + 10,000 lekë fature aplikimi+ 10,000 lekë fature për pajisje me leje ndërtimi.

TNI është përlllogaritur dhe arkëtuar me vlerë 3% x 127 m² x 32,739 = 124,735 lekë (paguar) nga zhvilluesi.

Llogaritja sipas çmimit të shitjes sipas vlerës së preventivit:

Nisur nga dosja fizike, projekti arkitektonik dhe konstruktiv si dhe nga akti i vlerësimit të TNI, subjekti ka paraqitur preventiv në vlerën 6,111,021 lekë.

TNI = Vlerë preventivi 6,111,021 lekë x 3% = 183,330 lekë.

Nga DPZHT është llogaritur TNI vlera prej 124,735 lekë ose më pak për vlerën 58,595 lekë (183,330 – 124,735), mungesë të ardhura në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

2. F.P. - Leje Ndërtimi me nr.2018 prot. datë 13.07.2021 është miratuar me Vendim nr.425 datë 13.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, për objektin: "*Hotel 4 kate me 2 kate nën tokë, podrum dhe garazhe*" me subjekt zhvillues M...sh.p.k, me përdorim të lejuar shërbime, adresë njësia Administrative Ksamil, Bashkia Sarandë.

Llogaritja e TNI behet në bazë të çmimit të shtetit për Bashkinë Sarandë. Fatura e pagesës së TNI datë 04.10.2021 është 990 077 lekë, fatura e aplikimit datë 04.10.2021 është 10,000 lekë, fatura për pajisje me leje ndërtimi datë 04.10.2021 është 10,000 lekë. Duke e përlllogaritur me 3% x 1008 m² x 32,739= 990,077 lekë + 10,000 lekë fature aplikimi+ 10,000 lekë fature për pajisje me leje ndërtimi.

TNI është përlllogaritur dhe arkëtuar në vlerën 3% x 1008 m² x 32,739 = 990,077 lekë(paguar) nga zhvilluesi.

Llogaritja sipas çmimit të shitjes sipas vlerës së preventivit:

Nisur nga dosja fizike, projekti arkitektonik dhe konstruktiv si dhe nga akti i vlerësimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, subjekti ka paraqitur preventiv në vlerën 35,082,531 lekë.

TNI = Vlerë preventivi 35,082,531 lekë x 3% = 1,052,476 lekë.

Nga DPZHT është llogaritur TNI vlera prej 990,077 lekë ose më pak për vlerën 62,399 lekë (1,052,476 – 990,077), mungesë të ardhura në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

3. **V.GJ.**- Leje Ndërtimi me nr.1707 prot. datë 17.11.2020 është miratuar me Vendim nr.395 datë 11.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, për objekt: ‘*Shtese 3 kate ne objekt ekzistues 1 kat, ne funksion te Turizmit*’ ø me subjekt zhvillues L...sh.p.k. , me përdorim të lejuar shërbime, adresë njësia Administrative Ksamil, Bashkia Sarandë.

Llogaritja e TNI behet në bazë të çmimit te shtetit për Bashkinë Sarande. Fatura e pagesës së TNI datë 18.01.2021 është 327 062 lekë fatura e aplikimit datë 18.01.2021 është 10,000 lekë, fatura per pajisje me leje ndërtimi datë 04.10.2021 është 10,000 lekë. Sipërfaqja totale e objektit qe shtohet është 333m² (147m² kati i pare +147m² kati i dyte +39m² kati i trete). Duke e përlllogaritur me 3% x 333 m² x 32,739= 327 062 lekë

TNI është përlllogaritur dhe arkëtuar me vlerë 3% x 333 m² x 32,739= 327 062 lekë (paguar) nga zhvilluesi.

Llogaritja sipas çmimit të shitjes sipas vlerës së preventivit:

Nisur nga dosja fizike, projekti arkitektonik dhe konstruktiv si dhe nga akti i vlerësimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, subjekti ka paraqitur preventiv në vlerën 11,880,000 lekë.

TNI = Vlerë preventivi 11,880,000 lekë x 3% = 356,400 lekë.

Nga DPZHT është llogaritur TNI vlere prej 327,062 lekë ose më pak për vlerën 29,338 lekë (356,400 – 327,062), mungesë të ardhura në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 28/2017 òPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.107/2014 òPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò, të ndryshuar , ku citohet:

ò1.Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja zbatohet për zhvillimet e reja që, sipas këtij ligji, kërkojnë pajisjen me leje ndërtimi dhe llogaritet sipas legjislacionit për sistemin e taksave vendore.ò

Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò me të gjitha ndryshimet, neni 27 pika 1 e tij citon:

òBaza e taksës është vlere në lekë e investimit të ri që kërkohet të kryhet **sipas preventivit, ose vlere në lekë e çmimit të shitjes për metër katror** të investimit të ri. Klasifikimi si investim i ri përcaktohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për dhënien e lejes së ndërtimit.”

Neni 27 pika 2 e ligjit nr.142/2015 datë 17.12.2015 òPër disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò citon:

“Në rastin e ndërtimeve për qëllime banimi apo njësi shërbimi nga shoqëritë e ndërtimit, të cilat nuk destinohen për përdorim në sektorin e turizmit, industrisë apo përdorim publik, taksa e ndikimit në infrastrukturë është në masën 4 për qind deri 8 për qind të çmimit të shitjes për metër katror. Baza e taksës është vlere në lekë për metër katror e çmimit të shitjes së njërive të shërbimit apo ndërtesave për qëllime banimi. Çmimi i shitjes për metër katror bazohet në vlerën referuese të vlerës së tregut, sipas përcaktimeve në udhëzimin e Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave”, që miratohet çdo vit.”

Ndikimi/Efekti:

Mos llogaritja saktë e TNI, krijon të ardhura të munguara në buxhetin e bashkisë Sarandë në vlerën 150,332 lekë.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.

Rëndësia: E mesme

Për këtë rekomandojmë:

- Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike bashkia Sarandë, të marrin masat për njoftimin subjekteve dhe arkëtimin e vlerës **150,332 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, *respektivisht:*

- vlere **58,595 lekë** nga investitorit **E.R. dhe O.J.**

- vlere **62,393 lekë** nga investitori **F.P.**

- vlere **29,338 lekë** ndaj investitorit **V.GJ.**

- Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit, për rastet kur investitorët e mësipërm nuk janë pajisur me certifikatë përdorimi të mos lëshohet pa derdhur diferencat e pallogaritur. Në rast të dhënies së lejes së përdorimit ti kërkohet ASHK Drejtoria Rajonale Sarandë që për rastet e mësipërme të mos veprohet në dhënie e certifikatës së pronësisë ose në rast se është lëshuar të bëhet kufizim pasurisë deri në likuidimin e diferencave.

Titulli i gjetjes 11: *Diferenca të konstatuara në mos llogaritjen e TNI të subjekteve me certifikatë përdorimi.*

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit teknik e ligjor të subjekteve të pajisur me certifikatë përdorimi, ku konstatohet se për 19 rastet e dhënies e certifikatës së përdorimit është e njëjta me atë të lejes së ndërtimit.

Por konstatohet se në tre raste situacionet përfundimtare të paraqitura nga investitorët janë me vlerë më të lartë se vlera e preventivit ose çmimit mbi të cilën është llogaritur TNI, për të cilën nga personat përgjegjës nuk është llogaritur diferenca e krijuar në vlerën **677,218 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ në buxhet, konkretisht:**

- 1- Objekti me zhvillues òA.D., E.D.ò, ka paraqitur vlerën e situacionit prej 44,745,876 lekë, ku TNI është në shumën 1,342,763 lekë (44,745,876 x 3%). Investitori fillimisht ka likujduar TNI në shumën 805,476 lekë, **duke mbetur për diferencë shuma 536,900 lekë (1,342,763 – 805,476).**
- 2- Objekti me zhvillues òN.R.ò, ka paraqitur vlerën e situacionit prej 73,842,414 lekë, ku TNI është në shumën 2,215,272 lekë (73,842,414 x 3%). Investitori fillimisht ka likujduar TNI në shumën 2,137,630 lekë, **duke mbetur për diferencë shuma 77,642 lekë (2,215,272 – 2,137,630).**
- 3- Objekti me zhvillues òE.D.ò, ka paraqitur vlerën e situacionit prej 7,819,224 lekë, ku TNI është në shumën 234,576 lekë (7,819,224 x 3%). Investitori fillimisht ka likujduar TNI në shumën 171,900 lekë, **duke mbetur për diferencë shuma 62,676 lekë (234,576 – 171,900).**

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 28/2017 òPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.107/2014 òPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò, të ndryshuar; Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò me të gjitha ndryshimet, neni 27 pika 1; Neni 27 pika 2 e ligjit nr.142/2015 datë 17.12.2015 òPër disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò.

Ndikimi/Efekt:

Mos llogaritja saktë e TNI, krijon të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë në vlerën 677,218 lekë.

Shkaku: Mos zbatimi i kuadrit ligjorë nga personat përgjegjës.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

- Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masat për njoftimin subjekteve dhe arkëtimin e vlerës **677,218 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, *respektivisht:*

- vlera **536,900 lekë** nga zhvilluesi òA.D., E.D.ò

- vlera **77,642 lekë** nga zhvilluesi òN.R.ò

- vlera **62,676 lekë** ngazhvilluesi òE.D.ò

- Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikim Zhvillim Territorit ti kërkojë ASHK Drejtoria Rajonale Sarandë që për rastet e mësipërme të

mos veprohet në dhënie e çertifikatës së pronësisë ose në rast se është lëshuar të bëhet kufizim pasurisë deri në likuidimin e diferencave.

Pika 2.3 e programit. Vlerësim i raportimit financiar për të arritur në opinionin nëse pasqyrat financiare për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021.

- Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:

Për vitin 2021 nga njësia shpenzuese Aparati i Bashkisë Sarandë për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. nr.25/2018, datë 01.01.2019 datë 29.4.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 dhe Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme të ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022, VKM Nr.783, datë 22.11.2006 dhe Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël.

- Hartimi i pasqyrave financiare të Bashkisë Sarandë.

Bashkia Sarandë për vitin 2021 ka hartuar Pasqyrat Financiare të Bashkisë Sarandë.

- Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Sarandë për vitin ushtrimor 2021 me shkresë përcjellëse nr.prot.1271 datë 28.03.2022. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Nënkryetari Bashkisë Sarandë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Drejtore Drejtorisë Ekonomike. Pra në këtë rast kemi delegime të këtyre detyrave.

- Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.

Për vitin 2021 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakte banke (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditarit i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;

- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë .

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.

- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program Excel

- Janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

- Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave dhe janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera , duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.

Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat të nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

- Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik - financiar 01.01.2021 deri më datën 31.12.2021.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2021 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2020.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2020 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Nga verifikimi i akt-rakordimit vjetor të thesarit për treguesit e realizimit të buxhetit dhe krahasuar këto me veprimet kontabël në llogarinë e 520 Disponibilitete në Thesarë dhe në ditarin e bankës rezultojnë të jenë rakorduara, veprime të paraqitura në me formatin nr.5 Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2021

Totali i Aktivit për vitin 2020 është në vlerën 4.678.295.926 lekë dhe për vitin 2021 është 4.839.997.613 lekë , i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari, sipas Aneksit 2.3.1 bashkëlidhur Projektraport Auditimit.

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në mbyllje të vitit 2020 është në vlerën 273.984.965 lek dhe në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 353.005.397 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V ÷ Teprica ne fillim te vitit ushtrimorë dhe rubrikën VI ÷ Teprica e Likuiditeteve ne fund te vitit ushtrimorë në Formatin nr.3 ÷ Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLO) sipas metodës direkte .

- **Gjendja e llogarisë 520 “Disponibilitete në Thesar”** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2020 është në vlerën 273.984.965 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 353.005.397 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, ku lëvizjet e këtyre disponibiliteteve paraqiten në me formatin nr.3 ÷ Pasqyrë e lëvizjes në cash viti 2021 .

Në klasën 3 “Gjendja e inventarit qarkullues” të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 10.807.374 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 9.541.700 lekë, ku diferenca e tyre në zbritje në vlerën prej 1.265.674 lekë rakordon me gjendjen e llogarisë 63 ÷ Ndryshimi i gjendjeve të inventaritë në formatin nr.2 ÷ Pasqyra e performancës financiare. Këto vlera në mënyrë analitike paraqiten në gjendjet e llogarive:

Gjendja e llogarisë 31 “Materiale” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 5,863,533 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 3,556,859 lekë, me një diferencë në zbritje për vitin ushtrimor prej 2,306,674 lekë, e cila përfaqëson ulje te gjendjes se mallrave ne fund te vitit 2021. Kjo llogari është e analizuar për gjendjen datë 31.12.2021 në shumën 3,556,859 lekë, duke bërë sondazhe për 9 artikuj në inventarin fizik.

- **Gjendja e llogarisë 32 “Inventari i imët ”** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 4.943.841 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 5.984.841 lekë me një diferencë në rritje për vitin ushtrimor prej 1.041.000 lekë, e cila përfaqëson rritje te inventarit te imët per vitin 2021.

Klasa 4 “Llogari të arkëtueshme” paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 465.980.193 lekë dhe në mbyllje të bilancit të vitit 2021 në vlerën 497,441,720 lekë, ku kemi shtim duke e krahasuar me vitin paraardhës.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në mbyllje të vitit 2020 është në vlerën 448,543,199 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 paraqitet në vlerën 481,241,985 lekë. Vlera e debitorëve ne vitin 2021 në krahasim me vitin 2020 ka pësuar një rritje prej 32,698,786 lekë, në të cilën ka ndikuar rritja e debitorëve të taksave në vlerën 31,003,793 lekë. Në vlerën e lartë të gjendjes së llogarisë së debitorëve ka ndikuar edhe gjendja e debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të lëna nga KLSH në vite në vlerën 162,031,719 lekë, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërkimit. Analiza e gjendjes së llog. ÷ Debitorë të ndryshëm dhe lëvizjet e pësuar në vitin ushtrimor, krahasuar me vitin paraardhës paraqiten në tabelën e mëposhtme, ndërsadebitorët e analizuar sipas rekomandimeve të lëna nga Kontrollit të Lartë të Shtetit në vite deri me datë 31.12.2021 paraqiten në Aneksin A/1.

Gjendja e llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” me date 31.12.2021

NR.	Debitorët llogaria 468	Gjendja me 31.12.2020	Shtesa per 2021	Pakësime 2021	Gjendja me 31.12.2021
	Bashkia Sarande				0
1	K...		5,365,918		5,365,918
2	A...		417,600		417,600
3	M...		45,5850		455,850

NR.	Debitorët llogaria 468	Gjendja me 31.12.2020	Shtesa per 2021	Pakësime 2021	Gjendja me 31.12.2021
4	E...		509,625		509,625
5	Debitore te KLSH ne vite	162,256,719		225,000	162,031,719
6	Debitore te taksa tatimeve ne vite	286,286,480	46,525,793	15,522,000	317,290,273
7					
	Totali	448,543,199	53,274,786	1,5747,000	486,070,985

Titulli gjetjes 1: Mbi kontabilizimet në llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” dhe mosveprimet për mbledhjen e detyrimeve të të tretëve ndaj Bashkisë.

Situata:

Në fund të vitit 2021 në gjendjen e konsiderueshme të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm” prej 481,241,985 lekë, përveç debitorëve të taksave ka ndikuar dhe vlera e lartë e gjendjes në vlerën 162,031,719 lekë të debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të rekomanduara nga KLSH në vite për Bashkinë dhe ish-Komunat, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtimin e këtyre detyrimeve, duke kaluar afatet e kërimit.

Kriteri:

Ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollin e ndryshuar me Ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 9,11 dhe 12, ligji nr. 68/2017 datë 27.4.2017 për financat e vetëqeverisjes vendore të ndryshuar, neni 40.

Impakti: Efekt negativ në rritjen e të ardhurave

Shkaku:

Puna e pa mjaftueshme dhe mos marrja e masave të nevojshme për mbledhjen e detyrimeve të tretëve që kanë ndaj Bashkisë.

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

- Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtoria Ekonomike dhe Drejtorinë Juridike të marrë masat që për debitorët në vlerën 162,031,719 lekë të rekomanduar në vite nga KLSH por të paarkëtuara, të cilave po ju kalon afati ligjor i kërimit, të zbërthejë dokumentacionin ligjor për to, duke i klasifikuar sipas afateve dhe për detyrimet deri në 5 vjet të nxjerrë akte administrative për rivendosjen e afateve dhe kërkimin e tyre në rrugë administrative dhe ligjore.
- Të mos lidhen kontrata dhe të përjashtohen nga procedurat e prokurimit pa bërë më parë likuidimin e detyrimeve që ato kanë ndaj Bashkisë Sarandë dhe të paankimuar prej tyre.

- **Gjendja e llogarisë 4342** ÷ Të tjera operacione me shtetin (të drejta) ÷ në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në shumën 16,199,735 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2021, që trashëgohen në vitin 2022. Kjo gjendje në analizë përfshin gjendjet e llogarive në pasivin e bilancit: llog.42 ÷ Detyrime ndaj personelit ÷ për vlerën 6,464,869 lekë, llog.431 ÷ Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa ÷ për vlerën 512,675 lekë, llog.435 ÷ Sigurime shoqërore ÷ për vlerën 1.999.317 lekë, llog.436 ÷ Sigurime shëndetësore ÷ për vlerën 269.746 lekë dhe llog.401-408 ÷ Furnitorë e llogari te lidhura me to ÷ me vlerën 6,953,128 lekë.

Klasa 4 “Të tjera aktive afatshkurtra” e cila përbëhet nga :

Gjendja e llogarisë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme” paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 57,200,636 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 30,401,541 lekë, e cila rakordon me gjendjen e llog.467 ÷ Kreditorë të ndryshëm ÷ në pasiv të bilancit.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:

Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:

- Për auditimin e aktiveve afatgjata materiale, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata materiale në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet afatgjata materiale;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konformë parimeve të përgjithshme të pranuar dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik.

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 6 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);
- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 3 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:

- Proçedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuar;
- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj.);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 “Aktivet Afatgjata” në aktiv të bilancit gjendja në total në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 3,870,322,758 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3,949,607,255 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)öparaqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 4,346,306,759 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,650,121,643 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 “Aktive Afatgjata jo materiale” që përbëhet nga:

- **Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”** në aktiv të bilancit paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020 në shumën prej 18,753,229 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 15,940,245 lekë, diferenca është vlerë e amortizimit të llogaritur. Ndërsa sipas Formatit 7/a òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ö gjendja paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 119,561,177 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën prej 119,561,177 lekë, që i përket 113 projekt-studimeve për investime. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar dhe paraqitet në Aneksin A/2.

Titulli gjetjes 2: Mbi saktësinë e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime”, veprimet kontabël të kryera në këtë llogari dhe analiza e saj.

Situata:

Gjendja e llogarisë 202 “Studime dhe kërkime” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet me vlerë neto 15,940,245 lekë dhe me vlerë bruto prej 119,561,177 lekë (kosto historike), që i përket 113 projekt-studimeve për investime. Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 14,433,919 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llogarisë 202 “Studime dhe Kërkime”, për 112 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe ruajtja e tyre është bërë në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve.

Kriteri:

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme dhe Aneksi 1. Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publikë pika 2, Klasa 2 Aktivet Afatgjata (Përbërja dhe trajtimi kontabël), Pika 3.3 Rregullat e plotësimit të pasqyrës financiare individuale të pozicionit financiar (bilanci), nënpika 62. Nënpika “Aktivet afatgjata jo materiale”

Ndikimi/Efekt

Mos pasqyrim i saktë i vlerës së plotë të aktiveve afatgjata dhe pozicionimit të pasaktë në llogari të shpenzimeve të studim-projektimit me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara..

Shkaku:

Nga Drejtoria e Financës nuk është kryer e mjaftueshme për kryerjen e veprimeve rregulluese të kësaj llogarie

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të marrë masa që projektet që i përkasin vlerës së pa analizuar prej 14,433,919 lekë dhe të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e koston së tij.

- *U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2021.*

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) “Aktivet afatgjata materiale” paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 3,933,667,010 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/a Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) paraqiten në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 4,530,560,466 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- **Gjendja e llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”** paraqitet me vlerë bruto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 115,397,833 lekë. Këto gjendje paraqiten të analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llogarisë 210 "Toka Troje Terrene" me date 31.12.2021

NR	LLOG	Emërtimi	Gjendja me 31.12.2020	Viti 2021	Gjendja me 31.12.2021
	210	TOKA TROJE TERRENE	115,397,833	-	115,397,833
1	210	Investime gjelbërimi	1,788,653		1,788,653
2	210	Mbjellje peme	8,483,448		8,483,448
3	210	Rikonstruksion plazhi +Rritja e kap. Te Gjelbërta ne Qytet	9,497,630		9,497,630
4	210	Lulishte	73,739		73,739
5	210	Parqe	1,669,977		1,669,977
6	210	Gjelberimi i shëtitores	173,303		173,303
7	210	Sistemimi i plazhit te ri Sarande	2,483,350		2,483,350
8	210	Sistemimi i plazhit te vjetër Sarande	4,985,914		4,985,914
9	210	Per mbrojtjen e tokës bujqësore	519,068		519,068
10	210	Sipërfaqja e rrethuar e Shtëpisë se Pushimit te Ushtarakeve	166,800		166,800
11	210	Mbjellje peme Dekorative rruga nr. 4, lot 1+super.	3,526,241		3,526,241
12	210	Mbjellje peme Dekorative rruga nr. 5,lot 2+super.	3,526,260		3,526,260
13	210	Mbjellje peme Dekorative rruga Limjon,L.Dardhes,rruga V.Pandi	3,022,880		3,022,880
14	210	Rikonstruksion i Stadiumit te Futbollit Sarande	33,220,160		33,220,160
15	210	Rikonst. i Stadiumit te Futbollit Sarande (tapeti pjesa e Federatës)	12,685,938		12,685,938
16	210	Sistemimi i Tregut Fruta Perime (mbulesa)	3,285,939		3,285,939
17	210	Rritja e kapaciteteve te Gjelbërta mbjellje peme	3,585,535		3,585,535
18	210	Permiresimi i kushteve te Plazheve ne Qytet	430,920		430,920
19	210	Rritja dhe përmirësimi i kapaciteteve te plazheve urbane	1,068,750		1,068,750
20	210	Mbjellje peme dekorative rruga Hyrëse	5,240,064		5,240,064
21	210	Vendosje vazo dekorative ne Qytet	447,192		447,192
22	210	Investim per token bujqes,rehabilim kanaleve ujitës e kullues	1,632,427		1,632,427
23	210	Investim per rinovim infrastrukturë agrare per fshatin Metoq-Gjashte	1,394,898		1,394,898
24	210	Investim per rinovim infrastrukture agrare per fshatin Shelegar	199,200		199,200
25	210	Ndertim lulishte 2005	1,285,766		1,285,766
26	210	Ndertim lulishte 2007	7,403,000		7,403,000
27	210	Peme dekorative 2008	921,601		921,601
28	210	Vendqëndrim mbeturinash 2008	1,182,780		1,182,780
29	210	Ndertim memorial 2010	1,496,400		1,496,400

Titulli gjetjes 3: Mbi kontabilizimet e aktiveve në llogarinë 210 "Toka Troje Terrene" dhe klasifikimi i tyre.

Situata:

Gjendja e llog. 210 "Toka, Troje, Terrene" paraqitet me vlerë bruto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 115,397,833 lekë.

Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 210 "Toka Troje Terrene", konstatohet se në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 14 artikuj aktive materiale në vlerën 38,081,192 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione".

Kriteri:

Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeò Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 òAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publikò i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, Pika 2. Klasa 2, òAktivet afatgjataò (përbërja dhe trajtimi kontabël), òKlasifikimi kontabëlò, me Nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

Impakti:

Pasqyrim dhe pozicionim i pasaktë i aktiveve afatgjata materiale në llogarinë 210 "Toka Troje Terrene" me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku:

Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të gjendjes së llogarisë 210 "Toka Troje Terrene" në lidhje me saktësimin e klasifikimit të këtyre aktiveve.

Rëndësia: i mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria Ekonomike dhe Buxhetit Bashkia Sarandë, të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llogarisë 210 "Toka Troje Terrene", sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 212 "Ndërtesa Konstruksione".

- **Gjendja e llogarisë 211 "Pyje, Plantacione"** paraqitet në vlerë bruto si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 31.804.000 lekë. Kjo gjendje paraqitet e analizuar sipas vlerës bruto në tabelën e mëposhtme:

NR	Emërtimi	Gjendje me 31.12.2020	Sasia	Çmimi	Shtesa 2021	Gjendja me 31.12.2021
	PYJE, KULLOTA, PLANTACIONE	31,804,000				31,804,000
1	Ullinj (Ish Komuna Ksamil)	11884000	23,768	500		11,884,000
2	Pyllëzimi e gjelbërimi i kurorës së qytetit Sarandës	19920000	1	19,920,000		19,920,000

- **Gjendja e llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione"** paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,001,055,732 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 954,853,065 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/a Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 1,093,296,888 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 1,102,204,443 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 8,907,555 leke, që përbëjnë shtesa me pagesë nga rritja e AAGJM si rikonstruksione shkollash, mure mbajtës, banja publike, vepra arti etj. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2020 në vitin 2021 paraqitet në Aneksin A/3.

Titulli gjetjes 4: Mbi kontabilizimet në llog. 212 "Ndërtesa Konstruksione"

Situata:

Gjendja e llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 954,853,065 lekë dhe në vlerë bruto 1,102,204,443 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" konstatohet se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 8 artikuj aktive materiale në vlerën 9,074,339 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 213 "Rrugë, rrjete, vepra ujore" në vlerën 7,343,493 lekë, llogarisë 210 "Toka, Troje, Terrene" në vlerën 1,730,846 lekë. Gjithashtu vlera prej 1,761,146 lekë është emërtuar aktive të trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)ö, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

Kriteri:

Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeö Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publikö i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022, Pika 2. Klasa 2, Aktivet afatgjataö (përbërja dhe trajtimi kontabël), Klasifikimi kontabëlö, me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikö i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

Impakti:

Pasqyrim dhe pozicionim i pasaktë i aktiveve afatgjata materiale në llogarinë 212 "Ndërtesa Konstruksione" si dhe mungesë e analizës për vlerën 1,761,146 lekë me ndikim në

informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku:

Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite.

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

- Drejtoria Ekonomike dhe Financës Bashkia Sarandë, të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llogarisë **212 “Ndërtesa Konstruksione”** sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llogarive: **213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** dhe llog. **210 “Toka, Troje, Terrene”**.
Kryetari i Bashkisë Sarandë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në vlerën 1,761,146 lekë përfshirë në gjendjen e llog. **212 “Ndërtesa Konstruksione”**, dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të kryejë zberthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- **Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 2,640,669,364 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,768,771,332 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/a òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike) ò paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 2,849,300,176 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 3.134.107.520 lekë. Gjatë vitit 2021 janë bërë shtesat në vlerën 284,807,344 leke, ku janë kryer investime në rrugë, kanale vaditëse, ujësjellës etj. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në tabelën në Aneksin nr. A/4.

Titulli gjetjes 5: Mbi kontabilizimet në llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”

Situata:

Gjendja e Llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet në vlerën neto në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,768,771,332 lekë dhe në vlerë bruto 3.134.107.520 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë **213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”** konstatohet se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 19 artikuj aktive materiale në vlerën 48,367,346 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë **212 “Ndërtesa Konstruksione”** në vlerën 36,403,544 lekë dhe llogarisë **210 “Toka, Troje, Terrene”** në vlerën 11,963,802 lekë. Gjithashtu vlera prej 29,568,137 lekë është emërtuar òRikonstruksionë, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson.

Kriteri:

Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ò Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 òAnaliza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik ò i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022, Pika 2. Klasa 2, òAktivet afatgjata ò (përbërja dhe trajtimi kontabël), òKlasifikimi kontabël, me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik ò i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75.

Impakti:

Pasqyrim dhe pozicionim i pasaktë i aktiveve afatgjata materiale në llogarinë 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* si dhe mungesë e analizës për vlerën 29,568,137 lekë me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku:

Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite.

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

- Drejtoria Ekonomike dhe Financës Bashkia Sarandë, të kryejë veprimet e sistemit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llogarisë 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llogarive 212 *“Ndërtesa dhe Konstruksione ”* llog. 210 *“Toka, Troje, Terrene”*.
- Kryetari i Bashkisë Sarandë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në vlerën 29,568,137 lekë përfshirë në gjendjen e llog. 213 *“Rrugë, rrjete, vepra ujore”* dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të kryejë zbrërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemit e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

- ***Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”*** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 35,312,277 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën 34,284,343 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 59,603,675 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 61,658,675 lekë për të cilat ka inventar fizik. Shtesa prej 2,055,000 lekë e gjendjes kontabël të vitit ushtrimor 2021 në krahasim me vitin 2020 përfaqëson shtesa pa pagese (dhurate nga Giz) për vegla pune (Prese) dhe kontejnerë. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie si dhe ndryshimet nga viti 2020 në vitin 2021 paraqitet Aneksin A/5.

Titulli gjetjes 6: *Mbi kontabilizimet e aktiveve në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” dhe klasifikimi i tyre.*

Situata:

Gjendja e llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në vlerë neto 34,284,343 lekë dhe në vlerë bruto 61,658,675 lekë për të cilat ka inventar fizik. Referuar analizës së inventarit kontabël të llogarisë 214 *“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune”* konstatohet se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 7 artikuj aktive materiale në vlerën 3,766,818 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llogarisë 218 *“Inventar Ekonomik”*.

Kriteri:

Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme të Aneksi 1 të Analizës e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik të ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022, Pika 2. Klasa 2, të Aktivit afatgjatë (përbërja dhe trajtimi kontabël), të Klasifikimit kontabël dhe me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik.

Impakti:

Pasqyrim dhe pozicionim i pasaktë i aktiveve afatgjata materiale në llogarinë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.

Shkaku:

Nga Drejtoria e Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin n kontabilitet të gjendjes së llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në lidhje me saktësimin e klasifikimit të këtyre aktiveve.

Rëndësia: i mesëm

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria Ekonomike dhe Financës Bashkia Sarandë, të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llogarisë 214 “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 218 “Inventar Ekonomik”.

Gjendja e llogarisë 215 “Mjete Transporti” në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 14.095.337 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 19.781.097 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/a òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 38.132.960 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 45.240160lekë. Shtesa e mjeteve të transportit janë dhurate nga Gizi në vlerë 7,107,200 lekë, për magazinimin e të cilave janë ndjekur procedurat ligjore. Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2020 deri në fund të vitit 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llogarisë 215 "mjete transporti " me 31.12.2018

Nr	EMERTIMI	Gjendja 31.12.2020	Shtesa per vitin 2021	Pakësime per vitin 2021	Gjendja 31.12.2021
	MJETE TRANSPORTI	38,132,960	7,107,200	0	45,240,160
1	Autoveturë e Policisë(Benz) A...	2400000			2400000
2	Automjet PIAGGIO S...	400000			400000
3	Makine e Policisë Bashkiake (xhip) A...	2071200			2071200
4	Blerje automjeti me funksionedyfishit (kosh+karroce) S...	2676000			2676000
5	Autoveturë CHEVROLET Targa A... (Dhurate R...)	1400000			1400000
6	Blerje automjeti vetëshkarkues me kapacitet 2/3 ton A...	1641600			1641600
7	Autoveturë Ford Fiesta A...prodh 2006 (dhurat nga proj. IADSA)	698600			698600
8	Makine mbeturinash Ksamil	2496000			2496000
9	Blerje makine automjet Ksamil A...	1330000			1330000
10	Makina Denisa (24.05.2008) MKZ	2000000			2000000
11	Automjeti internacional MKZ	700000			700000
12	Automjet Zjarrfikës Stajer 680 MKZ	1000000			1000000
13	Makina Magirus (27.05.2006) MKZ	1500000			1500000
14	Blerje Autoveturë tip Benz A...(19.01.2018)	2485000			2485000
15	Blerje fadromë 2019 (A...)	4908000			4908000
16	Blerje automjet e paisje zjarrfikës 2019 (A...) MKZ	3588000			3588000
17	Blerje automjet 4x4 me karrocëri 2019 (A...)MKZ	1594560			1594560
18	Blerje makine tip kamionçinë 2019 (A...)	1068000			1068000
19	Blerje kamjon 10 tonesh me vinç 2019 (A...)	4176000			4176000
20	Mercedes benzatego A... (Dhurate giz)		5927200		5927200
21	Pirun(Forklift) (Dhurate giz)		1180000		1180000

- **Gjendja e llogarisë 218 “Inventar Ekonomik”** në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 13.234.986 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 8,775,340 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/a òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)òparaqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 39,210,050 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën kontabël 40,147,835 lekë. Në këto gjendje përfshihet shtesa me pagesë në vlerën prej 902,400 lekë të pajisjeve dhe vlefata 35,385 lekë janë shtesa pa pagese (Dhuratën nga fondacioni òS.....ò).

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet për vitin 2021 paraqiten në Formatin nr.7/a dhe nr. 7/b òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)ò të PF si më poshtë:

Nr. Refer Llogari	E M E R T i M i	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
b	c	1	2	3	4	5	8	9	10
20	I. AAGJ/JO MATERIALE	119.561.177	100.807.948	18.753.229	0	2.812.984	119.561.177	103.620.932	15.940.245
201	Prime emisi e rimburs huave			0			0	0	0
202	Studime dhe kërkime	119.561.177	100.807.948	18.753.229		2.812.984	119.561.177	103.620.932	15.940.245
203	Konces.patent.licenc e tjera			0			0	0	0
21- 28	II. AAGJ/ MATERIALE	4.226.745.582	375.176.053	3.851.569.529	303.814.884	221.717.403	4.530.560.466	596.893.456	3.933.667.010
210	Toka,troje, Terene	115.397.833		115.397.833			115.397.833	0	115.397.833
211	Pyje, Kullota Plantacione	31.804.000		31.804.000			31.804.000	0	31.804.000
212	Ndërtime e Konstruksione	1.093.296.888	92.241.156	1.001.055.732	8.907.555	55.110.222	1.102.204.443	147.351.378	954.853.065
213	Rrugë,rrjete, vepra ujore	2.849.300.176	208.630.812	2.640.669.364	284.807.344	156.705.376	3.134.107.520	365.336.188	2.768.771.332
214	Instal tekn,makin,pais,vegl pun	59.603.675	24.291.398	35.312.277	2.055.000	3.082.934	61.658.675	27.374.332	34.284.343
215	Mjete transporti	38.132.960	24.037.623	14.095.337	7.107.200	1.421.440	45.240.160	25.459.063	19.781.097
216	Rezerva shtetore			0			0	0	0
217	Kafshe pune e prodhimi			0			0	0	0
218	Inventar ekonomik	39.210.050	25.975.064	13.234.986	937.785	5.397.431	40.147.835	31.372.495	8.775.340
24	AQT te dëmtuara			0			0	0	0
28	Caktime			0			0	0	0
	TOTAL i (i + II)	4.346.306.759	475.984.001	3.870.322.758	303.814.884	224.530.387	4.650.121.643	700.514.388	3.949.607.255

- *Inventarizimi i aktiveve për vitin 2021 Bashkia Sarande*

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të vitit 2021 për Bashkinë Sarande .

Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit per vitin 2021 kane dalë urdhri me nr.151, 152 datës 29.10.2021 òPer krijimin e komisioneve të inventarizimit te aktiveve makineri e pajisje dhe mjete transporti per vitin 2021ò. Janë mbajtur procesverbale nga çdo komision. Është mbajtur relacion shpjegues per gjendjen e llogariveò .

Per vitin 2021 nuk janë nxjerrë aktive afatgjata ose mjete motorike jashtë përdorimit.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive si për Bashkinë Sarande . Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor 2021.

- Rubrika **“Amortizimi i AQ materiale dhe jo materiale”** për vitin 2021 paraqitet në bilanc në vlerën 224.530.387 lekë, e cila kuadron me pasqyrën e amortizimit të bilancit në formatin nr. 7/b,

òAmortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuaraò është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018 òPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshmeò pika 36 Përlllogaritja është bërë mbi vlerën neto në çelje te periudhës ushtrimore për çdo grup aktivesh sipas klasifikimit.

Konkluzion: Gjendja kontabël e aktiveve afatgjata materiale (në vlerën bruto) për vitin 2021 në vlerën4,530,560,466lekë është paraqitur i plotë, pasi janë pasqyruar të gjitha shtesat dhe pakësimet për çdo lloj grup aktivi. Inventari kontabël i aktiveve materiale gjendje në llogaritë: 210“Toka, Troje, Terrene” është në vlerën 115,397,833 lekë; 211“Pyje, Plantacione” në vlerën 31,804,000 lekë, 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 1,102,204,443 lekë, 213“Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,134,107,520 lekë; 214“Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerën 61,658,675 lekë nuk është i qartë në përcaktimet e emërtesave dhe vlerave të secilit aktiv artikull për artikull, duke mos përcaktuar vlerën e plotë

të çdo aktivi, e cila duhet të përfshijë vlerën fillestare dhe shtesat gjatë viteve të secilit aktiv. Në këto inventarë kontabël janë azhurnuar bruto të gjithë investimet e kryera për të gjithë aktivet brenda llojit sipas emërtesave të projekteve të investimeve pa i ndarë dhe përmbledhur në një vlerë të vetme totale për çdo aktiv.

Për këto aktive mungojnë kartelat kontabël apo regjistri historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, përkrahimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur.

Kjo mënyrë e evidentimi dhe procesi i inventarizimit, nuk jep informacion të saktë kontabël për çdo aktiv, duke mos ̇certifikuar vlerat tek për tek të aktiveve, për të ofruar siguri të arsyeshme rreth vlerës fizike dhe kontabël të tyre, të njohura dhe regjistruara në pasqyrat financiare të njësisë në kundërshtim me UMF nr. 30 datë 27.12.2011 ̇Për Menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik kapitulli III, pika 30 dhe me Udhëzimin e MFE nr.5 datë 21.02.2022 ̇Për një ndryshim në Udhëzimin e MFE nr.8, datë 9.3.2018 ̇Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme ̇ i ndryshuar pika 2.1 ̇Trajtimi kontabël dhe funksionimi i grupit të llogarive 21 ̇Aktive afatgjata materiale ̇ në lidhje me blerjen, krijimin apo shtesat e tyre.

Klasa 3 “Aktive Afatgjata Financiare” rezultojnë në fund të vitit 2020 dhe 2021 me gjendje në vlerën 0 lekë. Në këtë klasë përfshihet gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” e cila si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet me gjendje 0, kur në fakt ka investime kapitale në formë aksionesh tek B... sha.

Titulli gjetjes 7: *Mbi kontabilizimin e investimeve kapitale në formën e aksioneve në Shoqërinë Aksionere “B...” sha.*

Situata:

Gjendja e llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” e cila si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet me gjendje 0, kur në fakt ka investime kapitali në formë aksionesh tek B... sha. Në këtë llogari duhet të kishte të evidentuar vlerën e kapitalit të derdhur në bazë të % së zotërimit të aksioneve nga Bashkia Sarandë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Bashkia Sarandë është aksionere me 100% të aksionevetë B..., në një sh.a. NUIS..., e cila është shoqëri aksionere me objekt ̇Organizimi i aktiviteteve sportive në fushën e futbollit... ̇, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e saj ̇. Bashkia Sarandë zotëron në K... Sha 2000 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksioni, me vlerë kapitali 2,000,000 lekë. Për vlerën e kapitalit prej 2,000,000 lekë të derdhur nga Bashkia Sarandë, duhet të ishin kryer veprimet e kontabël në debi të llogarisë 26 ̇Pjesëmarrje në kapitalin e vet ̇ në kredi të llogarisë 1011, ̇Shtesa të fondit bazë ̇.

Kriteri:

Udhëzimi i MFE nr.8 datë 9.3.2018 ̇Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ̇ Kreu III. ̇Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme ̇ pika 31.

Impakti:

Mos evidentimi në llogarinë aktiveve afatgjata llog.26 ̇Pjesëmarrje në kapitalin e vet ̇ i investimeve kapitale në formë aksionesh në vlerën 200,000 lekë në B... sha.

Shkaku:

Nga Drejtoria Financës nuk janë kryer veprimet kontabël përkatëse për evidentimin e aktiveve afatgjata të krijuara nga investimet e kryera e kryera që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere.

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria e Financës të marrë masa, që të kryejë veprimet kontabël për pasqyrimin në PF të investimeve kapitale në vlerën 2,000,000 lekë të kryera në vitet e mëparshme, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere në SH.A òNUIS..., për vlerën 2000,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 100% të aksioneve të B... sha.

- **Gjendja e llogarisë 231“Shpenzime në proces për rritjen e AQT”** në mbyllje të vitit ushtrimor 2020 dhe 2021 paraqitet në vlerën 0, sipas Aneksi 2.3.2 bashkëlidhur Projektraport Auditimit.

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 548.492.131 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 562,790,071 lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- **Gjendja e llogarisë 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to”** përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikujduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 7.900.247 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6.953.128lekë, vlerë e cila ka ardhur në zbritje me një shume 947.119 lekë krahasuar me vitin 2020. Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga 21 fatura të palikujduara për mallra dhe shërbime kundrejt 11 furnitorëve në vlerën 6,953,128 lekë. Ky borxh është krijuar në muajin dhjetor të vitit 2021 sipas bilancit, në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Analize e llogarisë 401-408 "Furnitore e llogarite lidhura me to per vitin 2021

	Subjekti	NIPT	Nr faturës	Data	Vlefte
1	N...	J...S	104	30.12.2021	3,816,552
2	N...	J...S	86	24.12.2021	119,520
3	E...	M...C	2	29.12.2021	790,000
4	S...	L...F	1	08.12.2021	56,000
5	M...	K...A	156	06.12.2021	24,000
6	Ç...	K...S	412	28.12.2021	20,160
7	L...	K...F	214	29.12.2021	1,140,000
8	V...	L...I	5	30.12.2021	74,900
9	O...	L...I	279	31.12.2021	879,996
10	I...	L...B	3	29.12.2021	25,000
11	T...	K...U	8	12.12.2021	7,000
		Totali			6,953,128

- **Gjendja e llogarisë 42 “Detyrime ndaj personelit”** paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën 6,464,869lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2022.

- **Gjendja e llogarisë 431 “Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat”** paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën kontabël 512,675lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2021 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2022.

- **Gjendja e llogarisë 435 “Sigurime shoqërore”** paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën 1,999,317lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës e analizuar si vijon: a. Sigurime shoqërore 9.5% punëmarrësi vlera 819,264 lek.

b. Sigurimet shoqërore 15% punëdhënësi vlera 1,180,053 lekë.

- **Gjendja e llogarisë 436 òSigurime shëndetësore** në fund të vitit 2021 është në vlerën kontabël 269.749 lekë, e cila përbëhet nga:

a. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarrësi vlera 134,874. lekë

b. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlera 134,875 lekë.

Gjendja e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet si në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 448.543.199 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 481,241,985 lekë, vlera të cilat rakordojnë me gjendjet e llogarisë kundërpartit 468 ÷Debitorë të ndryshëm në aktiv të bilancit.

- **Gjendja e llogarisë 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”** përfshin garancitë e ngurtësuar për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 25,311,302 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 6,528,114 lekë, ku për këtë gjendje të llog 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit Sarande në mënyrë analitike. Në këtë gjendje përfshihen shumat e ngurtësuar për 5% e garancisë së punimeve për investimet kryera, si dhe vlera e pullave gjendje në vlerën 139,500 lekë.

Tabela e gjendjes dhe lëvizjes së pullave

Nr	Emërtimi investimit	Gjendje me 31.12.2020	Arketuar 2021	Likuiduar 2021	Gjendje me 31.12.2021
	Depozitime te tjera ne ruajtje (pulla)	99,100	1,937,300	1,896,900	139,500
	Shuma	99,100	1,937,300	1,896,900	139,500

- **Gjendja e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”** përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Analiza e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”

	Subjekti	NIPT	Nr faturës	Data	Vlefte
1	M...	K...M	494	19.11.2020	32960
2	Y... PF	K...H	9466	07.05.2020	26500
		Shuma:			59460

SHERBIME

	Subjekti	NIPT	Nr faturës	Data	Vlefte
1	O...	K...H			22446410
2	SH...	K...G	1	10.05.2018	17200
3	K...	J...G	169	11.12.2020	3754240
		Shuma:			26,217,850

Vendime Gjyqësore

Nr	Zyra përmbarimore	NIPT	Emërtimi kreditorit	Vlefte
1	Zyra përmbarimore B...sh.p.k Sarandë	L...H	V...	3,284,625
2	Zyra përmbarimore E... Sarandë	L...E	B...	50,000
3	Zyra përmbarimore E... Sarandë	L...E	B...	659,526
4	Gjykata Apelit Vlorë		Shoqëria J... sha	130,080
		Shuma:		4,124,231
		Totali:		30,401,541

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 ÷Pasqyra e performancës financiare ÷ të PF të vitit 2021 paraqitet në Aneksin A/6:

Analiza e llogarive të të ardhurave për vitin 2021, të cilat në total janë në vlerën 954.829.065 lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Sarande paraqitet më poshtë:

Gjendja e llogarisë sintetike 70 ÷Të ardhurat nga taksat dhe tatimet÷ paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 242.599.752lekë, i cili kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë analitike 7002 ÷Tatim mbi Biznesin e vogël÷ pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 7.452.688lekë e cila përfshin taksën mbi Biznesin e vogël , e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

b. Gjendja e llogarisë 7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme” pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 90.500.107lekë e cila përfshin taksën mbi ndërtesën dhe truallin, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

c. Gjendja e llogarisë 7029 *“Te tjera tatime mbi pasurinë”* pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 10.221.195lekë e cila përfshin taksën e kalimit te pronësisë se mjeteve, e cila rakordon me të njëjtin zë në akt-rakordimin me thesarin.

ç. Gjendja e llogarisë 7035 *“Taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie”* pasqyrohet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 134.425.762lekë e cila përfshin taksa e ndërtimeve te reja, taksa e fjetjes ne hotel, taksë për zënie hapësire publike, taksë tabele, reklame, etj.

- Gjendja e llogarisë 71 ðTë ardhurat jo tatimoreë paraqitet në bilancin e 2021 në vlerën 135.780.707lekë, i cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

a. Gjendja e llogarisë 7109 ðTe ardhura te tjera jo tatimore nga ndërmarrjet dhe pronësia” paraqitet në bilancin e 2021 në vlerën 4.740.700lekë, e cila përfshin te ardhurat nga qiratë (ndërtese & truall), e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

-. Gjendja e llogarisë 711 ðShërbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare” paraqitet në bilancin e 2021 në vlerën 127.379.793lekë, e cila përfshin llogarinë 7110 ðTarifa administrative dhe rregullatoreë ku përfshihen tarifate per shërbimin e pastrimit, për leje transporti, licenca etj ,ö në vlerën 118.111.927 lek, llogaria 7111 ðTë ardhura sekondare e pagesa shërbimeshë, ku përfshihen tarifa parkimi, të ardhura nga çerdhe e kopshteë në vlerë 7,633,546 lekë, llogaria 7113 ðTe ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeveë ne vlere 900.040 leke llogaria 7114 ðTe ardhura nga biletatë ne vlere 389,000 lekë llogaria 7115 ðTe ardhura nga gjobat e çdëmtimeë në vlere 345.280 leke.. Kjo vlerë me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

-Gjendja e llogarisë 719 ðTe ardhura te tjera jo tatimoreë ne vlere 3,660.214 lekë. e cila kuadron me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 7206 *“Financim i prishëm nga buxheti”* në vlerën prej 16,199,735 lekë, e cila kësaj llogarie rakordon me llog. 4342 ðOperacione me shtetin (te drejta)ö.

Analiza e llogarive të shpenzimeve në vitin 2021 , të cilat në total janë në vlerën 761.933.432 lekë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë 600 *“Paga, shpërblime e të tjera personeli”* për vitin 2021, paraqitet në bilanc në vlerën 100.874.020 lekë.

- Gjendja e llogarisë 601 *“Kontribute për sigurime”* për vitin 2021, paraqitet në bilanc në vlerën 16.524.450 lekë

- Gjendja e llogarisë 602 *“Blerje mallra e shërbime”* paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 198.984.402 lekë dhe sipas akt-rakordimit me Thesarin është në vlerën 198,984,402 lekë , diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 604 *“Transferime korrente te brendshme”* paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 219.971.685lekë ku përfshihen transfertate per degët e varësisë për klubin e futbollit dhe per Prefekturën Vlorë dhe sipas aktrakordimet me Thesarin është në vlerën 219,971,685 lekë, diferenca nuk ka.

- Gjendja e llogarisë së fondeve 606 *“Transferime per Buxhetet familjare e Individë”* paraqitet në bilanc për vitin 2021 në vlerën 224.313.201lekë ,ku përfshihen pagesa paaftësie, ndihme ekonomike, bursa etj, e cila rakordon me akt-rakordimin me Thesarin.

Per vitin 2021 totali i te ardhurave ne vlere është 954,829,065 lekë dhe totali shpenzimeve është 761.933.432 lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 192,895,633 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 ðRezultatit e ushtrimitö.

Gjithashtu gjendja e llogarisë 63 *“Ndryshimi i gjendjes së inventarit”* është barabartë me ndryshimin e gjendjeve të klasës 3 në formatin 1 të bilancit, ku për vitin 2021 është në vlerën - 1.265.674 lekë .

Formati nr.6 “Investimet dhe burimet e financimit”

- Zëri "Shpenzime per Aktive Afatgjata materiale" formati 6 e plotësuar për shumën 303,814,884 lekë në analizë rakordon me pasqyrën òGjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjataò kolona 4 formati 7/a.

- Zëri "Burimet për investime" Formati 6, i plotësuar për shumën 303.801.884 lekë në analizë tregon burimet e investimit, vlera prej 294.617.299 lekë fonde të akorduara per investime, vlera prej 9.197.585 lekë investime te dhuruara nga donatore vendas.

Nga testi kontrollit për vitet 2020 dhe 2021 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:

Rregullaritetin i veprimeve me arkë nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit tarifave administrative vendore dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limit e arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.

Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konformë nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" dhe kreut III pika 34 dhe 35 gerrat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 "Për limitin e arkës".

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë

Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.

Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklaratimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përlllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi etj. Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.

Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve.

Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

- Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave materiale, veprimet me magazinën dhe administrimi i karburantit.

Veprimet nëpërmjet magazinës

-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si fletë-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.

-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara nga nen/Kryetari.

- Janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre ekziston viti i krijimit si dhe janë evidentuar shtesat dhe pakësimet për to, por nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 òPër menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publikò.

- Janë hapur kartela e zyrave inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: T.S. me detyrë Drejtore e Financës e dhe në cilësinë e nëpunësit zbatues (NZ), M.I. me detyrë specialiste e buxhetit e menaxhimit të aseteve në cilësinë e hartueses së pasqyrave financiare.

Pika 2.4 e programit. Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, me vlera të larta, për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021.

-Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për këtë vit ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka njësia vendore për punë e shërbime mallra, të cilat janë miratuar me VKB nr. 204, datë 24.12.2020, sipas Aneks 2.4.1 bashkëlidhur Projektraporti Auditimit.

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetuara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH^{së}, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, u konstatuan shkelje të akteve ligjore/ nënligjore të ligjit të prokurimit publik të cilat në mënyrë të hollësishme janë trajtuar, si vijon:

Për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 ó 31.12.2021 nga subjekti Bashkia Sarandë, konstatohet se janë zhvilluar gjithsej **19** procedura prokurime me vlera të larta me fond limit 433,430 mijë lekë, të dhënat e të cilit paraqiten në pasqyrën si vijon:

Në 000/lekë

EMËRTIMI	Viti 2021	
	Fondi prok 000/lekë	Në % ndaj fondit
Fondet prokuruar gjithsej	433,430	
<i>Nga të cilat</i>		
<i>- Në fushën e ndërtimit</i>	397,355	91.7
<i>-Në fushën e shërbimeve/ blerjeve</i>	36,075	8.4
Financime nga Bashkia/Grande	97,972	22.6
Financim me grandë specifike (Ministritë)	335,458	77.4

Nga të dhënat e pasqyrës, rezulton se me të ardhurat e veta dhe grande të pakushtëzuara, bashkia mbulon 22.6% të procedurave. Ndërsa pjesa tjetër me fondet e qeverisë me destinacion nga Ministritë e linjës.

Titulli i gjetjes 1. Rezultatet e auditimit të procedurave periudha 01.01.2021 – 31.12.2021

Situata:

Nga auditimi i dosjeve të procedurave të prokurimit për vitin 2021, rezulton se:

- Dosjet e procedurave të prokurimit edhe pse ishin mbyllur në të gjitha fazat e tij, nuk ishin të inventarizuara dhe protokolluara në arkivën e bashkisë Sarandë.
- Disa prej procedura projektet/ preventivat janë hartuar nga specialistët e Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit, Bashkia Sarandë dhe miratuar nga titullari i Bashkisë Sarandë, por të papajisur me licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse. Personat përgjegjës për realizimin e projektit duhet të jenë të licencuar sipas kategorive përkatëse të punimeve që do të kryhen, brenda afatit të vlefshmërisë.
- Procedura për investime nuk janë të pajisura me leje ndërtimi ose infrastrukturore. Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Sarandë dhe përgjegjësit të Sektorit të Procedurave janë lidhur kontrata për kryerjen e punimeve pa bërë më parë miratimin dhe marrjen e lejes së ndërtimit ose infrastrukturës.
- Janë pranuar në procedura prokurimi, shpallur fitues dhe lidhura kontrata zbatimi me subjekte të cilat nuk janë pajisur me Nipt (nius) sekondar për kohën e shtrirjes së kontratës, si dhe janë debitorë karshi Bashkisë Sarandë ndërvite, nga auditimet e kryera nga KLSH për mos zbatim të kontratave të punëve publike sipas preventivit.

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me Kreu III, neni 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 òPër kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimitò, të ndryshuar; VKM nr. 759, datë 12.11.2014, òPër licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtimò, e cila ka miratuar RregullorenòPër kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtimò, neni 16 òLicencaòkategoritë e punimeveò. Ligji nr. 9154, datë 6/11/2003 òPër Arkivatò; nenin 4/26.

Ndikimi/Efekti:

Si pasojë e veprimit të mësipërm, ekziston risku për një projekt jocilësor dhe për pasojë ndryshime thelbësore të projektit në fazën e zbatimit.

Shkaku:Neglizhencë nga ana e drejtuesve të Bashkisë Sarandë.

Rëndësia:*E mesme*

Për këtë rekomandojmë:

- Bashkia Sarandë të marrë masa për kryerjen e projekteve nga persona/subjekte të përcaktuar nga ligji, në mënyrë që të kemi projekte sa më cilësore dhe që paraqesin gjendjen reale të objektit.
- Sektori i Procedurave të Prokurimit Bashkia Sarandë, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura për periudhën 01.01.2021 ó 31.12.2021 me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor.
- Kryetari i Bashkisë Sarandë të mos lidhë kontrata me subjektet sipërmarrëse dhe fituese të procedurave të prokurimit për investime pa marrë më parë lejen e ndërtimit ose infrastrukturës në Sektorin e Planifikim Zhvillim Territorit, si dhe pa u pajisur me Nipt sekondarë dhe pa mundësuar likuidimin e detyrimeve ndaj bashkisë për mos zbatimin e kontratave sipas preventivit.

Titulli i gjetjes 2: *Aplikimi i kriterëve në procedurat e prokurimit, jo në përputhje me aktet ligjore/nënligjore të LPP dhe shpallja fitues e OE me mangësi në plotësimin e kriterëve.*

Situata:

Nga të dhënat e regjistrit të prokurimeve, konstatohet se për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2021 janë zhvilluar gjithsej 19 procedura me fond limit 433,430 mijë lekë dhe vlerë kontratë të lidhur 427,638 mijë lekë, me një ulje nga fondi limit prej 1.3%. Pjesëmarrës në

procedura janë 39 OE/BOE, nga ku janë skualifikuar 14 prej tyre për mos plotësim kriteresh të DST.

Mbi bazën e materialitetit të bërë në fillim të auditit, grupi i KLSH nga 19 procedura ka vlerësuar për auditim 10 procedura me fond limit 401,045 mijë lekë ose 92.5% e fondit total.

Në përfundim të punës audituese në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit mbi gjetjet e konstatuara nga grupi i KLSH, kanë rezultuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, gjithsej 6 procedura prokurimi, shkelje të cilat kanë konsistuar në:

- c- Në 6 procedura prokurimi, kriteret nuk janë në përputhje me dispozitat e LPP dhe llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë penguar mospjesëmarrjen e OE në procedurë;
- d- Në 5 procedura prokurimi, OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi ka kriteret të cilat nuk janë plotësuar dhe nga KVO janë vlerësuar si të rregullt. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurën tjetër me kushte më të favorshme, kjo me qëllim përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondit të prokuruar në vlerën **362,987 mijë lekë, konkretisht:**

Nr	Objekti i prokurimeve	Fondi prokuruar	Vlera e kontratës	Firma fituese	shkelje sipas naturës
1	÷Sistemim i rrugeve te brendeshme me asfaltobeton ne Ksamil(Rrhuga e Varrezave Parajsa,rr.Sherifi)÷	11,090,120	10,841,000	J...	Kritere/vlerësim
2	Sistemim i rrugeve te brendeshme me asfaltobeton rr, kristal,Permeti, Papa Gjon Pali i II dhe riveshje gropash.	10,972,200	10,814,576	A...	Kritere/vlerësim
3	Sistemim i rrugeve te brendeshme me asfaltobeton rr, Ismail Qemali Cabej, Adem Jashari,	9,597,600	9,392,610	2..	Kritere
4	Sistemim i rrugeve te brendeshme me asfaltobeton Rr.Gjergj Fishta , Naim Frasheri, Amantia, Kristoforidhi	8,560,800	8,530,800	M...	Kritere/vlerësim
5	Perfundim rrjet kryesor K.U.Z SARANDE	16,666,667	16,500,132	E...	Kritere/vlerësim/
6	÷Furnizimi me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe lugu i Dardhës. Faza e II (Loti Përfundimtar).÷	315,697,482	315,697,482	E...&S...	Kritere/vlerësim

Kriteri: Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim mëligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, ÷Për prokurimin publik÷, neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 ÷Autoriteti ose enti kontraktor÷, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76, ÷Kriteret detyruese për skualifikim÷, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publik÷, i ndryshuar, neni 82, ÷Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave÷, neni 83, “Njoftimi i fituesit”.

Impakti: Vendosija e kriterëve jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës, ka çuar në uljen e numrit të operatorëve pjesëmarrës.

Nga vlerësimi jo i drejtë i operatorëve në garë, veprime në paligjshmëri të përdorimit të fondeve me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet për vlerën **362,987 mijë lekë pa TVSH.**

Shkaku: Përgjegjësi e anëtarëve të Njësisë së Hartimit të Dokumenteve dhe anëtarëve të KVO, gjatë kohës së zhvillimit të procedurës si në aplikimin e kriterëve jo nëpërputhje me dispozitatligjore dhe shpalljen fitues të OE me mangësi nëplotësimin e kriterëve.

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

- Kryetari i Bashkisë Sarandë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me procedurën e zhvilluar, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikat e zhvillimit të procedurave me një OE.

Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhen pjesë e dosjes së prokurimit.

- Kryetari i Bashkisë Sarandë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa të menjëhershme për eliminimin e praktikave për kualifikimin dhe shpalljen fitues të operatorëve ekonomike në kushtet e mosplotësimin të të gjitha kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi operatorët ekonomik të cilët nuk plotësojnë kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor, nuk garantojnë cilësinë e punës/mallit dhe shërbimit, kjo për të shmangur paligjshmërinë e përdorimit të fondeve publik pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet (3-E) me vlerë **362,987 mijë lekë**.

Procedurat me shkelje në vendosjen e kriterëve për periudhën 01.01.2021 – 31.12.2021.

1- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Sistemim i rrugëve te brendshme me asfaltobetoni Ksamil (rruga e varrezave, paraqsa, rr. sherifi”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Sistemim i rrugëve te brendshme me asfaltobetoni Ksamil (rruga e varrezave, paraqsa, rr. sherifi “ö.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 4, datë 13.3.2021	3. Njësia e Prokurimit R.H.	4. Komisioni VO R.C. E.GJ. K.A.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë me propozimö,	L.H. E.L.	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 11,090,120 lekë REF-.....	6. Oferta fituese (pa TVSh) öJ...Sh.p.k me vlerën e ofertës 10,841,000 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 249 lekë pa TVSh OSE 2.2%.
8. Data e hapjes së tenderit 6.4.2021	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë.	10. Operatorë Ekonomike 1: a-Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK ska	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 4, datë 3.5.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 10,841,000.lekë me afat 30ditë	

Burimi të dhënave: *Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).*

- Vlerësimi i kriterëve:

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriterë **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 öPër prokurimin publikö, si dhe nenet 27 öKontrata e mallraveö dhe neni 61 öHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitö, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 ö Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, i ndryshuar, *konkretisht:*

Në pikën 2.2 të DST është kërkuar që OE nuk duhet të figurojë debitorë në Bashkinë Sarandë.

Një kërkesë e tillë nuk është mirëargumetuara, pasi nuk ka mbështetje ligjore, sipas dispozitave të LLP, kërkohej që OE pjesëmarrës nuk kanë detyrime për taksat vendore në vendet ku ushtrojnë aktivitet pa përcaktuar bashkinë dhe se nuk kanë detyrime fiskale nga organet tatimi. Vendosja e emrit të Bashkisë Sarandë është një kriter identifikues midis OE.

Në pikën 2.2.1 të DST, kopje të vërtetuara nga Administrata Tatimore e rrethit përkatës për xhiron mesatare vjetore të tre viteve të fundit 2018-2019-2020, që në asnjë rast nuk duhet të jetë më e vogël se vlera e fondit limit.

Sipas dispozitave ligjore vlera mesatare e xhiros duhet jo më pak se 40% e fondit limit dhe jo sa fondi limit që është aplikuar nga ju.

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargometuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: R.H., L.H. dhe E.L..

Me PV nr. 1, datë 6.4.2021 është bërë hapja e procedurës, nga konstatohet se ka vetëm një OE pjesëmarrës. Me PV nr. 2, datë 14.6.2021 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të operatorit pjesëmarrës.

Me nr. *extra*, datë 21.4.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Titullari i AK A.G., mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve.

Nga dokumentacioni në dosjen e procedurës dhe sistem SPE, rezulton se në këtë procedurë ka marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht shoqëria **“J...SH.P.K me NIPT J...M** dhe ofertë 10,841,000 lekë pa TVSh.

Sipas vlerësimit të KVO, shoqëria ka plotësuar kriteret e DST, duke e ftuar për lidhje kontrate.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **14.04.2021**.

Ankesa: **Nuk ka ankesë**

- Vlerësimi i procedurës:

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SEP, u konstatua se shoqëria ðJ...Sh.p.k, nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

- a- Shoqëria ðJ...sh.p.k, sipas të dhëna të Drejtorisë Ekonomike rezulton debitorë në vlerën 1,694,140 lekë.

Konkluzioni: Nga sa trajtuam mësipërm procedura paraqitet me probleme në vlerësimin e OE të shpallur fitues, pasi nuk plotëson kriteret e DST. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe vijonte procedurë tjetër me kriterë më të favorshme, duke rritur numrin e OE pjesëmarrës, për një përdorim me efektin të fondit të prokuruar me vlerë **11,090 mijë lekë**, veprime në paligjshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ðPër prokurimin publikë, i ndryshuar me ligjin neni 2, *“Parimet e përzgjedhjeje”*, neni 28, *“Anulimi i një procedure”*, neni 76, ðS`kualifikimi i ofertuesveö, neni 92, *“Shqyrtimi i ofertave”*, neni 97, *“Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”*, pika 1, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, neni 26, ðShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveö, pika 5, Neni 66, ðShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveö, neni 67, *“Klasifikimi i ofertave”*, neni 69, *“Njoftimi i fituesit”* dhe **ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: R.C., E.GJ. dhe K.A..**

Nga të dhënat e sistemit SEP, konstatohet se procedura është e pa arkivuar, kjo pasi sipas APP kërkohet qartësimi i Njoftimit të Kontratës, pasi kontrata është lidhur me datë 3.5.2021, ndërsa për publikim është paraqitur data 21.9.2021.

Nga personi përgjegjës nuk është bërë sqarimi APP për këtë mos përputhje dhe procedura ka vijuar me hapat e mëtejshëm pa u arkivuar, veprime në kundërshtim me menin 86 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 ðPër miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar.

2- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Sistemi i rrugëve të brendshme me asfaltbetoni në rrugën Kristal, Përmeti, Papa, Gjon Pali i II dhe riveshje gropash”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Sistemi i rrugëve të brendshme me asfaltbetoni në rrugën Kristal, Përmeti, Papa, Gjon Pali i II dhe riveshje gropash “ö.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 5, datë 22.3.2021	3. Njësia e Prokurimit R.H. L.H. E.L.	4. Komisioni VO R.C. E.GJ. K.A.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë me propozimö,		
5. Fondi Limit (pa TVSh)	6. Oferta fituese (pa TVSh) A.... me	7. Diferenca me fondin limit (pa

10,976,200 lekë REF-....	vlerën e ofertës 10,814,576 lekë pa TVSh.	TVSh) 162 lekë pa TVSh ose 1.4 %.
8. Data e hapjes së tenderit 6.4.2021	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë.	10. Operatorë Ekonomike 2: a-Skualifikuar 1 OE b- Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK ska	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 5, datë 3.5.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 10,814,576.lekë me afat 30 ditë	

- Vlerësimi i kriterëve:

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kritere **jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 òPër prokurimin publikò, si dhe nenet 27 òKontrata e mallraveò dhe neni 61 òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 ò Për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, *konkretisht*:

Në pikën 2.2 të DST është kërkuar që OE nuk duhet të figurojë debitorë në Bashkinë Sarandë.

Një kërkesë e tillë nuk është mirëargumetuara, pasi nuk ka mbështetje ligjore, sipas dispozitave të LLP, kërkohet që OE pjesëmarrës nuk kanë detyrime për taksat vendore në vendet ku ushtrojnë aktivitet pa përcaktuar bashkinë dhe se nuk kanë detyrime fiskale nga organet tatimi. Vendosja e emrit të Bashkisë Sarandë është një kriter identifikues midis OE.

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: R.H., L.H. dhe E.L..

Me PV nr. 1, datë 6.4.2021 është bërë hapja e procedurës, nga KU konstatohet se ka 2 OE pjesëmarrës. Me PV nr. 2, datë 14.6.2021 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të operatorit pjesëmarrës.

Me nr. *extra*, datë 22.4.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Titullari i AK A.G., mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve.

Nga dokumentacioni në dosjen e procedurës dhe sistem, rezulton se në këtë procedurë ka marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

Nr.	OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta	Kualifikuar/skualifikuar
1	A...	J..P	10,814,576	kualifikohet
2	B...	K...H	10,723,384	Skualifikohet

Janë skualifikuar ofertuesit.

I. Shoqëria “B...B” SH.P.K, nuk përmbush kriteret e DST-ve.

Vlerësimi i bërë nga KVO për skualifikimin e shoqërisë është i drejtë dhe në përputhje me dispozitat e LPP, pasi shoqëria nuk plotëson disa nga kriteret e DST, trajtuara gjerësisht në Projekt raportin e Auditimit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, KVO-ja njofton se shoqëria **A... me NIPT J..P, Adresa:** Sarande Lagjja nr. 1,Rruga Onhezmi, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **10,814,576 lekë pa TVSh** është identifikuar si oferta e suksesshme.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **14.04.2021.**

Ankesa: **Nuk ka ankesë**

- Vlerësimi i procedurës:

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SEP, u konstatua se shoqëria A...., nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

- a- Shoqëria A...., sipas të dhënave të Drejtorisë Ekonomike është debitorë në shumën **513,234 lekë.**

Konkluzioni: Nga sa trajtuam mësipërm procedura paraqitet me probleme në vlerësimin e OE të shpallur fitues, pasi nuk plotëson kriteret e DST. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe vijonte procedurë tjetër me kriteret më të favorshme, duke rritur numrin e OE pjesëmarrës, për një përdorim me efektin të fondit të prokuruar, veprime në paligjshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, ÷Për prokurimin publikë, i ndryshuar me ligjin neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 28, “Anulimi i një procedure”, neni 76, ÷S’kualifikimi i ofertuesve, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, neni 97, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, neni 26, ÷Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, pika 5, Neni 66, ÷Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 69, “Njoftimi i fituesit” dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO, **respektivisht: R.C., E.GJ. dhe K.A..**

Nga të dhënat e sistemit SEP, konstatohet se procedura është e pa arkivuar, kjo pasi sipas APP kërkohet qartësimi i Njoftimit të Kontratës, pasi kontrata është lidhur me datë 3.5.2021, ndërsa për publikim është paraqitur data 21.9.2021.

Nga personi përgjegjës nuk është bërë sqarimi APP për këtë mospërputhje dhe procedura ka vijuar me hapat e mëtejshëm pa u arkivuar, veprime në kundërshtim me menin 86 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 ÷Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar.

3- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Sistemin i rrugëve të brendshme me asfaltobetoni rruga Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Amantia, Kristoforidhi”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Sistemin i rrugëve të brendshme me asfaltobetoni rruga Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Amantia, Kristoforidhi”.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 7, datë 22.3.2021	3. Njësia e Prokurimit R.H.	4. Komisioni VO R.C. E.GJ. K.A.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë me propozimë,	L.H. E.L.	
5. Fondi Limit (pa TVSh) 8,560,800 lekë REF-...	6. Oferta fituese (pa TVSh) M... me vlerën e ofertës 8,530,800 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 30 lekë pa TVSh ose 0.3 %.
8. Data e hapjes së tenderit 6.4.2021	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë.	10. Operatorë Ekonomike 2: a-Skualifikuar 1 OE b- Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK ska	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 7, datë 26.4.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 8,530,800.lekë me afat 30 ditë	

- Vlerësimi i kriterëve:

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kriteret jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 ÷Për prokurimin publikë, si dhe nenet 27 ÷Kontrata e mallrave dhe neni 61 ÷Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 ÷ Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, *konkretisht:*

Në pikën 2.2 të DST është kërkuar që OE nuk duhet të figurojë debitorë në Bashkinë Sarandë.

Një kërkesë e tillë nuk është mirëargumetuara, pasi nuk ka mbështetje ligjore, sipas dispozitave të LLP, kërkohet që OE pjesëmarrës nuk kanë detyrime për taksat vendore në vendet ku ushtrojnë aktivitet pa përcaktuar bashkinë dhe se nuk kanë detyrime fiskale nga organet tatimi. Vendosja e emrit të Bashkisë Sarandë është një kriter identifikues midis OE.

Aplikimi i kritereve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: R.H., L.H. dhe E.L..

Me PV nr. 1, datë 22.3.2021 është bërë hapja e procedurës, nga KU konstatohet se ka 2 OE pjesëmarrës. Me PV nr. 2, datë 14.6.2021 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të operatorit pjesëmarrës.

Me nr. *extra*, datë 22.4.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Titullari i AK A.G., mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve.

Nga dokumentacioni në dosjen e procedurës dhe sistem, rezulton se në këtë procedurë ka marrë pjesë 2 OE, konkretisht:

Nr.	OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta	Kualifikuar/skualifikuar
1	M...	J...K	8,530,800	kualifikohet
2	M...	L...R	8,559,200	Skualifikohet

Janë skualifikuar ofertuesit.

1. Shoqëria "M..." SH.P.K, nuk përmbush kriteret e DST-ve.

Vlerësimi i bërë nga KVO për skualifikimin e shoqërisë është i drejtë dhe në përputhje me dispozitat e LPP, pasi shoqëria nuk plotëson disa nga kriteret e DST, trajtuara gjerësisht në Projektraportin e Auditimit.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, njoftohet **M... me NIPT J...K. Adresa:** Vlore Sarande Lagja 2, P 46, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **8,530,800 lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **14.04.2021**.

Ankesa: **Nuk ka ankesë**

- Vlerësimi i procedurës:

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SEP, u konstatua se shoqëria M..., nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

- a- Shoqëria òM...ò ka vetëdeklaruar jo saktë në lidhje me kërkesën që OE duhet të paraqesin deklaratë se nuk kanë detyrime ndaje Bashkisë Sarandë. Sipas të dhënave të Drejtorisë Ekonomike kjo shoqëri është debitor për **shumën 1,555,556 lekë**.
- b- Subjekti nuk ka deklaruar mbi kontratat e ngjashme, pika 2.1/f e DST, pasi sipas të dhënave të buletin të APP, kjo shoqëri ka kontratë me Drejtorinë Rajonale OSSH Gjirokastër, si vijon:

Objekti i kontratës/marrëveshjes kuadër: "Zhvillim rrjeti TM/TU dhe plotësim rrjeti TU me kablo ABC në kabinat Ksamil, Sarandë" me afat realizimi 4 muaj nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. 4. Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-74723-10-09-2020 5. Fondi limit: 38,047,810 lekë pa TVSH. 6. Vlera totale përfundimtare e kontratës: 45,402,364.8 lekë me TVSH. 7. Data e lidhjes së kontratës: 11.01.2021.

Konkluzioni: Nga sa trajtuam mësipërm procedura paraqitet me probleme në vlerësimin e OE të shpallur fitues, pasi nuk plotëson kriteret e DST. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe vijonte procedurë tjetër me kriterë më të favorshme, duke rritur numrin e OE pjesëmarrës, për një përdorim me efektin të fondit të prokuruar, veprime në paligjshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar me ligjin neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 28, “Anulimi i një procedure”, neni 76, òS`kualifikimi i ofertuesveò, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, neni 97, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 26, òShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveò, pika 5, Neni 66, òShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveò, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 69, “Njoftimi i fituesit” dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO, **respektivisht: R.C., E.GJ. dhe K.A..**

Nga të dhënat e sistemimit SEP, konstatohet se procedura është e paarkivuar, kjo pasi sipas APP kërkohet qartësimi i Njoftimit të Kontratës, pasi kontrata është lidhur me datë 26.4.2021, ndërsa për publikim është paraqitur data 21.9.2021.

Nga personi përgjegjës nuk është bërë sqarimi APP për këtë mospërputhje dhe procedura ka vijuar me hapat e mëtejshëm pa u arkivuar, veprime në kundërshtim me nenin 86 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

4- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Përfundim rrjeti kryesor K.U.Z Sarandë”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Përfundim rrjeti kryesor K.U.Z Sarandë”.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 9, datë 22.3.2021	3. Njësia e Prokurimit R.H. L.H. E.L.	4. Komisioni VO R.C. E.GJ. K.A.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “E hapurò,		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 16,666,667 lekë REF-....	6. Oferta fituese (pa TVSh)E... me vlerën e ofertës 16,500,132 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 166 lekë pa TVSh ose 0.9 %.
8. Data e hapjes së tenderit 27.4.2021	9. Burimi Financimit Buxheti i shtetit (MFE).	10. Operatorë Ekonomike 1: a-Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK ska	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 9, datë 12.5.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 16,500,132.lekë me afat 30 ditë	

Me shkresën nr. 437, datë 27.01.2021 Kryetari i Bashkisë Sarandë i është drejtuar A.D. me funksion Ministre e Financave dhe Ekonomisë që nisur nga nevojat emergjente të Ujësjetllës Kanalizime SHA Sarandë, për përfundimin e punimeve në objektin òRiformatim të Kolektorit Kryesor të U.Z Sarandë”, alokim të fondeve me vlerë 20,292,000 lekë.

Me shkresën nr. 1918/1, datë 2.2.2021 të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në referencë të kërkesës së Bashkisë Sarandë me shkresën nr. 437, datë 27.01.2021 është bërë delegim i fondeve në vlerën 20,000,000 lekë .

Me VKB nr. 24, datë 26.2.2021 në zbatim të shkresës së MFE është bërë shtesa të ardhurash në buxhet në vlerën 20,000,000 lekë, si transferua nga buxheti i shtetit.

- Vlerësimi i kriterëve:

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar kritere jo në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 òPër prokurimin publikò, si dhe nenet 27 òKontrata e mallraveò dhe neni 61 òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014

ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 ò Për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, *konkretisht*:

Në pikën 2..2 të DST është kërkuar që OE nuk duhet të figurojë debitorë në Bashkinë Sarandë.

Një kërkesë e tillë nuk është mirëargumetuara, pasi nuk ka mbështetje ligjore, sipas dispozitave të LLP, kërkohej që OE pjesëmarrës nuk kanë detyrime për taksat vendore në vendet ku ushtrojnë aktivitet pa përcaktuar bashkinë dhe se nuk kanë detyrime fiskale nga organet tatimi. Vendosja e emrit të Bashkisë Sarandë është një kriter identifikues midis OE.

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: R.H., L.H. dhe E.L..

Me PV nr. 1, datë 27.4.2021 është bërë hapja e procedurës, nga KU konstatohet se ka 1 (një) OE pjesëmarrës. Me PV nr. 2, datë 29.4.2021 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të operatorit pjesëmarrës.

Me nr. *extra*, datë 6.5.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Titullari i AK A.G., mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve.

Nga dokumentacioni në dosjen e procedurës dhe sistem, rezulton se në këtë procedurë ka marrë pjesë 1 (një) OE, konkretisht shoqëria E.... me Nipt K...H dhe ofertë 16,500,132 lekë pa TVSh.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, njoftohet se shoqëria **E... me NIPT K...H**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **16,500,132 lekë pa TVSh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SEP, u konstatua se shoqëria E..., nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

- Shoqëria E.... ka vetëdeklaruar jo saktë në lidhje me kërkesën që OE duhet të paraqesin deklaratë se nuk kanë detyrime ndaje Bashkisë Sarandë. Sipas të dhënave të Drejtorisë Ekonomike kjo shoqëri është debitor për shumën 509,625 lekë.

Konkluzioni: Nga sa trajtuam mësipërm procedura paraqitet me probleme në vlerësimin e OE të shpallur fitues, pasi nuk plotëson kriteret e DST. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe vijonte procedurë tjetër me kriterë më të favorshme, duke rritur numrin e OE pjesëmarrës, për një përdorim me efektin të fondit të prokuruar, veprime në paligjshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar me ligjin neni 2, "Parimet e përzgjedhjeje", neni 28, "Anulimi i një procedure", neni 76, òS`kualifikimi i ofertuesvë, neni 92, "Shqyrtimi i ofertave", neni 97, "Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës", pika 1, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 26, òShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, pika 5, Neni 66, òShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave, neni 67, "Klasifikimi i ofertave", neni 69, "Njoftimi i fituesit" dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO, *respektivisht*: R.C., E.GJ. dhe K.A..

Nga të dhënat e sistemit SEP, konstatohet se procedura është e paarkivuar, kjo pasi sipas APP kërkohej qartësimi i Njoftimit të Kontratës, pasi kontrata është lidhur me datë 21.5.2021, ndërsa për publikim është paraqitur data 21.9.2021.

Nga personi përgjegjës nuk është bërë sqarimi APP për këtë mospërputhje dhe procedura ka vijuar me hapat e mëtejshëm pa u arkivuar, veprime në kundërshtim me menin 86 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

Titulli gjetjes 2: Mos zbatimi i kushteve të kontratës nr. 9, datë 6.3.2021, në përfundimin në afat të punimeve, si dhe rëndim i TVSh kreditore të pajisjeve.

Situata:

- Nga auditimi i dosjes teknike dhe pagesave të kryera me bankë në lidhje me procedurën me objekt: “Përfundim rrjeti kryesor K.U.Z Sarandë”, rezulton se nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria E... me të cilën është lidhur kontrata nr. 9, datë 6.3.2021, është paraqitur për likuidim fatura nr. 5/2022, datë 28.2.2022, sipas të dhënave të situacionit përfundimtare, vlerë e cila nuk është likuiduar pasi shoqëria nuk ka mbyllur punimet sipas kushteve të kontratës dhe nuk ka aktkollaudim.

Sipas të dhënave të njësisë së procedurave (sektori i zbatimit të kontratave), nga shoqëria nuk është paraqitur vërtetim për përfundimin e punimeve sipas afatit të përcaktuar në kontratë, si dhe nuk ka shtesë afat punimesh.

Referuar të dhënave të situacionit përfundimtar që disponon Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, punimet kanë përfunduar me datë 28.2.2022 ose 257 dite vonesë nga afati i kontratës, nisur nga data e faturës së paraqitur për likuidim.

Nga samësipër nga Bashkia Sarandë (personat përgjegjës) nuk është mundësuar llogaritja e kamatëvonesave në masën 4/1000 për çdo ditë vonesë por jo më pak se 25%, në zbatim të nenit 27 të kontratës, në vlerën **4,950,064 lekë** (19,800,158 x 25%), veprime financiare me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Sarandë për të cilën ngarkohet me përgjegjësi **shoqëria E... si përgjegjëse për mos përfundim të punimeve dhe shtyrjen e kamatëvonesës.**

- Gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosjen teknike rezulton se **për makineritë dhe pajisjet është llogaritur TVSh-ja kreditore (e zbritshme)**, duke i konsideruar punime ndërtimi punimet e furnizimit të pajisjeve.

Ky format i miratuar nga Këshilli i Ministrave me udhëzimin përkatëse parashikon emërtimin e zërave të punimeve, sasi, çmim, vlerë si dhe shuma e tyre, duke i shtuar TVSh-në, pastaj kësaj shume i shtohen vetëm pajisjet.

Pra nuk ka më TVSh për pajisjet, pasi si rubrikë për efekt të llogaritjes së kostos janë zë më vete, duke u përfshirë mbrapa TVSh-së.

Si pasojë e përfshirjes në situacion të TVSh ó së janë likuiduar tepër në vlerën 249,000 lekë.

Kjo vlerë jepet sipas tabelës të mëposhtme:

Tabela 1

Nr. Sipas prev oferte	Zëri i punimeve	Njësia	Sasia në preventiv	Çmimi	Vlera
18	Panel komandimi soft-staert 45 k për lëshimin e tre pompave 38 kë secila dhe komandimi automatik të gjeneratorit 144 kë.	copë	1	1,245,000	1,245,000
				Shuma	1,245,000
				TVSh	249,000
				TOTALI	2,035,410

Si përfundim, janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve në vlerën 249,000 lekë si rrjedhojë e përfshirjes së TVSh së pajisjeve në situacionin e punimeve, vlerë kjo e cila përbën një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Referuar zërave të preventivit të hartuar nga ing. K. K., konstatohet se në numrin 18 të sajë, thuhet se: “Furnizim/vendosje, Panel komandimi soft-staert 45 k^w për lëshimin e tre pompave

38 kë secila dhe komandimi automatik të gjeneratorit 144 kë (demontim i panelit të vjetër, transport në magazinë).

Nga të dhënat e marra nga magazina Bashkia Sarandë dhe informacionit të marrë në Ndërmarrjen e Ujësjetës Kanalizime SHA Sarandë, rezulton se nga shoqëria E.....**nuk është bërë hyrje pjesa e vjetër e panelit e cila është zëvendësuar.**

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me:

Kontratën nr. 9, datë 6.3.2021 të lidhur midis Bashkisë Sarandë dhe shoqërisëE...;

i) UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa òAò, paragrafi i fundit, pasi të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat në përfshirjen e punimeve të ndërtimit, ku përcaktohet se:” Në të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat”;

ii) VKM nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8, ku përcaktohet se:” Analizat teknike do të përgatiten në përputhje me metodologjinë e përcaktuar në Kreun i të udhëzimit nr. 2, datë 08.05.2003 të Këshillit të Ministrave,”.

iii) UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa òcò, paragrafi i fundit, ku përcaktohet se:” Preventivin e plotë të projektit të zbatimit, duke përfshirë të gjitha vëllimet e punimeve të projekteve të lartpërmendura, hartuar nga projektuesit në përputhje me pikën 3.1 (formati tip bashkëlidhur këtij udhëzimi);

Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 òPër Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikò, i ndryshuar, për nenet 34-41.

Ndikimi/Efekt:

Mos zbatim i kushteve të kontratës nr. 9, datë 6.3.2021, kanë efekt negativ në buxhetin e bashkisë për vlerën **5,199,064 lekë.**

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit ligjorë në fuqi nga personat përgjegjës.

Rëndësia: E lartë

Për këtë rekomandojmë:

Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Kontratave, të marrin pasha për:

d- Llogaritjen, kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës sëkamatëvonesës për mos përfundim në afat tëpunimeve në objektin“Përfundim rrjeti kryesor K.U.Z Sarandë”, për vlerën **4,950,064 lekë nga shoqëria ‘E...’**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

e- Arkëtimin e vlerës së TVSh kreditorë tëpajisjeve prej **249,000 lekë**, zbritur padrejtësisht në vlerën e situacionit përfundimtar nga subjektiE....., duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

f- Mos kryerjen e pagesave të asnjë vlerë të situacioneve pa bërëdorëzimin e mallit sipas zërit18 të sajë, thuhet se: “Furnizim/vendosje, Panel komandimi soft-staert 45 kW për lëshimin e tre pompave 38 kë secila dhe komandimi automatik të gjeneratorit 144 kë (demontim i panelit të vjetër, transport në magazinë), nga shoqëria E....

5- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Sistemim i rrugëve me asfaltobetoni (rruga Ismail Qemali Cebej, Adem Jashari”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Sistemim i rrugëve me asfaltobetoni (rruga Ismail Qemali Cebej, Adem Jashari”.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 6, datë 23.3.2021	3. Njësia e Prokurimit R.H.	4. Komisioni VO R.C.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit	L.H.	E.GJ.

“Kërkesë me propozimö,	E.L.	K.A.
5. Fondi Limit (pa TVSh) 9,597,600 lekë REF-.....	6. Oferta fituese (pa TVSh)2... me vlerën e ofertës 9,392,610 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 205 lekë pa TVSh ose 2.1 %.
8. Data e hapjes së tenderit 6.4.2021	9. Burimi Financimit Të ardhurat e bashkisë	10. Operatorë Ekonomike 1: a-Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK ska	13. Përgjigje KPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 6, datë 3.5.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 9,392,610.lekë me afat 30 ditë	

- Vlerësimi i kritereve:

Në aplikimin e kritereve janë konstatuar **kritere jo në përputhje** me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 òPër prokurimin publikö, si dhe nenet 27 òKontrata e mallraveö dhe neni 61 òH2-Tmi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitö, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 ò Për miratimin e rregullave të prokurimit publikö, i ndryshuar, *konkretisht:*

Në pikën 2..2 të DST është kërkuar që OE nuk duhet të figurojë debitorë në Bashkinë Sarandë.

Një kërkesë e tillë nuk është mirëargumetuara, pasi nuk ka mbështetje ligjore, sipas dispozitave të LLP, kërkohet që OE pjesëmarrës nuk kanë detyrime për taksat vendore në vendet ku ushtrojnë aktivitetet pa përcaktuar bashkinë dhe se nuk kanë detyrime fiskale nga organet tatimi. Vendosija e emrit të Bashkisë Sarandë është një kriter identifikues midis OE.

Aplikimi i kritereve në mënyrë jo të mirëargumetuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: R.H., L.H. dhe E.L..

Me PV nr. 1, datë 23.3.2021 është bërë hapja e procedurës, nga KU konstatohet se ka 2 OE pjesëmarrës. Me PV nr. 2, datë 14.4.2021 është bërë vlerësimi i dokumentacionit të operatorit pjesëmarrës.

Me nr. *extra*, datë 22.4.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Titullari i AK A.G., mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve.

Nga dokumentacioni në dosjen e procedurës dhe sistem, rezulton se në këtë procedurë ka marrë pjesë 1 (një) OE, konkretisht shoqëria 2.... me Nipt K...M dhe ofertë 9,392,610 lekë pa TVSh.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, njoftohet se shoqëria **2... me NIPT K...H**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **9,392,610 lekë pa TVSh**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SEP, rezulton se shoqëria 2..., plotësojnë të gjitha kriteret e DST dhe dispozitat e LPP për shpalljen fitues.

Nga të dhënat e sistemit SEP, konstatohet se procedura është e paarkivuar, kjo pasi sipas APP kërkohet qartësimi i Njoftimit të Kontratës, pasi kontrata është lidhur me datë 21.5.2021, ndërsa për publikim është paraqitur data 21.9.2021.

Nga personi përgjegjës nuk është bërë sqarimi APP për këtë mospërputhje dhe procedura ka vijuar me hapat e mëtejshëm pa u arkivuar, veprime në kundërshtim me menin 86 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikö, i ndryshuar.

6- Në tenderin e zhvilluar me objekt “Sistemim i rrugëve te brendshme me asfaltobetoni Ksamil (rruga e varrezave, parajsa, rr. sherifi”, me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt “Furnizimi me ujë i zonës Baba Rrexhepi dhe lugu i Dardhës. Faza e II (Loti Përfundimtar)ö.		
1. Urdhër Prokurimi Nr. 10, datë 23.3.2021	3. Njësia e Prokurimit E.L. R.H. L.H.	4. Komisioni VO NR. 10/1, DT. 23.3.2021 E.GJ. R.C. K.A.
2. Lloji i Procedurës së Prokurimit “HAPURö,		
5. Fondi Limit (pa TVSh) 322,288,648 lekë REF-91236-03-25-2021	6. Oferta fituese (pa TVSh) öE... + SH...ö Sh.p.k me vlerën e ofertës 315,697,482 lekë pa TVSh.	7. Diferenca me fondin limit (pa TVSh) 6.591 lekë pa TVSh OSE 2%.
8. Data e hapjes së tenderit 30.4.2021 ndryshuar për dt. 27.5.2021	9. Burimi Financimit AKUM.	10. Operatorë Ekonomike 1: a-Skualifikuar 0 OE b- Kualifikuar 1 OE
11. Ankimime ska	12. Përgjigje Ankesës nga AK ska	13. PërgjigjeKPP
b. Kontrata		
14. Lidhja e kontratës Nr. 10, datë 12.10.2021	15. Vlera e kontratës (me TVSh) 315,697,482.lekë me afat 365 ditë	

Burimi të dhënave: Dosja fizike dhe auditim në SPE (Sistemi i prokurimit elektronik).

Titulli gjetjes 3: Mos llogaritje e saktë e fondit limit.

Situata:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi llogaritjen e fondit limit të procedurës me objekt “Sistemim i rrugëve te brendshme me asfaltobetoni Ksamil (rruga e varrezave, parajsa, rr. sherifi ” me fond limit 322,288,648 lekë pa TVSh, rezulton se:

Projektpreventivi është hartuar nga subjekti I...Sh.p.k.

Nga auditimi i zërave të preventivit të paraqitur nga subjekti duke i krahasuar me zërat e manualit të çmimeve sipas VKM nr. 629, dt. 15.07.2015 i ndryshuar, çmimet e aplikuar nuk janë të njëjta, duke rënduar padrejtësisht fondit limit për vlerën 2,509,080 lekë, tabela:

Nr. Sipas prevt	Nr.Analiz	Emërtimi i punimeve		Sasia	Çmimi sipas Preventivit	Çmimi sipas VKM 625	Diferencë çmim	Rendim fondi
20	2.491/h	F.V Tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=110mm, PN 10	ml	5820	1436	1186	250	1,455,000
21	2.491/i	F.V Tuba e rakorderi ujësjellësi PE d=125mm, PN 10	ml	3660	1664	1376	288	1,054,080
		SHUMA						2,509,080

Për sa më sipërm fondi limit për objektin öFurnizimi me ujë i zonës Baba Rrexhepi dhe lugu i Dardhës. Faza e II (Loti Përfundimtar)”, referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, sipas tabelave që i bashkëlidhen VKM nr. 629, dt. 15.07.2015 i ndryshuar është rënduar më shumë për vlerën **2,509,080 lekë pa TVSh, duke ngarkuar me përgjegjësi subjekti I...Sh.p.k.**

Kriteri:

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 629, dt. 15.07.2015 öPër miratimin e manualeve teknike të çmimeve të ...ö i ndryshuar

Ndikimi/Efekti:

Mos zbatimi i akteve ligjore, kanëçuar në rëndim të fondit limit për vlerën 2,509,080 lekë, në dëm të buxhetit të shtetit

Shkaku: Përgjegjësi e shoqërisë I...Sh.p.k, në mos zbatimin e saktë të VKM nr. 615, datë 15.7.2015

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Sarandë në rastet e hartimit të projekt/preventivave për investime publike nga subjekte të liçensuar, të ngrejë grup pune me specialist të fushës për verifikimin e zërave të preventivit referuar çmimeve të manualit, me qëllim arritjen e objektivave të kontratave të prokuruar, si dhe shmangien e efekteve negative në shumën prej 2,509,080 lekë pa TVSh, për mos ezaurimin e të gjitha hapësirave ligjore në përcaktimin e fondit limit në mungesë të manualeve.

Me shkresën nr. 963, datë 10.3.2021 Bashkia Sarandë i ka kërkuar Institutit të Ndërtimit (*Drejtoria e Rregullave Teknik dhe Oponencës*), për realizimin e oponencës teknike të objektit subjekti *“Furnizimi me ujë i zonës Baba Rrexhepi dhe lugu i Dardhës. Faza e II (Loti Përfundimtar)”* me vlerë të preventivuar regj 322,288,647 lekë pa TVSh. Kjo e fundit nga ana e sajë me shkresën nr. 477/3, datë 17.3.2021 kthen përgjigje mbi oponencën e kryer dhe vijimin e punimeve.

Në oponencë janë lënë disa detyra për tu plotësuar si në fazën e hartimit ashtu dhe në fazën e zbatimit nga firma zbatuese, konkretisht:

- *Konsulenti duhet të paraqesë një relacion të veçantë respektimin e kriterit dhe metodikave të llogaritjes të numrit të banorëve dhe prurjeve llogaritëse të rrjetit të brendshëm sipas kërkesave të KTP 11-78;*
- *Strukturat ujëmbajtëse duhet të projektohen me material (beton dhe çelik), të markave (klasave) të larta;*
- *Projekti duhet të ketë më shumë detaje dhe arnime të elementëve konstruktiv;*
- *Raporti teknik duhet të plotësohet me llogaritjet konstruktive të depos, me të dhënat strukturore, kushtet teknike të projektimit, materialet që do përdoren, etj.*

Nga verifikimi i dosjen, konstatohet se këto ndërhyrje nuk janë kryer nga Bashkia Sarandë dhe firma projektues.

Me shkresën nr. 367, datë 12.2.2021 Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ka dërguar në Bashkinë Sarandë fondin e detajuar për ndërtimin e ujësjellësit *“Furnizimi me ujë i zonës Baba Rrexhepi dhe lugu i Dardhës. Faza e II (Loti Përfundimtar)”*, sipas buxhetit të periudhës 2021-2023, në zbatim të ligjit nr. 137/2020 *“Për buxhetin e vitit 2021, udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit, udhëzimit nr. 4, datë 25.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021 në vlerën , të detajuar si më poshtë:*

- *Për objektin “Rikonstruksion i ujësjellësit Ksamil (Depo + Rrjeti shpërndarës), lagje nr.3 dhe nr. 4, financimi është vitin 2021 është parashikuar 20 milionë lekë, për vitin 2022 është parashikuar 20 milionë dhe për vitin 2023 vlera e mbetur prej 115.9 milionë lekë;*
- *Për objektin “Furnizim me ujë i zonës Baba Rexhepi dhe lugu i dardhës, faza e II (loti përfundimtar), financimi është vitin 2021 është parashikuar 77.3 milionë lekë, për vitin 2022 është parashikuar 25 milionë dhe për vitin 2023 vlera e mbetur prej 25 milionë lekë.*

Nga të dhënat konstatohet se procedura është zhvilluar pa fonde në dispozicion, pasi referuar vlerës së preventivit ajo është në shumën 322,288,647 lekë pa TVSh, ndërsa fondi i flokuar nga ministria është në shumën 283,309,275 lekë, **pra më pak për shumën 38,979,372 lekë.**

Referuar shkresë NR. 234, DATË 28.01.2021 së MIE (*Agjensia Kombëtare e Ujësjetës kanalizime AKUM*), në paragrafin e fundit thuhet që prokurimi i objektit do të bëhet me vlerë

të plotë 386,746,377 lekë me TVSh, nënshkruar nga A.B. me detyrë ish-Drejtor i Përgjithshëm i AKUM.

Nga sa trajtuar më sipër objekti është prokuruar pa pasur në dispozicion fondit total të projektit, veprime në kundërshtim me nenin 70 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar me pikën 2⁹ e nenit 85-*Lidhja e kontratës*, të VKM nr. 285, datë 29.5.2020 òPër miratimin e Rregullave të Prokurimit Publikò, si dhe me nenin 52 (paragrafi¹⁰) të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 òPër menaxhimin e Sistemit Buxhetor në R.SHò.

- Vlerësimi i procedurës.

Në aplikimin e kriterëve janë konstatuar **kritere jo në përputhje me kushtet** e zhvillimit të procedurës dhe në përputhje me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2000 òPër prokurimin publikò, si dhe nenet 27 òKontrata e mallraveò dhe neni 61 òHartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderitò, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ndryshuar me VKM nr. 823, datë 21.10.2020 ò Për miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, *konkretisht:*

Në pikën 2..2 të DST është kërkuar që OE nuk duhet të figurojë debitorë në Bashkinë Sarandë.

Një kërkesë e tillë nuk është mirëargumetuara, pasi nuk ka mbështetje ligjore, sipas dispozitave të LLP, kërkohet që OE pjesëmarrës nuk kanë detyrime për taksat vendore në vendet ku ushtrojnë aktivitet pa përcaktuar bashkinë dhe se nuk kanë detyrime fiskale nga organet tatimi. Vendosija e emrit të Bashkisë Sarandë është një kriter identifikues midis OE.

Në pikën 2.2.1 të DST, janë kërkuar kategori licensë të cilat nuk janë të mirëargumetuara dhe jo në përputhje me objektin e prokurimit, si licenca e kategorisë NP-1/C (punime gërmime në tokë, ; N9-7D (ujësjellës, gazsjellës, vajërasellës, vepra kullimi e vaditje); NS-4A (Punime rafinuare të muraturës dhe të lidhura me to, rafinuare me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rafinuare të natyrës teknike ndërtuese) dhe N.S. – 8 A Ndërtime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.

Në pikën 2.2.3 të DST është kërkuar që: Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt me eksperiencë minimumi 10 (dhjete) vjeçare të përfshirë në licensën e shoqërisë dhe të deklarojë se ai nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm: Libreze pune (përkatëse), CV përkatëse, Kontrate pune e vlefshme (përkatëse) dhe Diplome Vendosija e kriterit për kualifikim sa i takon eksperiencës në punë òtë paktën 10 vjetò konstatohet se është kriter i panevojshëm pasi në VKM nr. 42, dt. 16.01.2008 òPër miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimiò `Kreu IV, pika 1. Drejtuesi teknik i shoqërisë a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimiò.

Në pikën 2.2.5 të DST është kërkuar që OE të kenë një inxhinier elektronik/telekomunikacioni. Një kërkesë e tillë nuk është e mirëargumetuara nga subjekti dhe nuk përshtatet me zërat e preventivit. Gjithashtu kërkesa që stafi i inxhinierëve të jetënë listëpagesat për periudhën nëntor 2020 – janar 2021, të shoqëruar me diploma, kontrata pune dhe CV, librezë pune.

⁹Lidhja e kontratës do të bëhet në përputhje me afatet e përcaktuara në pikën 1, të këtijneni, **dhe vetëm pasifondi do të jetë në dispozicion (në llogarinëpërkatëse) të autoritetit/entit kontraktor.**

¹⁰Kryerja e shpenzimevëbëhet vetëm nësemasa e shpenzimitnukkalonfondet e angazhuarapërkëtëqëllim

Për AK është e rëndësishme të vërtetohet disponimi i specialistit të kërkuar në momentin e zhvillimit të procedurës së prokurimit dhe periudhën e zbatimit të kontratës objekt prokurimi (me kontratë pune) për sa kohë vërtetohet se janë punësuar pranë operatorit ekonomik dhe jo kohëzgjatja e disponimit për periudhat e mëparshme. Rekomandimi i APP nr. 8197, dt. 03.09.2018.

Gjithashtu për të stafin e mësipërm teknik është kërkuar CV e cila nuk shërben për të vlerësuar përmbushjen e ndonjë kriteri të vënë nga autoriteti kontraktor pasi nuk është vendosur asnjë kriter për eksperiencën ose veprimtarinë e mëparshme të tyre.

Në pikën 2.5.5 të DST është kërkuar që: OE pjesëmarrës njëri prej inxhinierëve drejtues teknik, duhet të jetë i certifikuar si ekspert për vlerësimin e ndikimit në mjedis.

Aplikimi i një kriteri të tillë është i paargumentuar dhe i panevojshëm, pasi faza e vlerësimit në mjedis bëhet gjatë fazës së hartimit të projektit dhe jo në zbatim të tij.

Në pikën 2.5.6 të DST është kërkuar që: OE ofertues duhet të jetë i pajisur me licencë për grumbullimin dhe transportimin, e mbetjeve urbane që kanë ndikim në mjedis, Kodi III.2.B të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP dhe nenin 26 të Vendim i KM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese natyrën dhe vlerën e kontratës. Ky kriter nuk lidhet me natyrën e kësaj kontrate. Asnjë zë preventivi nuk parashikon grumbullim apo transport të mbetjeve urbane. Operatori ekonomik gjatë zbatimit të kontratës nuk gjeneron mbetje urbane, dhe ky shërbim do të realizohet nga operatorët e tjerë të kontraktuar. Vendosija e këtij kriteri abuziv, kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, sepse nuk ka asnjë relevante në vlerësimin e aftësisë zbatuese të operatorëve ekonomikë për zbatimin e kësaj kontrate.

Ekspertiza është ezauruar në fazën e procesit të studimit dhe projektimit, nëpërmjet hartimit të projektit, specifikimeve teknike dhe në kundërshtim me përcaktimet e pikës 0a0 të nenit 1 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 për vlerësimin dhe ndikimin në mjedis, sipas se cilës qëllimi është të sigurojë një nivel të lartë të mbrojtjes së mjedisit, duke parandaluar, minimizimin dhe kompensimin të dëmit në mjedis, kjo nga projektet e propozuara përpara miratimit të tyre. *Pra shërbimet e ekspertizës në fjalë janë realizuar në fazën e studimit dhe projektimit të objekteve.* Aplikimi i kriterëve të tilla, çon në mos pjesëmarrjen e OE në garë.

Në pikën 2.5.5 të DST është kërkuar që: OE të ketë jo më pak se një inxhinier ndërtimi profili transport.

Ky është një kriter jo mirëargumentuara, pasi referuar zërave të preventivit nuk ka punime që kërkon një inxhinier të këtij profili.

Aplikimi i kriterëve në mënyrë jo të mirëargumentuara dhe në përputhje me procedurën e zhvilluar, duke ngarkuar me përgjegjësi anëtarët e NJHDT: R.H., L.H. dhe E.L..

Me PV nr. 1, datë 27.5.2021 është bërë hapja e procedurës, nga ku konstatohet se në këtë procedurë ka marrë pjesë vetëm bashkimi i OE “E... + SH...” SH.P.K me ofertë 315,697,482 lekë pa TVSh.

Me PV datë 31.5.2021 është bërë vlerësimi i procedurës të dokumentacionit të paraqitur nga bashkimi i OE “E... + SH...” SH.P.K me ofertë 315,697,482 lekë pa TVSh, nga ku rezulton se sipas KVO plotëson kriteret e DST të miratuara nga AK.

Me shkresën datë 31.5.2021 është bërë klasifikimpërfundimtar, nënshkruar nga Titullari i AK.

Me nr. extra, datë 7.6.2021 nga KVO është hartuar raporti përmbledhës i firmosur nga komisioni i vlerësimit, i miratuar nga Titullari i AK A.G., mbi ecurinë e procedurës së tenderit, informacionin mbi kualifikimet dhe skualifikimet e operatorëve.

Nga dokumentacioni në dosjen e procedurës dhe sistem SPE, rezulton se në këtë procedurë ka marrë pjesë vetëm një OE, konkretisht bashkimi i OE" **E... + SH...**" **SH.P.K me ofertë 315,697,482 lekë pa TVSh.**

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 31.5.2021.

Formularë njoftimi Fitusi (shtojca 16) datë 16.6.2021

Ankesa: **Nuk ka ankesë**

Midis bashkimit të OE **E... + SH...ö Sh.p.k** dhe AK është hartuar dhe firmosur kontrata nr. 10, datë 12.10.2021 për **öFurnizimi me ujë i zonës Baba Rrexhepi dhe lugu i Dardhës. Faza e II (Loti Përfundimtar)**ö me vlerën 315,697,482 lekë PA TVSh. me afat punimesh 365 ditë nga dorëzimi i sheshit të ndërtimit, kjo datë do të konsiderohet si data e fillimit të punimeve.

Referuar të dhënave të mësipërm, konstatohet se nuk janë respektuar afatet e hartimit të raportit përmbledhës, pasi vlerësimi është bërë me datë 31.5.2022, ndërsa raporti përmbledhës është mbajtur datë 7.6.2021 dhe formulari i njoftimit me datë 16.6.2021, dhe lidhjes së kontratës datë 12.10.2021, veprime në kundërshtim me nenet 83, 86, 85 dhe 97të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi: Titullarin e AK dhe anëtarët e NJP dhe KVO Bashkia Sarandë.

- Vlerësimi i procedurës:

Nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SEP, u konstatua se bashkimi i OE" **E... + SH...**" **SH.P.K**, nuk plotësojnë të gjitha kriteret e DST, konkretisht:

- b- Të dy shoqëritë nuk plotësojnë kriterin sipas pikës 2/g të DST, mbi pagesën e energjisë elektrike, pasi sipas vërtetimeve të lëshuara nuk përfshijnë periudhën e muajt mars 2021, ndërkohë që procedura zhvillohet me datë 27.5.2021.
- c- Shoqëria SH...sh.p.k, nuk plotëson pikën 2.2/d të DST, ku thuhet se: *"OE nuk duhet të figurojnë debitor në Bashkinë Sarandë"*, pasi nga verifikimi rezulton se është debitorë për vlerën 108,666 lekë.
- d- Shoqëria E...sh.p.k, nuk plotëson kriterin sipas pikës 2.2.1 të DST, për punime të ngjashme jo më të vogël se 50% e fondit limit. Sipas dokumentacionit në dosje dhe sistemin SEP, rezulton se:
Fondi limit i prokuruar është në shumën 386,746,377 lekë dhe shoqëritë duhet të plotësojnë 50% të fondit ose në vlerën 193,373,188 lekë.
Në zbatim të aktmarrëveshjes së bashkëpunimit shoqëria D...sh.p.k, mbulon 70% të kontratës, pra duhet të paraqesë **vlerën 135,361,232 lekë** (193,373,188 x 70%).
Nga shoqëria janë paraqitur dy kontrata, si vijon:
a-Kontrata me subjektin Bashkia Dropull për objektin *"Restaurim i rrugëve hyrëse te Kisha Bizantine Lindjes Hyjlindese në Peshkëpine e Poshtme dhe fshatin Radat"* me vlerë me TVSh 28,968,072 lekë dhe afat 26.37.2019 ó 30.9.2019;
b Kontrata me subjektin Bashkia Patos me objekt: *öRikonstruktion i rrugës Koli Marku"* me vlerë kontrate me TVSh 69,790,772 lekë, për periudhën 30.10.2018 ó 01.6.2019.
Pra në total vlera e punimeve të ngjashme është 98,758,844 lekë **ose më pak se kriteri për shumën -36,602,388 lekë.**
Gjithashtu këto kontrata nuk janë punime të ngjashme me objektin e prokurimit i cili është ndërtim ujësjellësi.

Konkluzioni: Nga sa trajtuam mësipërm procedura paraqitet me probleme në vlerësimin e OE të shpallur fitues, pasi nuk plotëson kriteret e DST. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe vijonte procedurë tjetër me kriterë më të favorshme, duke rritur numrin e OE

pjesëmarrës, për një përdorim me efektin të fondit të prokuruar, veprime në paligjshmëri me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, òPër prokurimin publikò, i ndryshuar me ligjin neni 2, “Parimet e përzgjedhjeje”, neni 28, “Anulimi i një procedure”, neni 76, òS`kualifikimi i ofertuesveò, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, neni 97, “Njoftimi i fituesit dhe nënshkrimi i kontratës”, pika 1, si dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar, neni 26, òShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveò, pika 5, Neni 66, òShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertaveò, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 69, “Njoftimi i fituesit” dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO, respektivisht: R.C., E.GJ. dhe K.A..

Nga të dhënat e sistemit SEP, konstatohet se procedura është e paarkivuar, kjo pasi nuk është plotësuar njoftimi i lidhjes së kontratës, veprime në kundërshti me menin 86 të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 òPër miratimin e rregullave të prokurimit publikò, i ndryshuar.

Shënim: Nga subjekti Bashkia Sarandë në fazën e Projektraportit nuk janë paraqitur observacione në lidhje me shkeljet e konstatuara në vlerësimin e procedurave të prokurimit (pika 2.4 e programit).

Nënpika 2.4.4 e programit. Auditim mbi hartimin e projekteve, zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomike fitues.

Referuar regjistrin të procedurave me vlerë të lartë të zhvilluar në vitin 2021, konstatohet se në fushën e investimeve janë realizuar gjithsej 11 procedura me fond limit 397,355 mijë lekë ose 91.6% e fondit gjithsej të prokuruar.

Në totalin e procedurave për investime, vlerën më të lartë e zë procedura me objekt òFurnizimi me ujë i zonës Baba Rrexhepi dhe lugu i Dardhës. Faza e II (Loti Përfundimtar).ò Me fond limit 315,697 mijë lekë. Kjo kontratë ishte akoma në zbatim me afat përfundimi deri datë 31.12.2022.

Nëse nga totali i investimeve për vitin 2021 me vlerë do zbresim vlerën e këtij investimi, mbetet për auditim vlera 81,657 mijë lekë.

Grupi i auditimit mbi bazën e materialitetit, nga 10 procedura me fond limit 81,657 mijë lekë, ka vlerësuar për auditim 4 procedura me fond limit 32,836 mijë lekë ose 40% e totalit. Gjithashtu u auditua dhe zbatimi i kontratës së pastrimit me vlerë 48,465 mijë lekë.

Nga auditimi ka rezultuar se:

1.Procedura me objekt: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Kristal”, “Përmeti”, “Papa Gjon Pali i II” dhe riveshje gropash”.

1. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Kristal”, “Përmeti”, “Papa Gjon Pali i II” dhe riveshje gropash”.				
14.Lidhja e kontratës Nr. 5 prot., datë 03.05.2021	15.Vlera e kontratës (me TVSh) lekë OE fitues A... Sh.p.k		16. Likuiduar lekë 12 977 436 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar datë. -Vlera me TVSh 12 977 436 lekë -Vlera pa TVSh 10 814 530 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 ditë, Zbatuar 30 ditë. Fillimi punimeve: 06.05.2021 Përfundimi punimeve: 07.06.2021		19. Zgjatja e kontratës	
20. Mbikëqyrësi i punimeve K.K.	Licenca Nr: MK.....	Kontrata nr.5/1 prot., datë 03.05.2021..	Vlera e Kontratës (me TVSh) 48,000 lekë	Likuiduar (me TVSh) 48,000 leke
21. Kolaudatori i punimeve Emri Mbiemri: Ing. A.K.	Licenca Nr: MK ...	Kontrata nr. 5/2 prot., datë 03.05.2021.	Vlera e Kontratës (me TVSh) 24,000 lekë	Likuiduar (me TVSh) 24,000 lekë

22.Akt Kolaudimi Datë 11.06.2021.	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 12.06.2021. ne baze te udhërit nr.5/6 date 04.06.2021	

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr.5 prot., datë 03.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë, të përfaqësuar nga Titullari A.G. dhe Operatorit Ekonomikë OE A..., me përfaqësues A.P. me licencë profesionale NZ ..., datë 12.11.2019. Vlera e kontratës është 12,977,491,20 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 30 (ditë) nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve dhe hyrja në kantierin e ndërtimit. Periudha e garancisë të punimeve 12 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 5/1 prot., datë 03.05.2021 është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Ing. K.K., me nr. Licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. ..., datë 03.05.2021 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 48 000 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 5/2, datë 03.05.2021 është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Ing. A.K., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK ..., datë 03.05.2021 përfaqësuar A.K. dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 24,000 lekë me TVSh.

Projektpreventivi

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga Ing. M.ZH. në vitin 2021.

Titulli gjetjes: *Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin “Sistemin i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Kristal”, “Përmeti”, “Papa Gjon Pali i II” dhe riveshje gropash”, Bashkia Sarandë, nga zbatuesi i punimeve OE A..., për zërat e punimeve A.6, dhe C.6*

Situata:

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 06.05.2021 dhe kanë përfunduar me datë 07.06.2021, brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 06.05.2021 sipas të cilit ò...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...ò.

Më datë 10.05.2021, K.K. mbikëqyrësi i punimeve i ka dërguar AK kërkesën për azhornimin e projektit për arsye të mospërputhjes të vumeve të punimeve.

Me procesverbalin e datës 13.05.2021 òMiratimi i ndryshimeve në projekt preventivò, formuluar/nënshkruar nga R.H., K.K. e administratori i A...A.P. është miratuar ndryshimet për zërat e punimeve që shtohen dhe zbriten, pa tejkalar fondin e planifikuar.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekti fillestar i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, libri i masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me vumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti

Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **235,200 lekë pa TVSh.**

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
A	Rr. Kristal (b=5m, l=200 m)							
5	Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit	m ²	350	322	322	0	322	112,700
C	Rr. Gjon Pali i II (b=5m, l=350 m)							
5	Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit	m ²	350	350	350	0	350	122,500
							Total	235,200

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

A. Rr. Kristal (b=5m, l=322 m)

1. Zëri A.5 “Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit”. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri është 200 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 322 m³. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 322 m³, i detajuar sipas projektit (322m x0.5m x2). Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton në fakt ky volum, me këto përmasa, nuk është realizuar në objekt, për pasojë vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

C. Rr. Gjon Pali i II

2. Zëri C.6 “Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit”. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri është 350 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 350 m³. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 350 m³, i detajuar sipas projektit (350m x0.5m x2). Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, në fakt ky volum, me këto përmasa, nuk është realizuar në objekt, për pasojë vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

- Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës ÷Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve

Kriteri:

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me Projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ÷Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimitit, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ÷Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitit e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5 prot., datë 03.05.2021.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 5/1 prot., datë 03.05.2021

Ndikimi/Efekti:

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Sarandë

Shkaku:

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të Projekt preventivit.

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **235,200 lekë** pa TVSh nga shoqëria A..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën nr. 5 prot, datë 03.05.2021 me objekt: *“Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Kristal”, “Përmeti”, “Papa Gjon Pali i II” dhe riveshje gropashë, Bashkia Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.*

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. K.K. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. A.K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

2.Procedura me objekt: *“Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. “Ismail Qemali” “Çabej”, “Adem Jashari”, Bashkia Sarandë.*

2. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: <i>“Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. “Ismail Qemali” “Çabej”, “Adem Jashari”.</i>				
14.Lidhja e kontratës Nr. 6 prot., datë 03.05.2021	15.Vlera e kontratës (me TVSh) lekë OE fitues 2...Sh.p.k		16. Likuiduar lekë 11,271,132 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar datë. -Vlera me TVSh 11,271,132 lekë -Vlera pa TVSh 9,392,610 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 ditë, Zbatuar 30 ditë. Fillimi punimeve: 06.05.2021 Përfundimi punimeve : 07.06.2021		19. Zgjatja e kontratës	
20. Mbikëqyrësi i punimeve K.K.	Licenca Nr: MK....	Kontrata nr.5/1 prot., datë 03.05.2021..	Vlera e Kontratës (me TVSh) 48,000 lekë	Likuiduar (me TVSh) 48, 000 leke
21. Kolaudatori i punimeve Emri Mbiemri: Ing. A.K.	Licenca Nr: MK....	Kontrata nr. 5/2 prot., datë 03.05.2021.	Vlera e Kontratës (me TVSh) 24,000 lekë	Likuiduar (me TVSh) 24,000 lekë
22.Akt Kolaudimi Datë 07.06.2021.	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 08.06.2021. në bazë të urdhrin nr. 6/6 prot. datë 03.06.2021			

Kontratrat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr.6 prot., datë 03.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë, të përfaqësuar nga Titullari A.G. dhe Operatorit Ekonomikë OE 2...Sh.p.k, me përfaqësues A.S. me licencë profesionale NZ 3455/13, datë 07.10.2019 Vlera e kontratës është 11,271,132 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 30 (ditë) nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve dhe hyrja në kantierin e ndërtimit. Periudha e garancisë të punimeve 12 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 6/1prot., datë 03.05.2021 është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Ing. K.K., me nr. Licencë për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0354/3, datë 03.05.2021, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 48,000 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 6/2 prot., datë 03.05.2021 është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Ing. A.K. , me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 1011, datë 03.05.2021, dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 24,000 lekë me TVSh.

Projektpreventivi

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga Ing. M.ZH. në vitin 2021.

Titulli gjetjes 2: Diferenca në volume për punime të deklaruar të kryera në objektin Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton”, Bashkia Sarandë, nga zbatuesi i punimeve OE 2...Sh.p.k, për zërat e punimeve A.5, dhe C.5

Situata:

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 06.05.2021 dhe kanë përfunduar me datë 07.06.2021, brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 06.05.2021 sipas të cilit ò...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...ò.

Nuk ka ndryshim projekti.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekti fillestar i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, libri i masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **317,148lekë pa TVSh.**

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
A	Rr. E. Çabej + I. Qemali (b=5m, l=750 m)							
5	Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit	m ²	380	759.60	750	0	759.60	288,648
C	Rr. Adem Jashari (b=3m, l=75m)							
5	Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit	m ²	380	75	75	0	75	28,500
							Total	317,148

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

A. Rr. Eqerem Çabej + Ismail Qemali (b=5m, l=750 m)

1. Zëri A.5-3.207“Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit”. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri është 750 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 759.60 m³.

Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 750 m^3 , i detajuar sipas projektit [(375+265 +110 m) x0.5m x2]. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton në fakt ky volum, me këto përmasa, nuk është realizuar në objekt, për pasojë vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

C. Rr. Adem Jashari (b=3m, l=75 m)

2. Zëri C.5 -3.207“Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit”. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri është 75 m^3 . Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 75 m^3 . Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 350 m^3 , i detajuar sipas projektit (75m x0.5m x2). Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, në fakt ky volum, me këto përmasa, nuk është realizuar në objekt, për pasojë vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

- Ka patur diferenca në volume dhe çmime në zërat e punës ÷Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri:

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me Projektpreventivi dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ÷Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ÷Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit të konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6 prot., datë 03.05.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6/1 prot., datë 03.05.2021.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 6/2 prot., datë 03.05.2021.

Ndikimi/Efekti:

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Sarandë

Shkaku:

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të Projektpreventivi

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **317,148 lekë** pa TVSh nga shoqëria 2..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5 prot datë 03.05.2021 me objekt: ÷Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. “Ismail Qemali” “Çabej”, “Adem Jashari”, Bashkia Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. K.K. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. A.K. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

3.Procedura me objekt: “Sistemim i rrugëve te brendshme me asfaltobeton Rr. Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Amantia, Kristoforidhi”, Bashkia Sarandë.

Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Sistemim i rrugëve te brendshme me asfaltobeton Rr. Gjergj Fishta , Naim Frashëri, Amantia, Kristoforidhi”

14.Lidhja e kontratës Nr.7 prot., datë 26.04.2021	15.Vlera e kontratës (me TVSh) lekë OE fitues M...Sh.p.k		16. Likuiduar lekë 10,236,960 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar datë. -Vlera me TVSh 10,236,960 lekë -Vlera pa TVSh 8,530,800 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 ditë, Zbatuar 30 ditë. Fillimi punimeve: 21.05.2021 Përfundimi punimeve : 20.06.2021		19. Zgjatja e kontratës nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve K.K.	Licenca Nr: MK....	Kontrata nr.7/1 prot., datë 26.04.2021..	Vlera e Kontratës (me TVSh) 48,000lekë	Likuiduar (me TVSh) 48 000 leke
21. Kolaudatori i punimeve Emri Mbiemri: Ing. A.T.	Licenca Nr: MK ..	Kontrata nr. 7/2 prot., datë 26.04.2021.	Vlera e Kontratës (me TVSh) 24,000 lekë	Likuiduar (me TVSh) 24,000 lekë
22.Akt Kolaudimi Datë 21.06.2021.	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 24.06.2021. në bazë të urdhrin nr. 7/6 datë 18.06.2021			

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr.7 prot., datë 26.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë, të përfaqësuar nga Titullari A.G. dhe Operatorit Ekonomikë OE M..., me përfaqësues M.M. me licencë profesionale N ..., datë 22.01.2021 Vlera e kontratës është 10,236,960 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 30 (ditë) nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve dhe hyrja në kantierin e ndërtimit. Periudha e garancisë të punimeve 12 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 7/1 prot., datë 26.04.2021 është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Ing. K.K. me përfaqësues K.K., me nr. Licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0354/3, datë 26.04.2021 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 48,000 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 7/2, datë 26.04.2021 është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Ing. A.T., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK....., datë 04.02.2020, me vlerë të kontratës së shërbimit 24,000 lekë me TVSh

Projektpreventivi

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga Ing. M.ZH. në vitin 2021.

Titulli gjetjes 3:*Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. Gjergj Fishta , Naim Frashëri, Amantia, Kristoforidhi”, Bashkia Sarandë, nga zbatuesi i punimeve OE M..., për zërat e punimeve A.6 dhe C.6.*

Situata:

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 21.05.2021 dhe kanë përfunduar me datë 20.06.2021, brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 21.05.2021 sipas të cilit ò...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...ò.

Projekti është zbatuar sipas projekt preventivit

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekti fillestar i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, libri i masave, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **61,500 lekë pa TVSh.**

Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
A	Rr. Gjerj Fishta (b=5m, l=170 m)							
5	Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit	m ²	300	117	117	0	117	35,000
C	Rr. Amantia (b=3m, l=220 m)							
5	Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit	m ²	300	88	88	0	88	26,400
							Total	61,500

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

A. Rr. “Gjerj Fishta” (b=5m, l=170 m)

1. Zëri A. 6 “Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit”. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri është 170 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 117 m³. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 117 m³, i detajuar sipas seksioneve. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, dhe auditimi në terren rezulton se; në fakt ky volum, me këto përmasa, nuk është realizuar në objekt, për pasojë vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

C. Rr. “Amantia” (b=3m, l=220 m)

2. Zëri C. 6 “Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit”. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri është 220 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 88 m³. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 88 m³, i detajuar sipas seksioneve. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, dhe auditimi në terren rezulton se; në fakt ky volum, me këto përmasa, nuk është realizuar në objekt, për pasojë vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri:

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me Projektpreventivi dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 òPër Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 òPër mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6 prot., datë 03.05.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6/1 prot., datë 03.05.2021.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 6/2 prot., datë 03.05.2021.

Ndikimi/Efekti:

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Sarandë

Shkaku:

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të Projektpreventivi

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **61,500 lekë** pa TVSh nga shoqëria M..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7 prot., datë 26.04.2024 me objekt: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. Gjergj Fishta , Naim Frashëri, Amantia, Kristoforidhi”, Bashkia Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. K.K. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. A.T. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

4.Procedura me objekt: “Sistemimi i bllokut të banesave në lagjen e Lugut të Dardhës”, Bashkia Sarandë.

4. Zbatimi i Kontratës së Punimeve: “Sistemimi i bllokut të banesave në lagjen e Lugut të Dardhës” Bashkia Sarandë				
14.Lidhja e kontratës Nr.8 prot., datë 30.04.2021	15.Vlera e kontratës (me TVSh) lekë OE fitues I...		16. Likuiduar lekë 4,917,698 lekë	
17- Situacioni Përfundimtar datë. -Vlera me TVSh 4,917,698 lekë -Vlera pa TVSh 4,098,081 lekë	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 30 ditë, Zbatuar 30 ditë. Fillimi punimeve: 30.04.2021 Përfundimi punimeve 20.05.2021		19. Zgjatja e kontratës nuk ka	
20. Mbikëqyrësi i punimeve K.K.	Licenca Nr: MK....	Kontrata nr.8/1 prot., datë 30.04.2021.	Vlera e Kontratës (me TVSh) 48,000lekë	Likuiduar (me TVSh) 48,000 leke
21. Kolaudatori i punimeve Ing. A.T.	Licenca Nr: MK ...	Kontrata nr. 8/2 prot., datë 30.04.2021.	Vlera e Kontratës (me TVSh) 24,000 lekë	Likuiduar (me TVSh) 24,000 lekë
22.Akt Kolaudimi Datë 30.05.2021.	23.Akt i marrjes në dorëzim datë 31.05.2021. në bazë të urdhrin nr.8/6 date 27.05.2021			

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës për punë publike me nr.8 prot., datë 30.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë, të përfaqësuar nga Titullari A.G. dhe OE I..., me përfaqësues B... me licencë profesionale N .., datë 21.02.2021. Vlera e kontratës është 4,918,220 lekë me TVSh. Afati zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 30 (ditë) nga data e dorëzimit të sheshit të punimeve dhe hyrja në kantierin e ndërtimit. Periudha e garancisë të punimeve 12 muaj.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 8/1prot., datë 30.04.2021 është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Ing. K.K. me nr. Licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. ..., datë 30.04.2021 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 48,000 lekë me TVSh.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas aktit me nr. 8/2, datë 30.04.2021 është lidhur kontrata përkatëse e këtij shërbimi me Ing. A.T., me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK....., datë 04.02.2020 dhe me vlerë të kontratës së shërbimit 24,000 lekë me TVSh.

Projektpreventivi

Projektpreventivi i objektit është hartuar nga Ing. K.K. në vitin 2021.

Titulli gjetjes 3: *Diferenca në volume për punime të deklaruara të kryera në objektin: “Rehabilitimi i pesë kanaleve ujitëse në zonën e Sukut”, Bashkia Sarandë, nga zbatuesi i punimeve OE I..., për zërat e punimeve 7 dhe 9.*

Situata:

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet, sipas njoftimeve përkatëse kanë nisur me datë 30.04.2021 dhe kanë përfunduar me datë 20.05.2021, brenda afatit të përcaktuar në kontratë.

Është bërë akti i dorëzimit të sheshit të ndërtimit në datën 30.04.2021 sipas të cilit ò...nga verifikimi në vend i sheshit, u konstatua se sheshi është i lirë dhe sipërmarrësi i punimeve merr në dorëzim sheshin e punimeve për realizimin e kontratës...ò.

Më datë 03.05.2021, K.K. mbikëqyrësi i punimeve i ka dërguar AK kërkesën për azhornimin e projektit për arsye të mospërputhjes të volumeve të punimeve.

Me procesverbalin e datës 04.05.2021 óMiratimi i ndryshimeve në projekt preventivò, formuluar/nëshkruar nga R.H., K.K. e administratori i ó I...ò Sh.p.k B... është miratuar ndryshimet për zërat e punimeve që shtohen dhe zbriten, pa tejkaluar fondin e planifikuar.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dokumentacioni teknik i zbatimit: Projekti fillestar i zbatimit dhe projekti i azhurnuar, Situacioni përfundimtar, libri i masave, etj.
- 2) Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **125,400 lekë pa tvsh pa TVSh.**

3) Tabela nr. 1

Nr	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
9	Shtresë stabilizant t=10 cm bankinat							
2	Seksionin: A-B; E-F; L-K; I-J	m ³	440	285	285.3	0	285	125,400
							Total	125,400

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

1. Zëri 7. “F.V. Hekur betoni i zakonshëm Ø 6 - Ø 10 mm”. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri është 2.43 ton. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 2.46 ton. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 3 ton, i detajuar sipas seksioneve: A-B = 0.22 ton; E-F = 0.91 ton; L-K= 0.94 ton; I-J = 0.80 ton dhe M-N 0.14.ton. me FV hekuri me Ø 6 mm - Ø 10 mm). Referuar observacionit paraqitur nga subjekti me shkresën nr. 1518/2, datë 27.5.2022, llogaritja e sasisë së hekurit është bërë për zgara Ø 4 mm. Gjatësi totale (2160.45m²x10ml/m²) = 21604.5 x 0.0989=2.14 ton. Në

situacionin përfundimtar janë 2.46 ton diferenca 0.32 t Sasia e hekurit të vendosur është 2.14 ton ose 0.32 ton më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri 9 “Shtresë çakëll t=10cm, përhapur e ngjeshur me makineri, b=2x0.5m, për bankinat anësore të betonit”. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri është 285 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar ky zë pune figuron në sasinë 285 m³. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 285.3 m³, i detajuar sipas seksioneve. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, dhe auditimi në terren rezulton se; në fakt ky volum, me këto përmasa, nuk është realizuar në objekt, për pasojë vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri:

Situacionimi i volumeve jo në përputhje me Projektpreventivi dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 ÷Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimiö, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 ÷Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimitö e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6 prot., datë 03.05.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 6/1 prot., datë 03.05.2021.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas aktit me nr. 6/2 prot., datë 03.05.2021.

Ndikimi/Efekti:

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Sarandë

Shkaku:

Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të Projektpreventivi

Rëndësia: i lartë

Për këtë rekomandojmë:

Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **125,400 lekë pa tvsh** pa TVSh nga shoqëria I..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8 prot., datë 30.04.2024 me objekt:öSistemimi i bllokut të banesave në lagjen e Lugut të Dardhës”, Bashkia Sarandë, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. K.K. me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. A.T. me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

5.Procedura me objekt: “Pastrimi i qytetit dhe largimi i mbetjeve” , Bashkia Sarandë.

5. Zbatimi i Kontratës së shërbimit me objekt: “Pastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane” Bashkia Sarandë		
14.Lidhja e kontratës Nr. 25 Prot .,datë 01.12.2016	15.Vlera e kontratës 48,465,088.05 lekë me TVSh OE fitues A.....Sh.p.k	16.Likuiduar: Situacione mujore, hollësisht në fund të Aktit të Konstatimit
17- Situacioni Përfundimtar Nga data 01.01.2019- deri më 30.06.2020 -Vlera 5,278,347 lekë me TVSh	18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 1 vit (12 muaj). Fillimi i shërbimit: 01.11.2020 Përfundimi shërbimit më datë	19. Zgjatja e kontratës Sëka

	30.11.2021		
20. Mbikëqyrësi i shërbimit S.H.			

Grupi i Punës e Përlogaritjes së Fondit Limit:

Preventivi i pastrimit është realizuar nga H....Sh.p.k përfaqësuar nga ing. F.B.. (janë përlogaritur në bazë të 21 analizave të shërbimit të pastrimit) në vitin 2018.

Analiza e shërbimit/oferta fituese është paraqitur në aneksin e Aktit të Konstatimit.

Kontratat (Sipërmarrjes).

Kontrata me nr. 25 prot., datë 01.12.2020 me objekt: “Pastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Sarandë” e lidhur ndërmjet Bashkisë Sarandë përfaqësuar nga Kryetari A.G. dhe Operatorëve Ekonomik A.....Sh.p.k përfaqësuar nga administrator A.A. Vlera totale e kontratës (në përputhje me preventivin e punimeve për të gjitha operacionet e punës) është 48,466,088.05 (dyzetë e tetë milion e katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e tetëdhjetë e tetë presje pesë) lekë pa TVSH dhe 58,159,305.66 lekë me TVSh. Operatori ekonomik do të kryejë shërbimin e sipërcituar duke filluar nga data 01.12.2020 deri më datë 30.11.2021.

Grupi i Punës e Përlogaritjes së Fondit Limit:

Preventivi i pastrimit është realizuar nga H....Sh.p.k përfaqësuar nga ing. F.B.. (janë përlogaritur në bazë të 21 analizave të shërbimit të pastrimit) në vitin 2018.

Analiza e shërbimit/oferta fituese është paraqitur në aneksin e Aktit të Konstatimit.

Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1) Dokumentacioni teknik i analizës së kostos së shërbimit, situacionet mujore, dokumentacioni i dosjes së zbatimit, etj.

Referuar Specifikimeve teknike: Aktivitetet që do të kryhen për realizimin e pastrimit të territorit në bashkinë Sarandë janë:

- Mbledhja, grumbullimi dhe transport mbetjeve urbane për në landfillin e Bajkalit.
- Mbledhja, grumbullimi dhe transportimi i mbetjeve të vëllimshme për në vend depozitimin e caktuar nga bashkia
- Larje dhe dezinfektim i kazanëve, pesetave dhe hapësirave publike
- Pastrim tregu fruta ó perime
- Pastrim tregu i shumicës
- Fshirje me mjet teknologjik e kunatave
- Fshirje me fshesë dore e rrugëve dhe shesheve gjatë ditës dhe natës
- Larje rrugësh dhe sheshe

A. Mungon dokumentacioni që provon monitorimin e shërbimit nga Autoriteti Kontrakto

1.- Grafikët vjetor të punimeve për realizimin e shërbimit të pastrimit të zonës, të përgatitur nga OE A.... dhe të miratuar nga AK Bashkia Sarandë.

- Oraret e operimit në secilën pikë kontejnerësh.
- Llojin, targën dhe itinerarin e makinave teknologjike që do të kryejnë shërbimin.
- Oraret e operimit dhe mjetet për shërbimet mbështetëse.
- Numrin e punëtorëve që do të mbështesin çdo operacion punimesh.

Referuar pikës 4”Grafikët e punimeve duhet të zbatohen rigorozisht nga operatori i shërbimit. Operatori i shërbimit nuk mund të punojë dhe të paguhet pa miratimin paraprak të grafikut të punimeve apo kur grafikut i ka kaluar afati i zbatimit”.

2. “Zyrë të Kontaktimit” për marrjen e ankesave.

3. Në të gjithë makinat dhe kontejnerët nuk shkruhet: **“Me ju për një qytet më të pastër”**, numri i telefonit të shërbimit 24 orësh.
4. -Referuar nenit 8 të kontratës OE A...., është i detyruar të paraqesë raporte mujore dhe vjetore, në të cilat duhet të parashikojë listën dhe gjendjen aktuale të automjeteve dhe pajisjeve (kontejnerëve, etj) të cilat përdoren për proceset e punës sipas preventivit në përputhje me Specifikimet Teknike. Në dosjen e zbatimit të shërbimit nuk gjendet asnjë raport mujor/vjetor.
5. OE A...., nuk ka paraqitur për miratim, një herë në 3- muaj Programin e Edukimit Publik Ambiental tek AK sipas përcaktimeve të bëra në Nenin 26. 12, i cili bëhet i zbatueshëm në rast se është konformë përcaktimeve të bëra në kontratë dhe pas miratimit nga Bashkia. OE nuk është ngarkuar me përgjegjësi e nuk është gjobitur, për mungesën e programit.
6. OE A...., nuk ka paraqitur stafin dhe punonjësit e paraqitur në oferte në gatishmëri për punë në datën e përcaktuar në kontratë për fillimin e punimeve. Në kundërshtim me pikën 7.3 të nenit 7 ÷Detyrimet e Sipërmarrësitö.
7. OE A...., nuk ka paraqitur brenda datës së përcaktuar në kontratë për fillimin e punimeve të gjitha mjetet, makineritë dhe pajisjet e paraqitura në oferte sipas specifikimeve të përcaktuara në kapitullin "Specifikimet Teknike". Nga auditimi në terren u konstatua që: mjetet makineritë dhe pajisjet që realizojnë shërbimin nuk janë ato të paraqitura në deklaratën mbi disponimin e makinerive (shtojca 10) e administratorit A.A. Veprimi në kundërshtim me pikën 7.2 të nenit 7 të kontratës dhe është në rastin e deklaratimit të rremë dhe AK duhet të vepronte në përputhje me nenin 13, pika 3, germa öaö të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, öPër Prokurimin Publikö.

Nga grupi i auditimit u kërkuan listëpagesat e gjithë të punësuarit e tij në përputhje me të gjitha dispozitat ligjore në fuqi të R.SH-së. Që OE A...., që nevojiten për realizimin e shërbimit

- Në dosjen e zbatimit Operatori Ekonomik A...., ka paraqitur listë emërore me 65 punonjës pastrimi për Bashkinë Sarandë (lista nuk ka asnjë ekstremitet, apo përshkrim për profesionin e punonjësve përveç ID).

Nga auditimi i situacioneve mujore, specifikimeve teknike, DT, listëprezencat e paraqitura nga drejtuesi teknik i OE dhe kontrat e zbatimit të shërbimit, analizës së çmimit të ofertës fituese si dhe detyrimin për paraqitjen çdo ditë (365 ditë në vit) në punë OE A...., minimalisht 75 (shtatëdhjetë e pesë) punonjës, rezulton diferenca në numrin e punonjësve që paguhen nga Autoriteti Kontraktor por që nuk janë prezent në shërbimin “Pastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane” Bashkia Sarandë, në përputhje me preventivin e hartuar nga projektuesi, specifikimet teknike e kontratën e nënshkruar, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **4,363 338.20 lekë pa TVSh**.

Diferencat janë të argumentuara si më poshtë:

Në DT është kërkuar: . Një punësim mesatar i të paktën **75 (shtatëdhjetë e pesë) personave**, për periudhën **Janar 2020 - Qershor 2020** të vërtetuar me:

OE A...., nuk ka paraqitur stafin dhe punonjësit e paraqitur në oferte në gatishmëri për punë në datën e përcaktuar në kontratë për fillimin e punimeve. Në kundërshtim me pikën 7.3 të nenit 7 ÷Detyrimet e Sipërmarrësitö dhe specifikimeve teknike.

Në aneksin e procesverbali gjenden kontratat e lidhura nga OE A...., që bënë të pamundur realizimin e shërbimeve me numrin e punonjësve të deklaruar në ofertën e paraqitur.

Nga grupi i auditimit u morr në konsideratë analiza e kostos IV “Fshirje me fshesë dore e rrugëve ,shesheve dhe hapësirave të tjera Brenda lagjeve, ditën në Ksamil për sipërfaqen

19,000 m². Shërbim që do të kryhet çdo ditë të vitit gjithsej 365 shërbimeö, paraqitur nga OE fitues(436,333.82 lekë/vit/1 punëtor x 10 punëtor = 4,363,338.20).

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se i janë likuiduar tepër në vlerën 4,363,338.20 pa TVSh sipërmarrësit të shërbimit për fuqi punëtoresh që nuk merr pjesë në shërbimin e pastrimit, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. G.D. me detyrë Drejtori i Shërbimeve Publike.
2. S.H. supervizor i kontratë së shërbimit.

Pika 2.5. Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

Titulli gjetjes 1. Statusit të rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 101/9, datë 01.10.2021.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH rezulton se: Nga Bashkia Sarandë është respektuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve (shkresa nr. 4891/2, datë 19.10.2021, **pra brenda afatit 20 ditor**).

Nuk është respektuar afati që brenda periudhën 6 mujore, Bashkia Sarandë duhet të informojë mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Sarandë, **nuk ka raportuar në këshillin e njësisë** (këshillin bashkiak), bazuar në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 për financat e vetëqeverisjes vendore, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij. Është hartuar plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve në të cilën janë përcaktuar strukturat dhe personat për zbatimin e rekomandimeve me afate konkrete.

Gjithashtu rezulton se:

a. Janë rekomanduar 16 masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 9 masa, është në proces zbatimi 1 (një) masë dhe nuk janë zbatuar 6 masa.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 5 masa me vlerë 6,748,993 lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, por janë në proces zbatimi pasi janë kontabilizuar.

c. Për masa mos efektivitet dhe eficensë, janë rekomanduar gjithsej 3 masa me vlerë 11.236.480 lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, duke mbetur pa zbatuar 3 masa me vlerë 6,748,993 lekë.

d. Për masa mungesë të ardhurash, janë rekomanduar gjithsej 4 masa me vlerë 495,505,008 lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, duke mbetur pa zbatuar vlera prej 495,505,008 lekë.

e. Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej 6 masa të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti..

Kriteri:

Ligji Nr. 154, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit nën neni 15, dhe Drejtat e KLSH, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 për financat e vetëqeverisjes vendore

Ndikimi/Efekti:

Mos ndjekje të procedurave në arkëtimin e detyrimeve për masa shpërblim dëmi në vlerën **100,239,676 lekë**.

Shkaku: Neglizhencë dhe papërgjegjshmëri e strukturave drejtuese.

Rëndësia: *E Lartë*

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Sarandë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 101/9, datë 01.10.201 òPër zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Sarandë, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht për:*

- **7 masa** organizative, ku 6 prej tyre nuk janë zbatuar fare;
- **5 masa** shpërblim dëmi me vlerë **6,748,993 lekë**;
- **3 masa** shpenzime në kundërshtim me 3-E për vlerën **6,748,993 lekë**;
- **3 masa** mungesë të ardhurash në shumën **495,505,008 lekë**

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Sarandë të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e KLSH.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 15 dhe 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e KLSH”, duke ngarkuar me përgjegjësi:

1. **A.G.**, me funksion Kryetar i Bashkisë Sarandë.
2. **T.S.**, me funksion Drejtor Drejtorja e Zhvillimit Ekonomik Financiar.
3. **L.B.** me funksion Drejtor i Taksave Bashkia Sarandë.
4. **L.H.** me funksion Specialiste në Drejtorinë Juridike.
5. **E.L.** me funksion Specialist Njësia e Prokurimeve.
6. **P.ZH.** me funksion Drejtor Drejtorja e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.

Më hollësisht për çdo rekomandim dhe statusi përkatës është paraqitur në Aneks 2.5, bashkëlidhur raport auditimit.

Pika 2.6 e programit. Të ndryshme (ankesa)

Nëinstitucionin e KLSH, nëpërmjet postës elektronike është paraqitur ankesë nga qytetari L.H., hyrë në KLSH nr. 1067, datë 11.10.2021, në të cilën kërkohet të auditohet procedura e dhënies së autorizimit nga DPZHT Bashkia Sarandë të njërame tëvendosur në hyrje të pallatit përpara njësisëtrejtare, përfituar sipas Deklaratës Noteriale hartuar nga noteri A.A. me nr. 2038rep/nr. 524kol, si dhe kontratë sipërmarrje me nr. 2307rep/523kol, datë 14.5.2004 për ndërtimin e një dyqani me sipërfaqe 53 m2 dhe vlerë 63000 mijë dollarë, ku *sipas qytetarit* përcaktohet tek dyqani do të bëhet parapet i dyqanit dhe shkallët përkatëse në këtë sipërfaqe të shtuar (nuk ka dokument që vërteton hipotekën e dyqanit).

Qytetari L.H., banor i qytetit Sarandë me adresë: Lagja nr. 2, Rruga òLefter Taloö, pallati nr. 161, kati i dytë pranë hotel òT...iö, ka bërë ankesë kundrejt Drejtorisë së PZHT Bashkia Sarandë, adresuar kjo dhe KLSH protokolluar me shkresën nr. 1067, datë 11.10.2021.

Sipas pretendimeve të qytetarit, ankohet se nga DPZHT është lëshuar autorizim nr. 2044/1, datë 31.7.2018, ku autorizon T.M. të kryej punime në objektin òGodinë banimi dhe shërbimiö, lagj nr. 2, me objekt: òPunime për vendosjen e ramës me konstruksion të lehtësuar metalik për përshtatjen e ndërtesës për personat me aftësi të kufizuar”.

Sipas qytetarit L.H.,pretendohet së akti administrativ (Autorizimi nr. 2044/1, datë 31.07.2018) është i paligjshëm dhe absolutisht i pavlefshëm në zbatim të nenit 108 dhe 109 të K.P. Administrative.

Drejtoria e PZHT Bashkia Sarandë ka pajisur me Autorizim nr. 2044/1 prot, datë 31.7.2018 qytetarin T.M., kjo referuar kërkesës së tij nr. 2044 prot, datë 24.7.2018, për vendosjen e njëramepër të realizuar hyrjen dhe daljen në banesë, pasi sipas kërkesës T.M. dhe F.Z. janë invalid, ku në referencë të nenit 9 dhe 10 të ligjit nr. 93/2014 datë 24.7.2014 oPër përfshirjen dhe Aksesushmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuarö, i ndryshuar, përfitojnë lehtësira në komunitet për lëvizjen e tyre.

Në zbatim të ligjit për personat me aftësi të kufizuar, DPZHT Bashkia Sarandë në zbatim të nenit 7¹¹ të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 oPër miratimin e rregullores së zhvillim territoritö, i ndryshuar, ka miratuar autorizimin për vendosje e një rame me konstruksion të lehtë metalik për përshtaten e ndërtesës për personat me aftësi të kufizuar.

Pretendimi i qytetarit L.H., se ballkoni që kalon para njësisë është pronë e tij, nuk qëndron pasi e gjithë sipërfaqja e ballkonit që përshkon dhe njësinë e tij, shërben si serviut kalimi si për banorët e pallatit, po ashtu dhe për pikat e shërbimit (ambient i përbashkët).

Bashkia Sarandë në përgjigje të kërkesës nr. K3/L14-2, datë 24.04.2019 të Avokatit të Popullit, depozituar pranë Bashkisë Sarandë datë 30.4.2019, bën me dije se:

- *Bashkia Sarandë nuk mund të marrë asnjë masë për faktin se problemi i L.H. ka të bëjë me një konflikt civil dhe jo administrativ;*
- *Autorizimi për ramë është bërë brenda çdo procedure ligjore, duke i ardhur në ndihmë personave me aftësi të kufizuar, në zbatim të ligjit nr. 93/2014 datë 24.7.2014 “Për përfshirjen dhe Aksesushmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuar”, i ndryshuar;*
- *Sipërfaqja për të cilën pretendohet se është pronë e L.H. është sipërfaqe e përbashkët dhe jo hapësirë publike;*

Për zgjidhjen e këtij konflikti L.H. i është drejtuar Gjykatës Administrative Gjirokastër me objekt: “*Shfuqizimin e aktit administrativ nr. 2044/1, datë 31.7.2018, me titull oAutorizimö, të nxjerrë nga DPZHT Bashkia Sarandë, si akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Dokumentacioni i depozituar në gjykim, rezulton së pala paditëse (L.H.) është pronare e vetme e pasurisë nr. 8/174+2-N9, vol.25, fq 164 me sipërfaqe 40 m2 dhe jo pronare mbi të cilën është instaluar rama metalike për personat me aftësitë kufizuar.*

Me vendim nr. 46 datë 22.11.2021, Gjykata Administrative Gjirokastër vendosi rrëzimin e kërkesë padisë së mësipërme të qytetarit L.H..

Nga ana e tij qytetari T.M., sipas kërkesë padisë prot Bashkia Sarandë nr. 1018, datë 7.3.2022, ka paditur në gjykatë qytetarin L.H. me objekt: “*Lirim verande*”, si ambient i përbashkët i pallatit ku banojë, pasi zë me karrike dhe tavolina verandët, duke penguar kalimin e invalidëve për të hyrë në banesë.

Çështja është aktualisht në shqyrtim, jemi në pritje të vendimit.

Konkluzioni: Pretendimi i ngritur nga L.H. në lidhje me dhënien e autorizimit nga DPZHT Bashkia Sarandë, për vendosjen e një rame për personat me aftësi të kufizuar, nuk qëndron, pasi autorizimi është dhënë në përputhje me nenit 7 të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 oPër miratimin e rregullores së zhvillim territoritö i ndryshuar dhe në zbatim të ligjit nr. 93/2014 datë 24.7.2014 oPër përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuarö, i ndryshuar, pasi personat që e kanë përfituar atë janë me aftësi të kufizuar. Gjithashtu referuar Vendim nr. 46 datë 22.11.2021, Gjykata Administrative Gjirokastër, kërkesë padia e L.H. nuk qëndron, duke e rrëzuar atë.

¹¹punimet për ndërtimin e rampave për përshtatjen e ndërtesave për personat me aftësi të kufizuara

Ndërsa në lidhje me ankesën e qytetarit T.M., për lirimin e verandës si ambient i përbashkët i pallatit ku banojë, çështja është në shqyrtim.

Për këtë rekomandojmë:

Kryetari i Bashkisë Sarandë nëpërmjet Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit të marrë masat dhe të informojë ankimuesin L.H. në lidhje me lëshimin e autorizimit nr. 2044/1 prot, datë 31.7.2018 të lëshuar nga Bashkia Sarandë në adresë të qytetarit T.M. me aftësi të kufizuar.

IV. GJETJE DHE PËR KËTË REKOMANDOJMË

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm sipas komponentëve, u konstatua në lidhje me:

“Mjedisin e kontrollit”

Bashkia Sarandë nuk ka Kod të Etikës. Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, Mungon një program strategjik institucional me prioritetet dhe objektivat dhe plan-veprimet e realizimit të tyre. Mungon dokumentacioni që vërteton se GSM është mbledhur dhe është angazhuar për monitorimin e sistemit të brendshëm të kontrollit financiar. Rregullorja e brendshme e miratuar me VKB nr.34 datë 05.06.2008 është shumë e vjetër dhe nuk përshtatet me strukturën organike aktuale, por Projekt-Draft Rregullorja e Re e Brendshme e hartuar është e cila edhe kjo është e mangët, pasi mungon Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e Sektorit të Bordit të Kullimit. Përshtatjet e punës nuk janë rishikuar për çdo vit dhe nuk janë miratuar në DAP. Nuk janë kryer vlerësimet e punonjësve, si dhe mungon një program trajnimi për to.

“Menaxhimi i Riskut”

Është përcaktuar koordinatori i riskut, dhe është hartuar regjistri i riskut, ku janë identifikuar dhe vlerësuar risqet vetëm në fushën e taksave detyrimeve dhe prokurimeve dhe jo në të gjitha fushat. Nuk është bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, të cilat përbëjnë risk për veprimtarinë e bashkisë. Mungon evidenca e niveleve të përcaktuara të tolerancës së riskut. Nuk ka miratuar gjurmën e auditimit, në kundërshtim me nenin 16 të ligjit për MFK.

“Aktivitetet e Kontrollit”

Bashkia Sarandë nuk ka procedura të përshtatshme për të siguruar IT të ndryshme në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve

“Informimi dhe Komunikimi”

Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj. Nga kërkimi i ndërveprimit të tij me qytetarët, konstatohet se në faqen e bregut mungon programi i transparencës. Gjithashtu mungon edhe regjistri me kërkesat dhe përgjigjet e qytetarëve.

“Monitorimi”

Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Auditimi i Brendshëm nuk ka dhënë vlerësime të plota për sistemin e kontrollit të brendshëm.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 *ōPër menaxhimin financiar dhe kontrollin* i ndryshuar, Manualit të MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrisë të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitullin III, pika 3.1. ligjit nr. 119/2014 *ōPër të drejtën e informimit* nenet 4,8. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1 faqe 25-27 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në cilësinë e Nëpunësit Autorizues bashkëpunim me Drejtorin e Drejtorisë Ekonomike, në cilësinë e Nëpunësit Zbatues, të marrin masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë risqeve; për miratimin dhe përmirësimin e rregullores së brendshme në përshtatje me strukturën organike; të kryejë investime në programe kompjuterike të licencuara dhe ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara; gjithashtu zhvillimin e programeve të trajnimeve nga punonjës brenda Bashkisë si dhe të punohet për plotësimin e kërkesave të komponentëve të MFK.

Brenda datës 30.9.2022

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga Njësia e Auditit të Brendshëm (*këtu e vijim NjAB*), Bashkia Sarandë, rezulton se për vitin 2021 realizimi i planit është në masën 100%.

NjAB në hartimin e planeve është fokusuar në prioritetin e risqeve të identifikuar, por nuk ka marrë në konsideratë respektimin e frekuencës së kryerjes së auditimeve. Në të gjitha dosjet e auditimit mungojnë: projekt drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit me të gjitha elementët e tij; Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut, për të evidentuar më saktë mangësitë e vërejtura, për të dhënë një opinion për funksionimin e kontroleve në çdo sistem e për të qenë më të qarta rekomandimet; Në disa raste formulimi i gjetjeve ka mangësi, pasi situata e përshkruar është i karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, në ndonjë rast nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si apo nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë apo raportimit financiar për problematikën e konstatuar nga auditimi; Rekomandimet janë të karakterit të përgjithshëm dhe jo të mirë përcaktuara, një pjesë i referohen bazës ligjore, pra *ōnë zbatim të akteve ligjore*ō, duke mos orientuar ndërmarrjen e veprimeve, të cilat do të sjellin përmirësimet në sistem, në të gjitha rastet nuk është përcaktuar nivelin i rëndësisë së tyre (i lartë, i mesëm dhe i ulët). Projektraporti i përcjellë subjektit të audituar nuk është shoqëruar me Formatin e sugjeruar të Plan-Veprimit për zbatimin e rekomandimeve. Në disa raste nuk është në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar; Në angazhimet e shërbimit të sigurisë të kryera në fakt nga Auditimi të Brendshëm për vitin 2021 mungojnë auditimet në sistemin e prokurimeve, në sistemin e pagesave sistemin e raportimit të pasqyrave financiare, në sistemin administrimin dhe menaxhimin e aseteve etj.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 *ōPër auditimin e brendshëm në sektorin publik* neni 11, neni 12, shkronja òdö, neni 19 dhe neni 20, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave *ōPër miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik* i ndryshuar me Urdhrin e Ministrisë të MFE nr.4 datë 10.01.2020 *ōPër miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në MAB miratuar me Urdhrin nr.100, datë 25.10.2016*ō, Kapitulli II 2.4.1 *ōAuditimi i përputhshmërisë*ō dhe 2.4.2 *ōAuditimi financiar*ō; Kapitulli III, pika 3.5; Kapitulli IV pika 4.1.1 *ōplanifikimi i një angazhimi auditimi*ō, pikës 4.1.11 dhe 4.1.12; kapitulli VI *ōEvidentimi dhe dokumentimi i punës audituese*ō pika 6.1 *ōNiveli i dokumentimit*ō. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1.2 faqe 27-31 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1. Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Sarandë, të kryejë auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e

auditimit në përputhje me MAB dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2021, konstatohet se në total është realizuar në masën 82%, ku nga vlera e planifikuar prej 1,296 mijë lekë është realizuar vlera prej 1,075,684 lekë. Zëri investime paraqitet në masën 59%, shpenzimet operative në masën 71% dhe shpenzime për paga në masën 90%.

Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara për vitin **2021**, nga vlera planifikuar prej **417,275 mijë lekë** është realizuar vlera prej **294,617 mijë lekë**.

Referuar të dhënave, rezulton se në totalin e procedurave të zhvilluara për vitin 2021 (*me vlerë të lartë*), Bashkia Sarandë me të ardhurat e veta mbulon 19% (*nga vlera e kontratave të lidhura prej 110,616 mijë lekë është likuiduar vlera prej 89,307 mijë lekë*), **pra me një diferencë në vlerën 21,309 mijë lekë**.

Pjesa tjetër e kontratave të lidhura e cila paraqitet në vlerën 402,550 mijë lekë, është me financim nga Ministritë e linjës dhe FZHR, ku për vitin ushtrimorë 2021 është planifikuar për likuidim vlera 98,059 mijë lekë, duke respektuar kufirin e 20%, nga e cila likuiduar vlera 78,259 mijë lekë ose më pak për shumën 19,800 mijë lekë, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve nga Buxheti i Shtetit. (*Të dhënat e mësipërme paraqiten në Aneks 2.1, bashkëlidhur Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Mos zbatimi i kontratave të lidhura dhe planifikuara në buxhetin e vitit 2021, nga të ardhurat e veta, vjen si rezultat i mos planifikimit të të ardhurave për likuidimin e këtyre faturave, pasi një pjesë është destinuar për pagesën e detyrimeve të prapambetura nga vitet e kaluara. Gjithashtu sipas Drejtorisë Ekonomike, kjo vjen për faktin se nga subjektet zbatuese dokumentacioni shoqërues nuk është në përputhje me ligjin, pasi ka mangësi në plotësimin e tij. Këto veprime vënë bashkinë në vështirësi financiare, si dhe rrisin detyrimet kreditore në fund të periudhave ushtrimore (fatura të pa likuiduara), ku pavarësisht se vijnë në ulje nga njëra periudhë në tjetër përsëri më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 30,401,541 lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërm janë në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar; pika 101 dhe 102 të udhëzimit të MFE nr. 2, datë 06.02.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime; neni 47 të ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”; nenet 79 -80 -81, të udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit” me ndryshime. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 31-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

3.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrë masa për hartimin e një buxheti real, mbështetur në realizimin e mundshëm dhe objektiv të të ardhurave dhe shpenzimeve. Të bëhen periodikisht analizat e punës për realizimin/mosrealizimin e buxheteve paraardhës, duke nxjerrë konkluzione të sakta për realizimet dhe mosrealizimet e buxheteve përkatëse si dhe të monitorohet ecuria e të ardhurave, duke vlerësuar risqet që mund të ndikojnë në mosrealizimin e vlerës së planifikuar dhe mbi bazën e tyre.

3.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrë masa që shpërndarja e fondeve buxhetore të bazohet në parashikimin e fluksit të hyrjeve të parasë dhe të angazhimeve, ku të sigurohet një përdorim eficient i burimeve financiare, duke rritur financimet nga të ardhurat e veta. Prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, të sigurojë raportim të saktë të tyre në MFE dhe evidentim i plotë në kontabilitet.

3.3. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, për të gjitha rastet e paraqitjes nga subjekti zbatues me vonesë të faturave për likuidim të situacioneve mujore, progresive ose përfundimtare, me dokumentacion jo të rregullt dhe në kundërshtim me kushtet e kontratës, të

aplikohet penalitet (kamatëvonesë) për deklaram me vonesë, si dhe t'ia kërkohet Drejtorisë Rajonale Tatimore Dega Sarandë zbatimin e procedurave për mos deklarim në afat të TVSh në shitje nga mos depozitimi i faturës në afatin e caktuar sipas ditarit të punimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin afatit **30-ditor** të paraqitjes në Degën e Thesarit Sarandë të urdhërshpenzimit me dokumentacionin shoqërues nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 01.01.2021 ó 31.12.2021, janë gjithsej 43 fatura me vlerë 146,297 mijë lekë.

Gjithashtu nga Bashkia Sarandë nuk është planifikuar e gjithë vlera e detyrimeve të prapambetura për likuidim, ku sipas disiplinës buxhetore, buxheti duhet të fillojë me planifikimin për likuidim të detyrimeve të prapambetura (*fatura të pa likuiduara në fund të periudhave ushtrimore*), pasi për vitin 2021 nga vlera prej 57,200 mijë lekë është planifikuar vlera 28,936 mijë lekë ose 49%.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me UMF nr. 5, datë 27.12.2014 *öPër shlyerjen e detyrimeve të prapambetura*, pikat 82-91; Ligjin nr. 68/2017 datë 27.4.2017 *öPër financat e Vetëqeverisjes Vendore* neni 40, 48; Ligjin nr. 9936, datë 26/06/2008 *öPër menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, neni 52. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 31-43 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

4.1. Rekomandimi: Drejtoria e Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrë masa për:

- Sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijohë kufizime limiti të arkës (*përjashtuar kufizimet e transfertave specifike nga Ministritë e linjës dhe donator të ndryshëm*), për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim që të mos akumulohet borxh për fatura të pa likuiduara dhe përfshirjen e institucionit në vështirësi financiare.

- Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës, për të cilat të bëhet përcaktimi i tyre në vlerë dhe detajimi për çdo program, duke respektuar dhe radhën e pagesave.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Bashkia Sarandë dhe të dhënave të raport auditimit të kryer nga NJAB sipas programit nr. 1244, datë 28.3.2022 për hapësirat publike, konstatohet se :

d- Subjektit T... me kontratë nr. 1434, datë 19.8.2021 (*Agjensia Kombëtare e Bregdetit*) dhe nr. 4821, datë 01.10.2021 (Bashkia Sarandë) për sipërfaqen 901 m², i është prerë faturë pagesë për sipërfaqen prej 1000 m² ose më shumë prej 99 m².

e- Subjektit A... me kontratë nr. 1250, datë 3.8.2021 (*Agjensia Kombëtare e Bregdetit*) dhe nr. 3986, datë 6.8.2021 (Bashkia Sarandë) për sipërfaqen 1003 m², i është prerë faturë pagesë për sipërfaqen prej 1300 m² ose më shumë prej 297 m².

f- Dhënia e sipërfaqeve për shfrytëzim të hapësirave për plazhe pa miratim nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit, sipas pasqyrës në faqen 50 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM nr. 171, datë 27.3.2019 i ndryshuar me VKM nr. 1172, datë 24.12.2020. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Bashkia Sarandë, të marrë masa për mos lejimin e shfrytëzimit të hapësirave publike (për plazh), të subjekteve ose individëve të cilat nuk kanë marrë miratim më parë në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit dhe për sipërfaqe jashtë kontratave të lidhura.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2021, rezulton gjendje e konsiderueshme e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” me vlerë 481,241,985 lekë, ku përveç debitorëve të taksave ka ndikuar dhe vlera e lartë e gjendjes në vlerën 162,031,719 lekë të debitorëve për detyrimet shpërblim dëmi të rekomanduara nga KLSH-ja në vite për Bashkinë dhe ish-Komunat, për të cilat nuk janë ndjekur të gjitha hapat ligjore për arkëtim, duke kaluar afatet e kërimit. Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr.10 296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”* i ndryshuar me ligjin nr. 110/2015, datë 15.10.2015, neni 9, 11 dhe 12, me ligjin nr. 68/2017, datë 27.4.2017 *“Për financat e vetëqeverisjes vendore”* i ndryshuar, neni 40. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 65-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Drejtorinë Juridike të marrë masat që për vlerën e debitorë prej 162,031,719 lekë të rekomanduar në vite nga KLSH-ja por të pa arkëtuara, të cilave po ju kalon afati ligjor i kërimit. Të analizojë dokumentacionin ligjor për to, duke i klasifikuar sipas afateve dhe për detyrimet deri në 5 vjet të nxjerrë akte administrative për rivendosjen e afateve dhe kërkimin e tyre në rrugë administrative dhe ligjore.

Brenda datës 30.9.2022

7. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llog. 202 “Studime dhe kërkime” në mbyllje të vitit 2021 paraqitet me vlerë neto 15,940,245 lekë dhe me vlerë bruto prej 119,561,177 lekë (kosto historike), që i përket 113 projekt-studimeve për investime. Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 14,433,919 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e llog. 202 “Studime dhe Kërkime”, për 112 projekt-studime për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”* Aneksi 1. pika 2, Klasa 2 *“Aktivet Afatgjata”*, pika 3.3 nën-pika 62. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 65-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa që gjendja prej 14,433,919 lekë e llog. 202 “Studime dhe kërkime”, të analizohet dhe të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektiveve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2022

8. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e inventarit kontabël të llog. 210 “Toka Troje Terrene”, rezulton se në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 14 artikuj aktive materiale në vlerën 38,081,192 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 212 “Ndërtesa Konstrukione”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”*, Aneksi 1, pika 2. Klasa 2, dhe me Nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 65-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 210 “Toka Troje Terrene”, sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive të planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 212 “Ndërtesa Konstrukione”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2022

9. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e inventarit kontabël të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” rezulton se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 8 artikuj aktive materiale në vlerën 9,074,339 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 7,343,493 lekë, llog. 210 “Toka, Troje, Terrene” në vlerën 1,730,846 lekë.

Gjithashtu vlera prej 1,761,146 lekë është emërtuar ÷Aktive te trashëguara, të pa inventarizuara (nga viti 1999)÷, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.82.2022 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme÷ i ndryshuar, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 Pika 2. Klasa 2, me Nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik÷ i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 65-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”.

9.2. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të marrë masa për inventarizimin e aktiveve në vlerën 1,761,146 lekë përfshirë në gjendjen e llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione”. Të kryej zërbërthimin e dokumentacionit financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2022

10. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e inventarit kontabël të llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” rezulton se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 19 artikuj aktive materiale në vlerën 48,367,346 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 212 “Ndërtesa Konstruksione” në vlerën 36,403,544 lekë dhe llog. 210 ÷Toka, Troje, Terrene÷ në vlerën 11,963,802 lekë. Gjithashtu vlera prej 29,568,137 lekë është emërtuar ÷Rikonstruksion÷, vlerë e cila nuk është e analizuar dhe nuk dihet se çfarë përfaqëson. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 ÷Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme÷, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 pika 2. Klasa 2, , me Nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik dhe me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 ÷Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik÷ i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 65-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 212 “Ndërtesa dhe Konstruksione ” llog. 210 “Toka, Troje, Terrene”.

10.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në vlerën 29,568,137 lekë përfshirë në gjendjen e llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike të kryejë zërbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet e në inventarin fizik.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2022

11. Gjetje nga auditimi: Nga analiza e inventarit kontabël të llog. 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” rezulton se, në këtë llogari janë kontabilizuar gabim 7 artikuj aktive materiale në vlerën 3,766,818 lekë, që nuk i përkasin klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përkasin klasifikimit kontabël të llog. 218 “*Inventar Ekonomik*”. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 5, datë 21.2.2022 *“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*”, Kreu II pika 5 dhe Kreu III pika 30, Aneksi 1 pika 2. Klasa 2, , me Nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 65-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për saktësimin e gjendjes së llog. 214 “*Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune*” sipas klasifikimit që i përket këtij posti në përputhje me nomenklaturën e llogarive te planit kontabël publik, duke e kredituar për vlerat përkatëse të aktiveve në debi të llog. 218 “*Inventar Ekonomik*”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2022

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjeve të procedurave të prokurimit për vitin 2021, rezulton se:

- Dosjet e procedurave të prokurimit nuk ishin të inventarizuara dhe protokolluara në arkivën e Bashkisë Sarandë.

- Disa procedura prokurimi, projektet/ preventivat janë hartuar nga specialistët e Drejtorisë së Planifikim Zhvillim Territorit, Bashkia Sarandë dhe miratuar nga titullari i Bashkisë Sarandë, por të pa pajisur me licencat e projektuesve me kategoritë përkatëse, konkretisht procedurat:

a- *Procedura me objekt “Sistemim i rrugëve te brendshme me asfaltbetoni Ksamil (rruga e varrezave, parajsa, rr. sherifi “, me fond limit 11,090 mijë lekë*

b- *Procedura me objekt “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltbetoni në rrugën Kristal, Përmeti, Papa, Gjon Pali i II dhe riveshje gropash “, me fond limit 10,976 mijë lekë*

c- *Procedura me objekt “Sistemin i rrugëve të brendshme me asfaltbetoni rruga Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Amantia, Kristoforidhi “, me fond limit 8,560 mijë lekë*

d- *Procedura me objekt “Sistemim i rrugëve me asfaltbetoni (rruga Ismail Qemali Cebej, Adem Jashari “, me fond limit 9,597 mijë lekë*

- Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Sarandë dhe përgjegjësit të Sektorit të Procedurave janë lidhur kontrata për kryerjen e punimeve pa bërë më parë miratimin dhe marrjen e lejes së ndërtimit ose infrastrukturës.

- Janë pranuar në procedura prokurimi, shpallur fitues dhe lidhura kontrata zbatimi me subjekte të cilat nuk janë pajisur me Nipt sekondar për kohën e shtrirjes së kontratës, si dhe janë debitorë karshi Bashkisë Sarandë ndër vite, nga auditimet e kryera nga KLSH për mos zbatim të kontratave të punëve publike sipas preventivit.

Veprime në kundërshtim me Kreu III, neni 5, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit, të ndryshuar; VKM nr. 759, datë 12.11.2014, “Për licencimin profesional të individëve dhe subjekteve juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, e cila ka miratuar Rregulloren “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale për individë dhe subjekte juridike që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim, neni 16 “Licenca ókategoritë e punimeve. Ligji nr. 9154, datë 6/11/2003 “Për Arkivat; neni 4/262021. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4. faqe 82-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandimi: Sektori i Procedurave të Prokurimit Bashkia Sarandë, të marrë masa për inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura për periudhën 01.01.2021 ó 31.12.2021 me gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor.

Brenda datës 31.12.2022

12.2. Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për kryerjen e projekteve nga persona/subjekte të përcaktuar nga ligji, në mënyrë që të kemi projekte sa më cilësore dhe që paraqesin gjendjen reale të objektit.

12.3. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë të mos nënshkruaj kontrata me subjektet sipërmarrëse dhe fituese të procedurave të prokurimit për investime pa marrë më parë lejen e ndërtimit ose infrastrukturës në Sektorin e Planifikim Zhvillim Territorit, si dhe pa u pajisur me Nipt sekondarë dhe pa mundësuar likuidimin e detyrimeve ndaj bashkisë për mos zbatimin e kontratave sipas preventivit.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llog. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” e cila si në mbyllje të vitit 2021 paraqitet me gjendje 0, kur në fakt ka investime kapitali në formë aksionesh tek B... sha. Në këtë llogari duhet të kishte të evidentuar vlerën e kapitalit të derdhur në bazë të % së zotërimit të aksioneve nga Bashkia Sarandë në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Bashkia Sarandë është aksionere me 100% të aksionevetë K... sh.a. NUIS..., e cila është shoqëri aksionere me objekt *Organizimi i aktiviteteve sportive ne fushën e futbollit...*ö, që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e sajë.

Bashkia Sarandë zotëron në K... Sha 2000 aksione me vlerë nominale 1000 lekë/aksioni, me vlerë kapitali 2,000,000 lekë. Për vlerën e kapitalit prej 2,000,000 lekë të derdhur nga Bashkia Sarandë, duhet të ishin kryer veprimet e kontabël në debi të llog. 26 ðPjesëmarrje në kapitalin e vetë në kredi të llog. 1011 ðShtesa të fondit bazëö.

Veprime në kundërshtim me Udhëzimi i MFE nr. 5 datë 21.2.2022 ðPër procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeö Kreu III. ðProcedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshmeö pika 31. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 65-82 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

13.1. Rekomandimi:Drejtoria Ekonomike të marrë masa, që të kryejë veprimet kontabël për pasqyrimin në PF të investimeve kapitale në vlerën 2,000,000 lekë të kryera në vitet e mëparshme, që lidhen me pjesëmarrjet me kapitalin e vet (fondet e veta) në kapitalin e shoqërive aksionere në SH.A ðNUIS..., për vlerën 2000,000 lekë të kapitalit të derdhur për zotërim të 100% të aksioneve të B... sha.

Me mbylljen e pasqyrave financiare viti 2022

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve të KLSH rezulton se:

Nga Bashkia Sarandë është respektuar afati 20 ditor për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve (shkresa nr. 4891/2, datë 19.10.2021).

Nuk është respektuar afati që brenda periudhën 6 mujore, Bashkia Sarandë duhet të informojë mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Nga ana e Kryetarit të Bashkisë Sarandë, **nuk është raportuar në këshillin e njësisë** (këshillin bashkiak), bazuar në ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 ðPër financat e vetëqeverisjes vendoreö, Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimitdhe raporton rregullisht në këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij

Është hartuar *Plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve* në të cilën janë përcaktuar strukturat dhe personat për zbatimin e rekomandimeve me afatekonkrete.

Gjithashtu rezulton se:

a. Janë rekomanduar 16masa organizative, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat janë zbatuar 9 masa, është në proces zbatimi 1 (një) masë dhe nuk janë zbatuar 6 masa.

b. Për shpërblim dëmi janë rekomanduar 5 masa me vlerë 6,748,993 lekë, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, por janë në proces zbatimi pasi janë kontabilizuar.

c. Për masa mos efektivitet dhe efikasitet, janë rekomanduar gjithsej **3 masa** me vlerë **11.236.480 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, duke mbetur pa zbatuar 3 masa me vlerë **6,748,993 lekë**.

d. Për masa mungesë të ardhurash, janë rekomanduar gjithsej **4 masa** me vlerë **495,505,008 lekë**, nga të cilat janë pranuar plotësisht. Nga të pranuarat nuk është zbatuar asnjë masë, duke mbetur pa zbatuar vlera prej **495,505,008 lekë**.

e. Për masa disiplinore, janë rekomanduar gjithsej **6 masa** të cilat janë pranuar dhe zbatuar nga subjekti.

Veprimet dhe mos veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 *ËPër organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit* neni 15, *ËTë drejtat e KLSH*, germa (j). ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 *ËPër financat e vetëqeverisjes vendore*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 101-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë të marrë masa për zbatimin e plotë të rekomandimeve në proces zbatimi ose të pazbatuara, dërguara nga KLSH me shkresën nr. 101/9, datë 01.10.201 *ËPër zbatimin e Rekomandimeve nga auditimi i kryer në Bashkinë Sarandë*, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave përgjegjës për mos zbatimin e tyre, *respektivisht për:*

- **7 masa** organizative, ku 6 prej tyre nuk janë zbatuar.
- **5 masa** shpërblim dëmi me vlerë **6,748,993 lekë**.
- **3 masa** shpenzime në kundërshtim me 3-E për vlerën **6,748,993 lekë**.
- **3 masa** mungesë të ardhurash në shumën **495,505,008 lekë**.

14.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë të marrë masa të menjëhershme për raportimin në Këshillin Bashkiak, të masave dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e KLSH.

Brenda datës 31.10.2022

15. Gjetje nga auditimi: Në institucionin e KLSH, nëpërmjet postës elektronike është paraqitur ankesë nga qytetari L.H., hyrë në KLSH nr. 1067, datë 11.10.2021, në të cilën kërkohet të auditohet procedura e dhënies së autorizimit nga DPZHT Bashkia Sarandë të një rame të vendosur në hyrje të pallatit përpara njësisë tregtare, përfituar sipas Deklaratës Noteriale hartuar nga noteri A.A. me nr. 2038 rep/nr. 524kol, si dhe kontratë sipërmarrje me nr. 2307rep/523kol, datë 14.5.2004 për ndërtimin e një dyqani me sipërfaqe 53 m2 dhe vlerë 63000 mijë dollarë, ku sipas qytetarit përcaktohet tek dyqani do të bëhet parapet i dyqanit dhe shkallët përkatëse në këtë sipërfaqe të shtuar (nuk ka dokument që vërteton hipotekën e dyqanit).

Sipas qytetarit L.H., pretendohet së akti administrativ (Autorizimi nr. 2044/1, datë 31.07.2018) është i paligjshëm dhe absolutisht i pavlefshëm në zbatim të nenit 108 dhe 109 të K.P. Administrative.

Pretendimi i ngritur nga L.H. në lidhje me dhënien e autorizimit nga DPZHT Bashkia Sarandë, për vendosjen e një rame për personat me aftësi të kufizuara, nuk qëndron pasi autorizimi është dhënë në përputhje me nenit 7 të VKM nr. 408, datë 13.5.2015 *ËPër*

miratimin e rregullores së zhvillim territoritë i ndryshuar dhe në zbatim të ligjit nr. 93/2014 datë 24.7.2014 për përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me aftësi të Kufizuar, i ndryshuar, pasi personat që e kanë përfitur atë janë me aftësi të kufizuar.

Gjithashtu referuar Vendim nr. 46 datë 22.11.2021, Gjykata Administrative Gjirokastrë, kërkesë padia e L.H. nuk qëndron, duke e rrëzuar atë.

Ndërsa në lidhje me ankesën e qytetarit T.M., për lirim të verandës si ambient i përbashkët i pallatit ku banojë, çështja është në shqyrtim. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 115-116 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë nëpërmjet Drejtorisë së Planifikimit Zhvillim Territorit të marrë masat dhe të informojë ankimuesin L.H. në lidhje me lëshimin e autorizimit nr. 2044/1 prot, datë 31.7.2018 nga Bashkia Sarandë në adresë të qytetarit T.M. me aftësi të kufizuar, duke bërë sqarimet përkatëse ligjore mbi domosdoshmërinë e këtij autorizimi për personat me aftësi të kufizuar.

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit nën 15 të drejtat dhe detyrat e KLSH-së, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 "Kodi i procedurave administrative në R.SH" nën 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore" nën 21-33 dhe Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pika 93, nga **Kryetari i Bashkisë Sarandë**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit. **Nëpunësi Zbatues** të ndjekë procesin dhe të kryejë regjistrimet e nevojshme kontabël përfundimtare, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **10,317,550 lekë** ndaj **6 personave**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: "Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: "Kristal", "Përmeti", "Papa Gjon Pali i II" dhe riveshje gropash", Bashkia Sarandë, me vlerë kontrate (pa TVSh) 10,814,530 lekë, realizuar nga shoqëria A..., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën **235,200 lekë pa TVSh**, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 5 prot., datë 03.05.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandë dhe shoqëria A... (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 101-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike Bashkia Sarandë, të marrë masa për arkëtimin e vlerës prej **235,200 lekë** pa TVSh nga shoqëria A..., në cilësinë e sipërmarrjes në kontratën nr. 5 prot, datë 03.05.2021 me objekt: "Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: "Kristal", "Përmeti", "Papa Gjon Pali i II" dhe riveshje gropash, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 31.10.2022

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: "Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: "Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. "Ismail Qemali" "Çabej", "Adem Jashari", me vlerë kontrate (pa TVSh) 9,392,610 lekë, realizuar nga shoqëria 2..., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 317,148 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 6 prot, datë 03.05.2021 të lidhur mes Autoritetit

Kontraktor Bashkia Sarandës dhe shoqërisë 2...(Më hollësisht trajtuar pikën 2.4.4 faqe 101-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **317,148lekë** pa TVSh nga shoqëria 2..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 5 prot datë 03.05.2021 me objekt: *“Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rrugët: “Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. “Ismail Qemali” “Çabej”, “Adem Jashariö, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.*

Brenda datës 31.10.2022

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *“Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. Gjergj Fishta, Naim Frashëri, Amantia, Kristoforidhi”, me vlerë të kontratës (pa TVSh)8,530,800 lekë, realizuar nga shoqëria M..., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 77,400 lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7 prot., datë 26.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandës dhe shoqëria M...(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 101-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **77,400lekë** pa TVSh nga shoqëria M..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7 prot., datë 26.04.2024 me objekt: *“Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltobeton Rr. Gjergj Fishta , Naim Frashëri, Amantia, Kristoforidhi”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.*

Brenda datës 31.10.2022

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt: *“Sistemimi i bllokut të banesave në lagjen e Lugut të Dardhës”, me vlerë të kontratës (pa TVSh)4,098,081 lekë, realizuar nga shoqëria I..., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 125,400lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 8 prot., datë 30.04.2021 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandës dhe shoqërinë I...(Më hollësisht trajtuar pikën 2.4.4 faqe 101-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **125,400lekë** pa TVSh nga shoqëria I..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 8 prot., datë 30.04.2024 me objekt: *“Sistemimi i bllokut të banesave në lagjen e Lugut të Dardhës”, vlerë kjo e cila përfaqëson një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si rrjedhojë e situacionimit të punimeve të pakryera.*

Brenda datës 31.10.2022

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të shërbimit të kontratës me objekt: *“Pastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Sarandë”, me vlerë të kontratës (pa TVSh)48,466,088lekë, realizuar nga shoqëria A..., rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 4,363,338.20lekë pa TVSh, veprime në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së shërbimit nr. 25 prot., datë 01.12.2020 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Sarandës dhe shoqërisë A...(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.4 faqe 101-114 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Nga Bashkia Sarandës të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **4,363,338 lekë pa TVSh** nga OE A..., në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën së shërbimit me nr. 25 prot., datë 01.12.2020, me objekt: *“Pastrimi dhe largimi i mbetjeve urbane të Qytetit Sarandëö, Bashkia Sarandë,që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.*

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes teknike dhe pagesave të kryera me bankë në lidhje me procedurën me objekt: “Përfundim rrjeti kryesor K.U.Z Sarandë”, rezulton se nga sipërmarrësi i punimeve shoqëria E... me të cilën është lidhur kontratë nr. 9, datë 6.3.2021, është paraqitur për likuidim fatura nr. 5/2022, datë 28.2.2022.

Nga të dhënat e situacionit përfundimtar, vlerë e cila nuk është likuiduar pasi shoqëria nuk ka mbyllur punimet sipas kushteve të kontratës dhe nuk ka aktkolaudim.

Sipas të dhënave të njësisë së procedurave (*sektori i zbatimit të kontratave*), nga shoqëria nuk është paraqitur shkresë për përfundimin e punimeve sipas afatit të përcaktuar në kontratë, si dhe nuk ka shtesë afat punimesh.

Referuar të dhënave të situacionit përfundimtar që disponon Drejtoria Ekonomike Bashkia Sarandë, punimet kanë përfunduar me datë 28.2.2022 ose 257 dite vonesë nga afati i kontratës, nisur nga data e faturës së paraqitur për likuidim.

Nga Bashkia Sarandë (*personat përgjegjës*) nuk është mundësuar llogaritja e kamatëvonesave në masën 4/1000 për çdo ditë vonesë por jo më pak se 25%, në zbatim të nenit 27 të kontratës, në vlerën **4,950,064 lekë** (19,800,158 x 25%), veprime financiare me efekt negativ në buxhetin e Bashkisë Sarandë për të cilën ngarkohet me përgjegjësi shoqëria E... si përgjegjëse për mos përfundim të punimeve dhe shtyrjen e afatit të dorëzimit të punimeve.

Gjithashtu nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosjen teknike rezulton se për makineritë dhe pajisjet është llogaritur TVSh-ja kreditore (e zbritshme), duke i konsideruar punime ndërtimi punimet e furnizimit të pajisjeve.

Ky format i miratuar nga Këshilli i Ministrave me udhëzimin përkatës parashikon emërtimin e zërave të punimeve, sasi, çmim, vlerë si dhe shuma e tyre, duke i shtuar TVSh-në, pastaj kësaj shume i shtohen vetëm pajisjet.

Pra nuk ka më TVSh për pajisjet, pasi si rubrikë për efekt të llogaritjes së kostos janë zë më vete, duke u përfshirë mbrapa TVSh-së.

Si pasojë e përfshirjes në situacion të TVSh ó së janë likuiduar tepër në vlerën **249,000 lekë**.

Si përfundim, janë likuiduar tepër sipërmarrësit të punimeve në vlerën 249,000 lekë si rrjedhojë e përfshirjes së TVSh së pajisjeve në situacionin e punimeve, vlerë kjo e cila përbën një dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Referuar zërave të preventivit të hartuar nga ing. K. K., konstatohet se në numrin 18 të saj, thuhet se: “Furnizim/vendosje, Panel komandimi soft-staert 45 kW për lëshimin e tre pompave 38 kë secila dhe komandimi automatik të gjeneratorit 144 kë (demontim i panelit të vjetër, transport në magazinë).

Nga të dhënat e marra nga magazina Bashkia Sarandë dhe informacionit të marrë në Ndërmarrjen e Ujësjiellës Kanalizime SHA Sarandë, rezulton se nga shoqëria E.....**nuk është bërë hyrje pjesa e vjetër e panelit e cila është zëvendësuar.**

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën nr. 9, datë 6.3.2021 të lidhur midis Bashkisë Sarandë dhe shoqërisë E...;

i) UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për Klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”, Kreu I/I “Klasifikimi i punimeve të ndërtimit”, germa òAö, paragrafi i fundit, pasi të gjitha rastet përjashtohen pajisjet dhe aparaturat në përfshirjen e punimeve të ndërtimit.

ii) VKM nr. 514, datë 15/8/2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, ndryshuar me VKM nr. 664, datë 26/9/2012, pika 8.

iii) UKM Nr. 1, datë 16.6.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin NR. 3, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, të ndryshuar, pika 1, germa òcö, paragrafi i fundit.

Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 *“Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publikë, i ndryshuar, për nenet 34-41. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 82-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandimi: Drejtoria Ekonomike në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Kontratave, të marrin pasha për:

a. Llogaritjen, kontabilizimin dhe arkëtimin e vlerës së kamatëvonesës për mos përfundim në afat të punimeve në objektin *“Përfundim rrjeti kryesor K.U.Z Sarandë”*, për vlerën **4,950,064 lekë** nga shoqëria E....., duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

b. Arkëtimin e vlerës së TVSh kreditorë të pajisjeve prej **249,000 lekë**, zbritur padrejtësisht në vlerën e situacionit përfundimtar nga subjekti E....., duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët.

c. Mos kryerjen e pagesave të asnjë vlerë të situacioneve pa bërë dorëzimin e mallit sipas preventivit zërit18, ku thuhet se: *“Furnizim/vendosje, Panel komandimi soft-staert 45 kW për lëshimin e tre pompave 38 kW secila dhe komandimi automatik të gjeneratorit 144 kW (demontim i panelit të vjetër, transport në magazinë), nga shoqëriaE....*

Brenda datës 31.10.2022

D. MASA PËR ELEMIMININ E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat e regjistrit të procedurave të prokurimit, rezulton se për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2021, rezulton se janë zhvilluar gjithsej 19 procedura me fond limit 433,430 mijë lekë dhe vlerë kontratë të lidhur 427,638 mijë lekë, me një ulje nga fondi limit prej 1.3%.

Nga auditimi i 10 procedurave të prokurimit të vlerësuara për auditim me fond limit 401,045 mijë lekë ose 92.5% e fondit total dhe në përfundim të punës audituese në terren dhe pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit mbi gjetjet e konstatuara, kanë rezultuar në shkelje të akteve ligjore e nënligjore të LPP, si më poshtë:

a. Në **6 procedura prokurimi**, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me dispozitat e LPP dhe llojin e procedurës, veprime të cilat direkt ose indirekt kanë kufizuar pjesëmarrjen e OE në procedurë.

b. Në **5 procedura prokurimi**, OE/BOE të shpallur fitues nuk janë në kushtet e plotësimit të kriterëve të DST të miratuara nga AK, pasi ka kriteret e cilat nuk janë plotësuar dhe nga KVO janë vlerësuar si të rregullt. Në këto kushte KVO duhet të anulonte procedurën dhe zhvillonte procedurën tjetër me kushte më të favorshme, kjo me qëllim përdorimin me efektivitet, eficientë dhe economicitet të fondit të prokuruar në vlerën **362,987 mijë lekë**.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim më ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, *“Për prokurimin publikë, neni 3, “Parimet e përzgjedhjeje”, nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 “Autoriteti ose enti kontraktor”, neni 98, “Anulimi i një procedure”, neni 76, “Kriteret detyruese për skualifikim”, neni 92, “Shqyrtimi i ofertave”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publikë, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 82-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë, për çdo rast të procedurave të zhvilluara të ngrejë grup pune me specialistë të fushës (sipas llojit të procedurës), për hartimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve në përputhje me objektin e kontratës, me synim rritjen e numrit të operatorëve pjesëmarrës në procedurë, duke eliminuar praktikën e zhvillimit të procedurave me një OE.

Të bëhet argumentimi teknik për secilin kriter, duke u mbështetur në preventivin e punimeve, volumin dhe afatin e punimeve dhe dokumentacioni i argumentimit të kriterëve të bëhet pjesë e dosjes së prokurimit.

1.2. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë, nëpërmjet strukturave përkatëse, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave kualifikuese në kushtet e mosplotësimit të kriterëve të përcaktuara në DST, veprime të cilat çojnë në përdorimin e fondeve pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomikitet.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi llogaritjen e fondit limit të procedurës me objekt “*Sistemim i rrugëve të brendshme me asfaltbetoni Ksamil (rruga e varrezave, parajsja, rr. sherifi*” me fond limit 322,288,648 lekë pa TVSh, rezulton se: Projektpreventivi është hartuar nga subjekti I...sh.p.k.

Disa nga zërat e preventivit të paraqitur nga subjekti duke i krahasuar me zërat e manualit të çmimeve sipas VKM nr. 629, dt. 15.07.2015 i ndryshuar, çmimet e aplikuara nuk janë të njëjta, duke rënduar padrejtësisht fondit limit për vlerën 2,509,080 lekë, sipas tabelës në faqen 95-96 e Raport Auditimit.

Për sa mësipërm fondi limit për objektin *“Furnizimi me ujë i zonës Baba Rrexhepi dhe lugu i Dardhës. Faza e II (Loti Përfundimtar)”*, referuar manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre, të rishikuara, sipas tabelave që i bashkëlidhen VKM nr. 629, dt. 15.07.2015 i ndryshuar, është rënduar më shumë për vlerën **2,509,080 lekë pa TVSh**, veprime në kundërshtim me VKM nr. 629, dt. 15.07.2015 *“Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të ...”* i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 82-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Sarandë në rastet e hartimit të projekt/preventivave për investime publike nga subjekte të licencuar, të ngrejë grup pune me specialist të fushës për verifikimin e zërave të preventivit referuar çmimeve të manualit, me qëllim arritjen e objektivave të kontratave të prokuruar, si dhe shmangien e efekteve negative në fondet publike.

Në vijimësi

E. MASA PËR ULJEN E BORXHIT TATIMOR DHE RITJEN E PERFORMANCËS NË ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TAKSAT DHE TARIFAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA (TË ARDHURA TË MUNGUARA).

1. Gjetje nga auditimi: Referuar Vendimeve të KB për paketën fiskale të vitit 2021, rezulton se taksa e ndërtesës për një pjesë të konsiderueshme të familjeve aplikohet në mungesë të dokumentacionit ligjor (*genplani për sipërfaqet ose të dhënave nga ASHK*), duke përdorur tarifë fikse 70 -100 m², mbi të cilën janë aplikuar taksa e pasurisë për ndërtesën. Kjo mënyrë e aplikimit e taksës së ndërtesës për abonentët familjarë nuk është e saktë dhe proporcionale, pasi favorizon disa dhe penalizon disa të tjerë, ku pas viteve 90 ka shumë ndërtime pa leje dhe me sipërfaqe mbi 100 m² dhe nuk janë identifikuar ato, duke bërë që ndaj këtyre subjekteve të mos aplikohet saktë taksa e ndërtesës.

Gjithashtu nuk ka një bashkëpunim midis vetë sektorëve të bashkisë dhe jo vetëm, ku mungon informacioni i marrë nga Drejtoria e PZHT për lejet e ndërtimit dhe përdorimit të lëshuar nga kjo strukturë për sipërfaqet e objekteve dhe sipërfaqet e truallit, si dhe të dhënave të dërguara nga ASHK Dega Rajonale Sarandë mbi sipërfaqet e objekteve të legalizuara pa leje ndërtimi. Referuar të dhënave të marrë nga Drejtoria e PZHT për lejet e ndërtimit/përdorimit të lëshuara nga kjo strukturë, konstatohet se për 3 leje taksa e pasurisë (taksa ndërtesë), nuk është llogaritur e saktë për sipërfaqen që ato disponojnë, duke evidentuar një të ardhur të munguar.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me nenin 20, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *ËPër Taksat vendore* i ndryshuar dhe neni 4 i VKM nr. 132, datë 07.03.2018 *ËPër metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa", e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës*. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 43-65 të Raportit *Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Drejtorja e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë të gjitha masat për një bashkëpunim më të mirë me Drejtorinë e PZHT Bashkia Sarandë dhe ASHK Dega Rajonale Sarandë, për sigurimin e të dhënave të nevojshme me dokumentacion ligjorë për sipërfaqet e ndërtimit të objekteve, kjo për një taksim sa më real të taksës së pasurisë (ndërtesës).

Në vijimësi

1.2. Rekomandimi: Drejtorja e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës prej **285,062 lekë**, të taksës së ndërtesës nga **3** investitorë, *respektivisht:*

- **vlera 134,064 lekë** nga investitori **E.O.**
- **vlera 40,320 lekë** nga investitori **D.D.**
- **vlera 110,678 lekë** nga investitori **G.A.**

Brenda datës 31.10.2022

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi, u konstatua se për tarifën e parkimit, nga administrata e Bashkisë Sarandë nuk është lidhur asnjë kontratë, ndërkohë që rrugët kudo janë të mbushura me tabela treguese për parkime të rezervuara dhe me vijëzimet përkatëse.

Krahas kësaj, vendosja e tabelave për parkime të rezervuara, pa arkëtuar pagesat përkatëse dhe pa lidhur kontrata përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Sarandë, evazion fiskal. Pavarësisht se në disa raste thuhet se ndërpritet kontrata për rezervimin e parkimit, tabelat vazhdojnë të qëndrojnë, si për bizneset, familjarët, autobuzat, taksitë, etj., pavarësisht se në paketat fiskale të çdo viti janë parashikuar tarifa parkimi për të gjitha kategoritë e mjeteve.

Edhe në rastet kur subjektet nuk kanë bërë pagesën, nga ana e bashkisë duhet të ishin marrë masat përkatëse sipas akteve ligjore e nënligjore për detyrimet kontraktuale. Ndërkohë që Bashkia ka shpenzuar duke bërë vijëzimet dhe duke vendosur tabelat përkatëse, të cilat nuk janë hequr edhe pas përfundimit të kontratës (*sipas pasqyra faqe 54-55 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Nga të dhënat e tabelës, konstatohet se DTTV Bashkia Sarandë menaxhon 28 subjekte me parkim me pagesë për vlerën 1,120,000 lekë, nga e cila likuiduar vlera 640,000 lekë dhe nuk është likuiduar vlera **prej 480,000 lekë**, e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.

Gjithashtu konstatohet se për një numër vend parkimesh, bashkia nuk kishte informacion dhe nuk ishin taksuar për vendet që ato shfrytëzonin dhe për të cilat kanë dhe të vendosur në tabelën.

Nga tabela, shihet për 18 vend parkime nuk është paguar vlera e taksës prej **720,000 lekë**, si ardhur e munguar në buxhet për tabelat dhe vijëzimet që vazhdojnë të qëndrojnë në rrugët e qytetit të Sarandës, përbën të ardhur të munguar për buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Personat përgjegjës janë: **G.D.** me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike bashkia Sarandë dhe Inspektori i Zyrës së Shërbimeve për transportin **TH.K.**

Veprime në kundërshtim me ligji nr. 8450, datë 24.2.1999, *ËPër përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre* dhe aktet nënligjore në zbatim të tij; Ligji Nr. 9920, dt. 19.5.2008, *ËPër Procedurat Tatimore*; VKM nr. 170, dt. 25.04.2002, nr. 344, dt. 19.4.2017 dhe nr. 970, dt. 02.12.2015 *ËPër Liçencat e tregimit të Hidrokarbureve*;

UMF nr. 26, Dt. 04.09.2008 dhe nr. 12, dt. 4.4.2017, *ËPër Taksat Kombëtare*, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Nga administrata e Bashkisë Sarandë duhet të verifikohen të gjitha tabelat dhe vijëzimet për parkimet e rezervuara, të cilat mbahen në mënyrë abuzive dhe të ndiqen procedurat përkatëse ligjore, sipas rastit. Për personat të cilët i kanë tabelat dhe vijëzimet dhe nuk kanë bërë kërkesa për ndërprerjen e kontratës me bashkinë, të bëhet menjëherë faturimi i vlerës totale të debisë, për të gjithë periudhën e përdorimit të tabelave.

2.2. Rekomandimi: Bashkia Sarandë të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **720,000 lekë të 18 vend parkime** të cilëve nuk ju është maturuara detyrimi, pavarësisht faktit se ato i shfrytëzojnë vend parkime e rezervuara, *konkretisht:* subjekti N... për një vend parkime me vlerë **40,000 lekë**, subjekti A... për një vend parkime **40,000 lekë**, subjekti A... për një vend parkime **40,000 lekë**, subjekti S... për një vend parkime **40,000 lekë**, subjekti A... për dy vend parkime **80,000 lekë**, subjekti B... për një vend parkime **40,000 lekë**, subjekti C... për një vend parkime **40,000 lekë**, subjekti E... për një vend parkime **40,000 lekë**, subjekti F... për një vend parkime **40,000 lekë**, subjekti I... për një vend parkime **40,000 lekë**, subjekti K... për një vend parkime **40,000 lekë**, subjekti L... për një vendparkime **40,000 lekë**, subjekti R... për një vend parkime **40,000 lekë** dhe subjekti V... për katër vend parkime **160,000 lekë**

2.3. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **480,000 lekë nga 12 subjekte**, sipas tabelës faqe 53 të Raport Auditimit.

Brenda datës 31.10.2022

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i tarifave vendore për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, u konstatua se ka mangësi në plotësimin e të dhënave të këtyre subjekteve në përgjithësi dhe debitorëve në veçanti, si p.sh., në krijimin e një regjistri të posaçëm për këto lloj subjektësh, në evidentimin e subjekteve që vërtet e ushtrojnë këtë lloj aktiviteti (sepse pavarësisht se mund ta kenë si objekt të aktivitetit të tyre, nuk e ushtrojnë këtë aktivitet ose anasjelltas) dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi.

Kështu, nga verifikimi në faqen e internetit të QKB-së, u konstatua se në Bashkinë Sarandë, figurojnë rreth **40 subjekte** (NUIS-e sekondare, përfshirë autobotet) të cilët kanë si objekt të aktivitetit të tyre tregtinë me pakicë të karburanteve, gazit natyror, lëndëve djegëse për popullatën, etj.

Gjithashtu, nga auditimi i kësaj kategorie të bizneseve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nuk është aplikuar autorizim për tregtim karburanti.

Të gjitha subjekteve që ju ka mbaruar afati 5 vjeçar i autorizimit pas datës të hyrjes në fuqi të VKM-së nr. 970, datë 2.12.2015, për rinovimin e licencës duhet të paguajnë si më sipër.

Të dhënat për detyrimet për taksën e licencës për pikat e tregtimit me pakicë të karburanteve dhe njësitë të shitjes së lëndëve djegëse dhe bombolave të gazit për taksat dhe tarifat vendore janë paraqitur në tabelën faqe 5-56 të Raport Auditimit.

Nga sa mësipërm vlera 17,600,000 lekë, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Veprime në kundërshtim me VKM-në Nr. 344, datë 19.04.2017, e cila ka ndryshuar VKM-në Nr. 970, datë 2.12.2015, parashikohet se: 09. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 lekë për bashkitë e tjera. 010. Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë,

është 500,000 lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 lekë për bashkitë e tjera.ö (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi:Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve Publike dhe Policinë Bashkiake Bashkia Sarandë, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **17,600,000 lekë**(sipas tabelës në faqen 56-57 të Raport Auditimit), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit.

Gjithashtu, të verifikojë nëse edhe subjektet e tjera të cilat në QKB figurojnë aktivë dhe me objekt aktiviteti tregtinë e karburanteve apo lëndëve djegëse për popullatën, e zhvillojnë këtë lloj aktiviteti dhe të liqenohen apo të pezullohen, sipas rastit.

3.2.. Rekomandimi:Në rastet kur këto subjekte nuk paraqiten për licencim apo për arkëtimin e plotë të tarifës së licencë/autorizimit në bashkëpunim me Inspektoriatin Shtetëror Teknik të ndërmerren veprime administrative e ligjore deri në mbylljen e aktivitetit të këtyre subjekteve.

Brenda datës 31.10.2022

4. Gjetje nga auditim: Nga auditimi i dokumentacionit të kontratave të qirave për asetet, që Bashkia Sarandë ka me subjekte të ndryshme, rezulton se janë lidhur gjithsej 39 kontrata qiraje për objekte dhe truall me pretendimin se janë në pronësi të saj për një vlerë qiraje vjetore prej 4,864,860 lekë, nga e cila janë likuiduar për vitin 2021 vlera 3,642,560 lekë, duke mbetur për likuidim **vlera 1,222,300 lekë**

Për asetet e dhëna me qera nga Bashkia, nga auditimi u konstatua se për asnjë rast nuk është bërë përditësimi i sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në AKSH (nëse ka) apo në listat e transferimit të pasurive nga KM. Kjo nuk është pasqyruar në inventarin e pasurive të paluajtshme dhe i ka hapur rrugë informalitetit. Gjithashtu, deri në periudhën objekt auditimi, asnjë nga objektet e dhëna me qera nuk figuron i regjistruar në AKSH, pra në asnjë rast Bashkia Sarandë nuk rezulton të disponojë Titull (Çertifikatë) Pronësie për objektet e kontraktuara. Nga sa më sipër, rezulton se ligjërisht, Bashkia ka lidhur kontrata për objekte që nuk janë të vetat.

Referuar kushteve të kontratës (neni 7 i tyre), të gjithë personat të cilat nuk ka likuiduar në afat detyrimin mbi kontratën e qirasë duhet të paralizohen në masën 0.5% për çdo ditë vonesë, **pra në vlerën 2,945,743 lekë** (1,222,300 lekë x 0.5% x 482 ditë vonesë), **e ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Sarandë** (të dhënat sipas aneks 1), veprime në kundërshtim me nenin 7 të kontratës së qirave të subjekteve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4.1. Rekomandimi:Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për të kontabilizuar detyrimin dhe të kërkojë në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **1,222,300 lekë** të kontratave të pa likuiduara.

Gjithashtu për të gjithë subjektet që nuk kanë likuiduar në afat detyrimin e qirasë sipas kushteve të kontratës të llogariten penalitetet (kamatëvonesat) në shumën **2,945,743 lekë**, dhe të arkëtohen vlera e detyrimit. Në rast mos pagese të detyrimeve të qirasë, Bashkia Sarandë të kërkojë prishjen e kontratës për moszbatim të kushteve të saj.

Brenda datës 31.10.2022

4.2. Rekomandimi:Bashkia Sarandë të marrë masa për të bërë përditësimin e sipërfaqes faktike në dispozicion dhe asaj të regjistruar në ASHK Dega Sarandë (nëse ka) apo në listat e transferimit të pasurive nga KM, fillimisht për asetet e dhëna me qera dhe më pas me të gjitha asetet e saj. Këto të pasqyrohen në inventarin e pasurive të paluajtshme për të mos i hapur rrugë informalitetit. Të verifikojë gjendjen juridike të pronave të saj dhe të ndërpresë të gjitha ato kontrata për asete të cilat nuk i ka ligjërisht në pronësi.

Menjëherë dhe në vijimësi

5. Gjetje nga auditim: Nga auditimi i dokumentacionit, rezulton se në territorin e Bashkisë Sarandë ushtrojnë aktivitet 3 subjekte për shfrytëzim karriere (gurore) në sipërfaqet pyjore/kullosore, pjesë e territorit të kësaj njësie vendore, kaluar me VKM nr. 684, datë 2.9.2020 òPër disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 433, parcelat 4,17 dhe 18. Nga grupi i KLSH u kërkua informacion në lidhje me këto subjekte, por që nuk disponohej asnjë e dhënë. Grupi i KLSH në zbatim të nenit 15 dhe 26, të ligjit 154/20214 òPër Organizimin dhe Funksionimin e KLSHò, me shkresën prot Bashkia Sarandë nr. 1804, datë 28.4.2022, ju kërkua Kryetarit të Bashkisë Sarandë ngritjen e një grupi pune mbi verifikimin në terren të këtyre subjekte.

Me datë 15.5.2019 nga M.L. me detyrë specialist i menaxhimit te pyjeve dhe kullotave, konfirmon se:

Në zbatim të urdhrat të Kryetarit të Bashkisë nr. 78, datë 29.4.2022 është ngritur grupi i punës për verifikimin e problemit, nga ku rezulton se në territorin e Bashkisë Sarandë ushtrojnë aktivitet shfrytëzim gurore 3 subjekte, konkretisht: A..., I...sh.p.k dhe P...sh.p.k.

Me shkresat nr. 1893/1,2,3 datë 4.5.2022 i është kërkuar informacion subjekteve në lidhje me detyrimet për shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore, duke konkluduar se:

1. Shoqëria A... me Nipt ...ushtron aktivitet në parcelën kullosore 18 me emërtimin (Gurrës Vollder), me sipërfaqe 69.71 ha me leje minerale nr. 59, datë 24.4.2012 për periudhën 3.9.2012 deri më 3.7.2022 me sipërfaqe shfrytëzimi 0.5 km = 5 ha, deri në fund të lejes.

Subjekti ka kontratë me Bashkinë Himarë për një periudhë 4 vjeçare e cila fillon me datë 23.5.2018 dhe mbaron me datë 22.5.2022 për tarifën **148,500 lekë/viti**.

Referuar dispozitave të VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 òPër disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM òPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò (tabela 6), konstatohet se kontrata e qirasë për shfrytëzim të sipërfaqeve është llogaritur në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, tabela 6, pasi për sipërfaqen në shfrytëzim detyrimi i qirasë vjetore do duhej të ishte në vlerën **2,475,000 lekë** (5 ha x 495,000 lekë/ha/viti x 4 vite).

Pra për kontratën 4 vjeçare shoqëria ka paguar 148,500 lekë x 4 vite = 594,000 lekë ose më pak se vlera reale për shumën **1,881,000 lekë** (2,475,000 – 594,000), **e ardhur e munguar**.

Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Sarandë në zbatim të VKM nr. 684, datë 2.9.2020 duhet të kishte kërkuar në Bashkinë Himarë dosjen e subjektit dhe arkëtimin e detyrimit që nga datë 2.9.2020, gjë e cila nuk ka ndodhur dhe reflektimin e ndryshimeve për kontratën e qirasë.

2. Shoqëria P...sh.p.k me Nipt ...ushtron aktivitet në parcelën 17 me emërtesë (Vollder) me sipërfaqe totale 37.02 ha.

Shoqëria është pajisur me leje minerale nr. 661/1, datë 19.12.2012 për sipërfaqen e shfrytëzueshme prej 0.107 km = 10.7 ha. Sipas të dhënave kjo shoqëria nuk ka kontratë qiraje as me Bashkinë Himarë dhe as me Bashkinë Sarandë. Nga shoqëria janë depozituar dy vendime gjyqësore (nr. 405, datë 20.3.2002 dhe nr. 4, datë 7.2.2020), për njohjen e pronësisë, por që nuk janë përkthyer në certifikatë pronësie.

Nga sa trajtohet shoqëria ka shfrytëzuar pasurinë shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë.

Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 òPër disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveò (tabela 6), detyrimi i pa kontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **5,778,000 lekë** (540,000 lekë/ha/vit x 10.7), **e ardhura munguar në buxhet**. Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që shoqëria ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2021.

3. Shoqëria I...sh.p.k me Nipt... ushtron aktivitet në parcelën 4 me emërtesë (Cerek Uaturica) me sipërfaqe totale 92.08 ha.

Shoqëria është pajisur me leje minerale për sipërfaqen e shfrytëzueshme prej 0.186 km = 18.6 ha për periudhën 26.12.1995 ó 29.12.2017. Sipas të dhënave kjo shoqëria nuk ka kontratë qiraje as me Bashkinë Himarë dhe as me Bashkinë Sarandë.

Shoqëria disponon certifikatë pronësie me nr. 1/269 për sipërfaqen 3.5 ha, duke mbetur sipërfaqe shtet 15.1 ha, për të cilën duhej kontratë qiraje.

Nga sa trajtohet shoqëria ka shfrytëzuar pasuri shtetërore pa kontratë qiraje dhe pa likuiduar asnjë vlerë.

Referuar VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 *õPër disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveõ (tabela 6), detyrimi i pakontraktuar për sipërfaqen e shfrytëzueshme që përkthen në mungesë të ardhurash në buxhet për periudhën e zbatimit të lejes minerale, nëse kontratat do ishin 1 vjeçar është në vlerën **8,154,000 lekë (540,000 lekë/ha/vit x 15.1), e ardhura munguar në buxhet.** Kjo vlerë varjon në raport me sipërfaqen që shoqëria ka shfrytëzuar nga momenti i marrjes së lejes deri në fund të vitit 2021.*

Nga sa trajtuam më sipër, Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Sarandë duhet të vijojë me procedurat për menaxhimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore në shfrytëzim nga subjektet e mësipërme, ku për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi të sipërfaqeve Pyjore dhe kullosore dhe nuk janë lidhur kontrata, duhet të bëhet pezullimi i veprimtarisë së shfrytëzimit të sipërfaqeve Pyjore dhe Kullosore, deri në momentin e çregjistrimit nga fondi pyjorë kullosor për saktësimin e pronarit të pronës.

Nëse pas daljes së VKM për destinacionin se kush është pronarë i ligjshëm i sipërfaqes për të cilën është lëshuar leja minerale dhe nëse ajo është në juridiksion të Bashkisë Sarandë, të lidhen kontratat e qirasë.

Veprime në kundërshtim me VKM nr. 1064, datë 22.12.2010 *õPër disa ndryshime në vendimin nr. 391, datë 21.6.2006 të KM õPër përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotaveõ nenin 24, të ligjit nr. 10304, datë 15.07.2010 õPër sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisëõ, me nenin 17, të ligjit nr. 9385, datë 04.05.2005, õPër pyjet dhe shërbimin pyjorë, të ndryshuar, me pikën 6, neni 17, të ligjit nr. 9693, datë 19.03.2007, õPër Fondin Kullosorë, me pikat 3, 7, 9, 10, 11 dhe 12, të VKM nr. 1353, datë 10.10.2008, õPër rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjorë, ndryshuar me VKM nr. 435, datë 08.06.2016, si dhe pikat 3, 6, 7, 9 dhe 11, të VKM nr. 1354, datë 10.10. 2008, õPër rregullat dhe procedurat që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosorë i ndryshuar me VKM nr. 434, datë 08.06.2016. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1. Rekomandimi: Drejtoria e Bujqësisë, Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, Bashkia Sarandë, të marrë masa për:

- Tërheqjen e dokumentacionit të subjektit A...sh.p.k, me kontratë qiraje me Bashkinë Himarë, por që janë kaluar në juridiksion të Bashkisë Sarandë, si dhe të bëhet rillogaritja e detyrimit për kontratën e qirasë të llogaritur në kundërshtim me dispozitat ligjore, duke krijuar një të ardhur të munguar në vlerën **1,881,000 lekë**, kjo për shoqërinë A...sh.p.k.

Për sipërfaqet e mbyllura të kërkohet nga subjekti zbatimi i raportit teknik për ripyllëzim e zonës së shfrytëzueshme.

- Subjektet P...sh.p.k dhe I...sh.p.k, të cilët nuk kanë kontratë as me Bashkinë Himarë dhe as me Bashkinë Sarandë, por kanë vijuar me shfrytëzimin e sipërfaqeve pyjore/kullosore pronë e Bashkisë Sarandë, të bëhet bllokimi i aktivitetit deri në marrjen e vendimit nga Ministria e linjës për sipërfaqet nën 1 ha ose nga KM për sipërfaqet mbi 1 ha, mbi pronësinë e sipërfaqes që do shfrytëzohet nga subjektet.

- Për sipërfaqen rrugë kalimi dhe vendepozitim që subjektet shfrytëzojnë deri në sipërfaqen e miratuar sipas lejes minerale, të bëhet saktësimi dhe përlllogaritjen e detyrimeve për qiranë nga Bashkia Sarandë.

- Për sipërfaqet e shfrytëzueshme nga shoqëritë P...sh.p.k dhe I...sh.p.k pa kontratë qiraje deri më 31.12.2021, të kërkohet detyrimi në vlerën **13,932,000** lekë për sipërfaqen e shfrytëzuar në vite, nga e cila: për shoqërinë P...sh.p.k në vlerën 5,778,000 lekë dhe shoqërinë I...sh.p.k në vlerën 8,154,000 lekë, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore, si dhe ripyllëzimi i sipërfaqeve sipas raportit teknik të miratuar me marrjen e lejes minerale.

Menjëherë dhe në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të prokurimit me vlerë të lartë dhe të vogël, konstatohet se janë lidhur kontrata për blerje mallrash dhe investime me subjekte të cilat nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të Bashkisë Sarandë.

Sipas të dhënave mbi aplikimin e detyrimeve për vitin nga DTV Bashkia Sarandë, konstatohet se për këto subjekte nuk është kërkuar pajisje me Nipt sekondarë për periudhën e zbatimit të kontratës, si dhe nuk është bërë maturimi i detyrimeve për taksa/tarifa vendore në masën 95,000 lekë, siç është përcaktuar në VKB-në nr. 167, datë 27.11.2020 *Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021*ö.

Gjithsej evidentohet një detyrimi i patakshuar në vlerën **1,650,000** lekë, kjo për 20 subjekte, si e ardhur e munguar, sipas tabelës faqe 60-21 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Gjithashtu nga auditimi mbi procedurën e njoftimit të subjekteve tatimpagues të detyrimeve vjetore për taksa e tarifa vendore, u konstatua se DTV Bashkia Sarandë nuk vepronte në përputhje me dispozitat ligjore, pasi pas nxjerrjes së njoftim detyrimit, po nga administrata e DTV Bashkia Sarandë me kërkesë të subjektit nxirrej një mandat pagesë për një shumë të caktuar, e cila nuk është sa shuma e njoftim detyrimit por më e vogël.

Kjo lloj procedure e ndjekur është e kundërligjshme ose një marrëveshje për pagesë me këste e pa ligjësuar, veprime të cilat çojnë në mos arkëtimin e detyrimeve vjetor dhe rritjen e nivelit të borxhit në fund të periudhave ushtrimore, ku për këtë njësi vendore është shumë e lartë prej 430 milionë lekë.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, *ËPër Procedurat Tatimore*ö, i ndryshuar, nenin 22 i ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 *ËPër Qendër Kombëtare të Regjistrimit*ö (QKB), i ndryshuar; nenin 15 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 *ËPër Sistemin e Taksave vendore*ö, i ndryshuar, VKB-në nr. 167, datë 27.11.2020 *Për miratimin e paketës fiskale të vitit 2021*ö. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit Bashkia Sarandë, të bashkërendojnë punën për evidentimin e subjekteve fizik/juridik që nuk janë të regjistruara në regjistrin tregtarë të kësaj njësie vendore, për pajisjen me Nipt (Nius) sekondarë dhe maturimin e detyrimeve për taksa e tarifa vendore.

6.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të eliminojë praktikën e nxjerrjes së mandat pagesave pjesore të detyrimeve, pasi subjektet të jenë pajisur me njoftim detyrimi vjetorë ku të ngarkohet dhe për detyrimin e prapambetur.

Në vijimësi

6.3. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e detyrimit të pa matuaruar në vlerën **1,650,000** lekë ndajë **20 subjekteve**, sipas tabelës faqe 62-63 të Raport Auditimit.

Brenda datës 31.10.2022

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi llogaritjen e TNI për disa nga objektet me leje ndërtimi dhe përdorimi, rezultoi se nuk është llogaritur në zbatim të dispozitave ligjore, veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhurash për Bashkinë Sarandë në shumën **150,332** lekë, konkretisht:

1. E.R. dhe O.J. - Leje Ndërtimi me nr.1887 prot. datë 20.04.2021 është miratuar me Vendim nr.409, datë 16.06.2021 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, për objekt: "*Ndërtim pishine dhe 1 kat parkimi nëntokë në godinë banimi 2-kate*" me subjekt zhvillues M...sh.p.k.

Llogaritja e taksës së ndikimit në infrastrukture behet në bazë të çmimit të shtetit për Bashkinë Sarandë. Fatura e pagesës së TNI datë 02.06.2021 është 144,735 lekë, fatura e aplikimit datë 02.06.2021 është 10,000 lekë, fatura për pajisje me leje ndërtimi datë 18.03.2021 është 10,000 lekë. Sipërfaqja totale e objektit është 127m². Duke e përlllogaritur me 3% x 127 m² x 32,739 = 124,735lekë + 10,000 lekë fature aplikimi+ 10,000 lekë fature për pajisje me leje ndërtimi. TNI është përlllogaritur dhe arkëtuar me vlerë 3% x 127 m² x 32,739 = 124,735 lekë (paguar) nga zhvilluesi.

Llogaritja sipas çmimit të shitjes sipas vlerës së preventivit:

Nisur nga dosja fizike, projekti arkitektonik dhe konstruktiv si dhe nga akti i vlerësimit të TNI, subjekti ka paraqitur preventiv në vlerën 6,111,021 lekë.

$TNI = \text{Vlerë preventivi } 6,111,021 \text{ lekë} \times 3\% = 183,330 \text{ lekë.}$

Nga DPZHT është llogaritur TNI vlere prej 124,735 lekë ose më pak për vlerën 58,595 lekë (183,330 – 124,735), mungesë të ardhura në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

2. F.P. - Leje Ndërtimi me nr.2018 prot. datë 13.07.2021 është miratuar me Vendim nr.425 datë 13.10.2021 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, për objektin: "*Hotel 4 kate me 2 kate nën tokë, podrum dhe garazhe*" me subjekt zhvillues M...sh.p.k, me përdorim të lejuar shërbime, adresë njësia Administrative Ksamil, Bashkia Sarandë.

Llogaritja e TNI behet në bazë të çmimit të shtetit për Bashkinë Sarandë. Fatura e pagesës së TNI datë 04.10.2021 është 990 077 lekë, fatura e aplikimit datë 04.10.2021 është 10,000 lekë, fatura për pajisje me leje ndërtimi datë 04.10.2021 është 10,000 lekë. Duke e përlllogaritur me 3% x 1008 m² x 32,739= 990,077 lekë + 10,000 lekë fature aplikimi+ 10,000 lekë fature për pajisje me leje ndërtimi.

TNI është përlllogaritur dhe arkëtuar në vlerën 3% x 1008 m² x 32,739 = 990,077 lekë(paguar) nga zhvilluesi.

Llogaritja sipas çmimit të shitjes sipas vlerës së preventivit:

Nisur nga dosja fizike, projekti arkitektonik dhe konstruktiv si dhe nga akti i vlerësimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, subjekti ka paraqitur preventiv në vlerën 35,082,531 lekë.

$TNI = \text{Vlerë preventivi } 35,082,531 \text{ lekë} \times 3\% = 1,052,476 \text{ lekë.}$

Nga DPZHT është llogaritur TNI vlere prej 990,077 lekë ose më pak për vlerën 62,399 lekë (1,052,476 – 990,077), mungesë të ardhura në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

3. V.GJ.- Leje Ndërtimi me nr.1707 prot. datë 17.11.2020 është miratuar me Vendim nr.395 datë 11.02.2021 të Kryetarit të Bashkisë Sarandë, për objekt: '*Shtese 3 kate në objekt ekzistues 1 kat, në funksion të Turizmit*' me subjekt zhvillues L...sh.p.k. , me përdorim të lejuar shërbime, adresë njësia Administrative Ksamil, Bashkia Sarandë.

Llogaritja e TNI behet në bazë të çmimit të shtetit për Bashkinë Sarandë. Fatura e pagesës së TNI datë 18.01.2021 është 327 062 lekë fatura e aplikimit datë 18.01.2021 është 10,000 lekë, fatura për pajisje me leje ndërtimi datë 04.10.2021 është 10,000 lekë. Sipërfaqja totale e objektit që shtohet është 333m² (147m² kati i pare +147m² kati i dyte +39m² kati i trete). Duke e përlllogaritur me 3% x 333 m² x 32,739= 327 062 lekë

TNI është përlllogaritur dhe arkëtuar me vlerë 3% x 333 m² x 32,739= 327 062 lekë (paguar) nga zhvilluesi.

Llogaritja sipas çmimit të shitjes sipas vlerës së preventivit:

Nisur nga dosja fizike, projekti arkitektonik dhe konstruktiv si dhe nga akti i vlerësimit të taksës së ndikimit në infrastrukturë, subjekti ka paraqitur preventiv në vlerën 11,880,000 lekë.

TNI = Vlerë preventivi 11,880,000 lekë x 3% = 356,400 lekë.

Nga DPZHT është llogaritur TNI vlera prej 327,062 lekë ose më pak për vlerën 29,338 lekë (356,400 – 327,062), mungesë të ardhura në buxhetin e Bashkisë Sarandë.

Veprime në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 28/2017 òPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.107/2014 òPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò, të ndryshuar; Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò me të gjitha ndryshimet, neni 27 pika 1; Neni 27 pika 2 e ligjit nr.142/2015 datë 17.12.2015 òPër disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

7.1. Rekomandimi:Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike bashkia Sarandë, të marrin masat për njoftimin subjekteve dhe arkëtimin e vlerës **150,332 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, *respektivisht:*

- vlera **58,595 lekë** nga investitorit **E.R. dhe O.J.**
- vlera **62,393 lekë** nga investitori **F.P.**
- vlera **29,338 lekë** ndaj investitorit **V.GJ.**

Brenda datës 31.10.2022

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit teknik e ligjor të subjekteve të pajisur me certifikatë përdorimi, konstatohet se për 19 rastet e dhënies e certifikatës së përdorimit është e njëjta me atë të lejes së ndërtimit.

Por konstatohet se në tre raste situacionet përfundimtare të paraqitura nga investitorët janë me vlerë më të lartë se vlera e preventivit ose çmimit mbi të cilën është llogaritur TNI, për të cilën nga personat përgjegjës nuk është llogaritur diferenca e krijuar në vlerën **677,218 lekë, vlerë e cila përbën efekt negativ në buxhet, konkretisht:**

- 4- Objekti me zhvillues òA.D., E.D.ò, ka paraqitur vlerën e situacionit prej 44,745,876 lekë, ku TNI është në shumën 1,342,763 lekë (44,745,876 x 3%). Investitori fillimisht ka likujduar TNI në shumën 805,476 lekë, **duke mbetur për diferencë shuma 536,900 lekë (1,342,763 – 805,476).**
- 5- Objekti me zhvillues òN.R.ò, ka paraqitur vlerën e situacionit prej 73,842,414 lekë, ku TNI është në shumën 2,215,272 lekë (73,842,414 x 3%). Investitori fillimisht ka likujduar TNI në shumën 2,137,630 lekë, **duke mbetur për diferencë shuma 77,642 lekë (2,215,272 – 2,137,630).**
- 6- Objekti me zhvillues òE.D.ò, ka paraqitur vlerën e situacionit prej 7,819,224 lekë, ku TNI është në shumën 234,576 lekë (7,819,224 x 3%). Investitori fillimisht ka likujduar TNI në shumën 171,900 lekë, **duke mbetur për diferencë shuma 62,676 lekë (234,576 – 171,900).**

Veprime në kundërshtim me nenin 46 të ligjit nr. 28/2017 òPër disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin Nr.107/2014 òPër Planifikimin dhe Zhvillimin e Territoritò, të ndryshuar; Ligji nr.9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò me të gjitha ndryshimet, neni 27 pika 1; Neni 27 pika 2 e ligjit nr.142/2015 datë 17.12.2015 òPër disa ndryshime dhe shtesa të ligjit nr.9632 datë 30.10.2006 òPër sistemin e taksave vendoreò. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1 Rekomandimi:Drejtoria e Planifikim Zhvillim Territorit në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike Bashkia Sarandë, të marrin masat për njoftimin subjekteve dhe arkëtimin e vlerës **677,218 lekë**, duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët, *respektivisht:*

- vlera **536,900 lekë** nga zhvilluesi òA.D., E.D.ò
- vlera **77,642 lekë** nga zhvilluesi òN.R.ò

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga DTV Bashkia Sarandë, rezulton një gjendje e lartë e detyrimeve të pa arkëtuara nga subjektet fizik/juridik në vlerën 317,290,273 lekë.

Nisur nga fakti se numri i debitorëve është i lartë (aktualisht 2461 me vlerë 317,290,273 lekë), nuk mund të paraqesim në formë tabelore për shkak të sasisë së madhe, e cila është në formë dixhitale, me CD.

Konstatohet se nga një periudhë në tjetër, niveli i detyrimeve të pa arkëtuara vjen në rritje nga viti 2020 në shumën 31,021,793 lekë, pasi nga vlera 286,268,480 lekë në fund të vitit 2021 paraqitet vlera **317,290,273 lekë**, e cila përbëhet nga taksat dhe tarifatat vendore të papaguara, *borxh tatimor dhe mungesë të ardhurash për buxhetin e Bashkisë Sarandë*.

Nga DTV Bashkia Sarandë, nuk janë llogaritur kamatëvonesat për mos likuidimin në afat të detyrimeve në shumën **69,486,569 lekë**.

Evidentohet fakti që peshën kryesore e zënë debitorët e subjekteve fizik/juridik në vlerën 317,222 mijë lekë ose 78.8% e totalit.

Gjithashtu evidentohet fakti se nga DAV Bashkia Sarandë, nuk është ndjekur asnjë procedurë ligjore për arkëtim e tyre, veprime të cilat kanë çuar në mungesë të ardhurash në bashki.

Referuar të dhënave të buxhetit, vlera e detyrimeve nga taksat e tarifatat vendore të subjekteve fizik/juridik dhe abonentë familjarë është 30.5% e planit të buxhetit.

Gjithashtu evidentohet një numër i konsiderueshëm subjektësh të cilët dhe pse ushtrojnë aktivitetet dhe nga Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore çdo vit ju rigjenerohet njoftim detyrimi për vitin vijues, janë lejuar që të ushtrojnë aktivitetet pa bërë likuidimet e detyrimeve ndër vite.

Në lidhje me njoftimin për debitorë, nga inspektorët tatimorë janë bërë disa herë njoftime vlerësimi për detyrimet tatimore vendore për të gjithë subjektet dhe taksapaguesit familjare debitorë, por nga niveli menaxherial nuk është ndërmarrë asnjë veprim për të kaluar në masat shtrenguese dhe në mbledhjen me forcë të detyrimit.

Nga të dhënat evidentohet se një numër i konsiderueshëm subjektet me status pasiv/mbyllur me detyrime të pa arkëtuara, gjithsej nga 138 subjekte që kanë mbyllur aktivitetin, 60 prej tyre janë me detyrime me vlerë **9,971,459 lekë**, ku përgjegjësia është si Administratës së QKB Njësia Sarandë, po ashtu dhe DTV Bashkia Sarandë, e cila ka lejuar mbylljen e tyre subjekteve pa likuiduar detyrimet fiskale, duke u bërë premisë për kalimin e tyre në borxh **të pa arkëtueshëm ose të keq**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 ó “Çregjistrimi i subjekteve tatimore” dhe Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 òPër procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisëò, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, òKodi Penal i Republikës së Shqipërisëò, i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve¹², apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit òPër Kundërvajtjet Administrativeò (brenda 2 viteve), duke u bërë përgjegjës për rritjen e nivelit të borxhit. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimi tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat/ tarifatat vendore në fund të vitit 2021 në vlerën **317,290,273 lekë**.

¹² “Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, megjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Brenda datës 31.12.2022

9.2. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë, të marrë masa për llogaritjen e saktë të vlerës së kamatëvonesave në masën 0.06% për detyrimet e maturuara por të paderdhura sipas afateve ligjore nga subjektet dhe më pas të ndërmarrë veprime për arkëtimin e kësaj vlere.

9.3. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë të bashkëpunojë me QKB Dega Sarandë që në zbatim të dispozitave ligjore të ligjit për procedurat tatimore dhe QKB, të mos lejojnë që për subjektet debitorë të bëhet mbyllja e aktivitetit ose lejimin e administratorëve për hapjen e aktiviteteve të tjera me Nipt tjetër, kjo për të eliminuar në maksimum borxhin e keq.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me abonentët familjarë situata është pak më mirë, kjo si rezultat i bashkëpunimit me agjentin tatimorë Ndërmarrjen e Ujësjiellës Kanalizime Sarandë.

Kështu:

Për periudhën 2015 ó 2021 është faturuar gjithsej vlere 558,989,049 lekë, nga e cila: tarifë shërbimi 350,056,918 lekë dhe taksa ndërtesë në vlerën 208,932,032 lekë. Janë likuiduar për këtë periudhë shuma 474,057,147 lekë, kjo sipas akt akordimeve mujore dhe vjetore me agjentin tatimorë, **duke mbetur për likuidim shuma 84,931,902 lekë për 16067 familje, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.**

Referuar të dhënave të paraqitura mbi likuidimet, konstatohet se sipas akt akordimeve që abonentët familjarë të kenë paguar më shumë se detyrimi, gjë e cila nuk mund të ndodh, por nga DTTV Bashkia Sarandë nuk ka informacion të saktë mbi debitorët familjarë që janë të kontabilizuar në Ndërmarrjen e Ujësjiellës Kanalizime sha.

Gjithashtu, konstatohet se nga DTV Bashkia Sarandë, nuk ka informacion mbi familjet që janë pa kontratë me ujësjiellësin, duke mos aplikuar detyrimet fiskale për taksat e tarifave vendore.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Kreun XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave Vendore Bashkia Sarandë të bashkërendojë punën me Ndërmarrjen e Ujësjiellës Kanalizime Sarandë, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së mbetur më 31.12.2021 prej **84,931,902 lekë.**

Brenda datës 31.12.2022

11. Gjetje nga auditimi: Nga të dhënat konstatohet se në vitin 2021 kemi një rënie të nivelit të arkëtimeve nga taksa e ndikimit të infrastrukturë (TNI), ku nga 113,920 mijë lekë të arkëtuara në vitin 2020 në vitin 2021 është arkëtuar vlere prej 55,704 mijë lekë, kjo si rezultat i uljes së kërkesave për leje ndërtimi.

Në këtë zë bën pjesë dhe taksa nga ndërtimet e reja (ALUIZNI), ku referuar të dhënave, detyrimi për këtë taksë në fund të vitit 2021 paraqitet në shumën 74,206,014 lekë.

Vlora prej **74,206,014 lekë**, përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Sarandë, ku në mënyrë analitike, pasqyra në Drejtorinë e Taksave Vendore.

Nga dokumentacioni i paraqitur, nuk u evidentuan raste që Bashkia Sarandë ti jetë drejtuar ASHK Dega Sarandë, për bllokimin e pasurisë dhe mos kryerjen veprimeve hipotekore ose bllokimin e marrjes e lejes së legalizimit dhe certifikatës pa bërë më parë pagesën taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 27 pika (d), të ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 *“Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”*.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me ligjin nr. 9482 datë 03.04.2016, *ËPër legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje* i ndryshuar me ligjin nr. 50/2014 neni 23, neni 23, pika 2/1 e nenit 27 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, *ËPër sistemin e taksave vendore* të ndryshuar, VKM nr. 860, datë 10.12.2014 *ËPër përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe veprave të zbatueshme për legalizim* i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

11.1. Rekomandimi:Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e PZHT Bashkia Sarandë, të marrë masat duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e vlerës prej **74,206,014 lekë**, sipas listës që disponon DTV Bashkia Sarandë.

11.1. Rekomandimi:Kryetari i Bashkisë Sarandë nëpërmjet bashkëpunimit institucional, t'kërkojë ASHK-së Drejtoria Rajonale Sarandë, që të mos pajisë me çertifikata legalizimi subjektet apo individët përfitues nga procesi i legalizimit pa kryer pagesat e taksës së ndikimit në infrastrukturë në masën 0.5% të vlerës së investimit për objektet që përfitojnë nga legalizimi. Në rastet kur nga ASHK është vijuar me dhënien e certifikatës së legalizimit të kërkohet bllokimi i pronës deri në kryerjen e pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Brenda datës 31.12.2022

F. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 57 *ËPërgjegjësia për masat disiplinore*, nenin 58 *ËLlojet e masave disiplinore* dhe nenin 59 *ËKompetenca dhe procedura për masat disiplinore*, të Ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", në pikën 11 të VKM nr. 115, datë 05.06.2014 *ËPër përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin disiplinor në shërbimin civil*, si dhe nenit 37 dhe 144 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 *ËKodi i Punës në Republikën e Shqipërisë*, i ndryshuar, nenit 9 *Ë Masat disiplinore*, të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Sarandë** vlerësimin e përgjegjësive të punonjësve dhe dhënien e masës disiplinore nga *ËVërejtje* deri në *ËLargim nga puna*, ndaj **4 (katër) punonjësve**, si më poshtë:

1. **L.B.**, me detyrë Drejtor i DTTV Bashkia Sarandë.

2. **N.A.**, me detyrë Specialiste e borxhit fizik/juridik.

3. **K.K.**, me detyrë Drejt/Drejtoria e Bujqësisë Shërbimit Veterinar, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit.

4. **G.D.**, me detyrë Drejtor i Shërbimeve Publike.

Për shkeljet e mëposhtme:

Mangësitë e konstatuara në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifave vendore në lidhje me planifikimin dhe taksimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitetet në Bashkinë Sarandë dhe mos ndjekjen e të gjitha procedurave administrative e ligjore në zbatim të ligjit për arkëtimin e debitorëve, trajtuar në pikën 2.2.6 faqe 43-65 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

G. MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 i ndryshuar me ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 *ËPër prokurimin publik*, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit (kapitulli III/2.3 faqen 35-67), mbështetur në nenin 15, të ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 *ËPër Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*; nenin 132 të ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 *ËPër prokurimin publik*, si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin

58-*llojet e masave disiplinore* të ligjit nr. 152/2013 *ËPër nëpunësin civilë*; nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 *ËKodi i Punës në Republikën e Shqipërisë* (me ndryshime) dhe të kontratës individuale të punës, **i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Sarandë**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave **administrative ose masë disiplinore** në raport me shkeljet e konstatuara, për **6 (gjashtë) punonjësve**, si më poshtë:

1. **R.H.**, me detyrë *Specialist IT në Drejtorinë e Personelit dhe Burimeve Njerëzore*.

2. **L.H.**, me detyrë *Specialist Drejtoria Juridike*.

3. **E.L.**, me detyrë *Specialist në Njësinë e Prokurimit në Drejtorinë Juridike*.

Për shkeljet e mëposhtme:

- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT), në mos argumentim dhe vendosje të kërkesave të specifikimeve teknike dhe kërkesave për kualifikim të pa argumentuara, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në mospërputhje me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020, *ËPër prokurimin publik*, neni 3, "*Parimet e përzgjedhjeje*", nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 *ËAutoriteti ose enti kontraktor*, neni 98, "*Anulimi i një procedure*", neni 76, *ËKriteret detyruese për skualifikim*, neni 92, "*Shqyrtimi i ofertave*", si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, *ËPër miratimin e rregullave të prokurimit publik*, i ndryshuar, neni 82, *ËShqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave*, neni 83, "*Njoftimi i fituesit*". (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 82-100 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

4. **R.C.**, me detyrë *Zv/Kryetar i Bashkisë Sarandë*.

5. **E.GJ.**, me detyrë *Sekretar i Përgjithshëm*.

6. **K.A.**, me detyrë *Specialist IT në Drejtoria e Personelit dhe Burimeve Njerëzore*.

Për shkeljet e mëposhtme:

